RAPORTI PËRFUNDIMTAR

Mbi
"Auditimin e Përputhshmërisë"

Tiranë, korrik 2026

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3 – 8**
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
II.	**HYRJA**	**8 – 12**
1.	Objektivat dhe qëllimi	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
6.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
III	**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**	**12 - 64**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	12 - 12
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	**12 – 64**
2.1	*Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre*	*12 - 15*
2.2	*Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve dhe administrimin e marrëdhënieve të punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi*	*15 – 21*
2.3	*Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve operative, kapitale, administrative.*	*21 – 39*
2.4	*Mbi zbatimin e ligjshmërie në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave publike.*	*21 -39*
2.4.4	*Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike*	*39 – 43*
2.5	*Auditimi i organizimit dhe mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprore; zbatimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.*	*43 – 49*
2.6	*Mbi planifikimin dhe zbatimin e treguesve ekonomik dhe financiar të shoqërisë.*	*49 – 64*
IV.	**REKOMANDIME**	**64 – 71**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Departamenti i Auditimit të Institucioneve të Sigurisë, Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve të vitit 2025 dhe Programit të Auditimit nr. 983/1, datë 15.10.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 17.10.2025 deri më datë 23.01.2026, ka kryer auditimin e përputhshmërisë në shoqërinë HEC Lanabregas-Tiranë Sh.A, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, zbatimin e legjislacionit në fushën e prokurimeve publike, zbatimin e kontratave të punëve publike (investimet), organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, zbatimin e treguesve ekonomik e financiar, strukturës organizative, dhënien e pagave e shpërblimeve, etj.

Periudha e mbuluar me auditim, sipas programit të Auditimit është nga data 01.01.2023 deri në datën 30.09.2025. Gjatë procesit të auditimit, nga grupi i auditimi janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga shoqëria "HEC Lanabregas- Tiranë" Sh.A si, në zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve dhe administrimin e marrëdhënieve të punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, auditimin me zgjedhje të shpenzimeve operative (sipas periudhave), zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimet të fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, mbi organizimin dhe mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, inventarizimi fizik i pasurisë, dhe planifikimin dhe zbatimin e treguesve ekonomik dhe financiarë të shoqërisë.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

KLSH-ja në zbatim në neneve 6 dhe 10, të Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ka detyrimin të auditojë në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualet në fuqi, standardet ndërkombëtare të auditimit. Në ushtrim të kompetencave të tij ligjore auditon përdorimin, administrimin dhe mbrojtjen e fondeve dhe pronës publike apo shtetërore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Në funksion të këtyre detyrimeve ligjore auditimi u krye në përmbushje të programit të auditimit nr. 983/1, datë 15.10.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH.

Rëndësia e auditimit që KLSH kryen mbi shoqërinë HEC Lanabregas Sh.A është shumëdimensionale dhe lidhet kryesisht me transparencën, mirëmenaxhimin dhe mbrojtjen e interesit publik, duke u fokusuar në:

- Transparenca dhe llogaridhënia publike, që aktiviteti financiar dhe operativ i shoqërisë të jetë transparent dhe në përputhje me ligjin;
- Nëse HEC Lanabregas SH.A, po i përdor në mënyrë efikase asetet dhe resurset e saj. A gjeneron energji në përputhje me kapacitetin, a minimizohet kostoja e mirëmbajtjes, dhe a arrihen objektivat strategjike të energjisë;
- Synon të zbulojë çdo shkelje të legjislacionit financiar, tatimor apo të prokurimeve publike që mund të ketë ndodhur gjatë veprimtarisë së shoqërisë. Kjo përfshin kontrolle mbi kontratat, tenderët dhe menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Identifikon raste të mundshme të keqmenaxhimit, keqpërdorimit të fondeve, apo korrupsionit, duke i raportuar ato për ndjekje të mëtejshme administrative ose ligjore;
- Rekomandimet e auditimit ndihmojnë shoqërinë të zbatojë praktika më të mira të menaxhimit, të përmirësojë sistemet e kontrollit të brendshëm dhe të rrisë besueshmërinë ndaj palëve të interesuara (qeveria, komuniteti lokal, investitorët, etj.);
- Rezultatet e auditimit i shërbejnë edhe institucioneve shtetërore për të përmirësuar politikat kombëtare në menaxhimin e burimeve ujore dhe energjetike, bazuar në prova e gjetje konkrete.

- Auditimi i HEC Lanabregas SH.A është thelbësor për të siguruar që aktiviteti i shoqërisë zhvillohet në mënyrë të ndershme, efektive dhe në interes të qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi, synon në dhënien e opinionit të përputhshmërisë në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë HEC Lanabregas Sh.A, për periudhën 01.01.2023 deri në 30.09.2025, nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë shoqëria HEC Lanabregas, për të bërë të mundur marrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime, me synim marrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushjen e qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre;*
- *Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve dhe administrimin e marrëdhënieve të punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.*
- *Auditimi me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve operative, kapitale, administrative etj.*
- *Mbi zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimet të fondeve publike, si dhe lidhja e zbatimi i kontratave.*
- *Auditimi i organizimit dhe mbajtja e evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprore; zbatimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj. ndaj buxhetit të shtetit*
- *Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.*
- *Mbi planifikimin dhe zbatimin e treguesve ekonomik dhe financiarë të shoqërisë.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodat për kryerjen e këtij e auditimi janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 80% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;

c. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë, si në fushën e strukturës organizative, të fondit të pagave, pasqyrave financiare, procedurave të prokurimit, për të cilën grupi i auditimit ka konstatuar 10 gjetje dhe ka dhënë 10 rekomandime të karakterit organizativ dhe 3 gjetje dhe 3 rekomandime për 3-E.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Nga auditimi i 4 dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, në shoqërinë "HEC-Lanabregas" Sh.A, u konstatua se:

- Dosjet fizike të procedurës se prokurimit, nuk janë të pajisura me inventar të brendshëm për të gjithë përmbajtjen e tyre, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, dhe të Vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 4, datë 19.06.2017 "*Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH*", dhe Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për arkivat*";
- Në 3 nga 4 procedurat e audituara, KVO-ja nuk ka vepruar në përputhej me dispozitat e LPP, pasi OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DT të miratuara nga AK "HEC- Lanabregas" Sh.A, duke lidhur kontratë me një OE në mos plotësim të kritereve kualifikuese, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 2, neni 3 pika 1 dhe neni 92 pika 3 dhe 4.
- Nga auditimi mbi miratimin e ndryshimeve në strukturë të Asamblesë dhe të Këshillit Mbikëqyrës, rezultoi se nga pikëpamja formale, vendimet në asnjë rast nuk i referohen vendimit konkret i cili pëson ndryshime, duke mos pasur lidhje logjike pasi në këto vendime nuk pasqyrohet numri ekzistues i punonjësve i cili rritet ose pakësohet në varësi të ndryshimeve të kërkuara.
- Në Rregulloren e brendshme apo në ndonjë akt tjetër administrativ, nuk janë parashikuar kritere të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në punë për vende të lira, shpallja e tyre bëhet rast pas rasti në varësi të nevojave për rekrutim.
- Nuk parashikohet procedura e konkurrimit apo e pranimit në punë, si dhe procedura e publikimit të njoftimit për rekrutim në një pozicion të caktuar. Në kontratat individuale të punës është parashikuar vetëm dokumentacioni që duhet të paraqesë punëmarrësi në rastin e pranimit në punë. Nuk evidentohet të ketë raste të deklarimeve për vende të lira në të cilat të jenë të publikuara.
- Në planet ekonomiko financiare, nuk është planifikuar numri i vendeve vakante të krijuara si rezultat i largimeve nga puna apo daljeve në pension.
- Nga auditimi i dokumentacionit në shoqërinë "HEC-Lanabregas" SHA, rezultoi se objektivi kryesor i shoqërisë përcaktuar dhe në statutin e shoqërisë është prodhim i energjisë elektrike dhe shitja e energjisë elektrike. Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj. Nga shqyrtimi i regjistrit të aktiveve të shoqërisë vërehet se një pjesë e madhe e makinerive dhe pajisjeve kanë tejkaluar afatet teknike të përdorimit.
- Nga shoqëria nuk u bënë të disponueshme analiza teknike të mbështetura në manualet përkatëse të pajisjeve, ekspertizave të specialistëve të fushës, të detajuara për caktimin e jetëgjatësisë për pajisjet gjendje, dhe planifikimin për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. Gjithashtu drejtimi i shoqërisë duhet të plotësojë planin e vet me një njohje të mirë të bazës së aktiveve që duhen për të përmbushur objektivat e saj. Strategjitë e menaxhimit të aktiveve duhet të synojnë që të krijojnë, të ruajnë dhe sipas nevojave, të përmirësojnë strukturën e aktiveve, brenda një periudhe të caktuar.
- Nga auditimi u konstatua se shoqëria HEC Lanabregas SHA nuk ka hartuar e miratuar rregullore për menaxhimin e aktiveve, për ruajtjen e tyre, përcaktimin e personave përgjegjës për rastet e dëmtimeve apo mungesave gjatë procesit të inventarizimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 9, germa "ë", dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 5.
- Nga auditimi u konstatua se në vlerën e AAGJM në pasqyrat financiare janë paraqitur studime e projektime në proces në vlerën 17,913,190 lekë që kanë të bëjnë me projekte të cilat i përkasin periudhave 2017 - 2019 me qëllim zëvendësimin e pajisjeve të vjetra të HEC-it të cilat, nuk janë vënë në zbatim dhe mbartin riskun e mos përmbushjes së objektivave për përdorimin e aktiveve afatgjata nga pikëpamja e vlerave, përmirësimin në strukturën e tyre për një periudhë të caktuar duke siguruar efiçensën e fondeve të përdorura për përmirësimin e tyre.
- Në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe 2024, në Aktivet afatshkurtër, zëri shpenzime të shtyra në vlerën 12,975,000 lekë përfaqëson edhe vlerën e kontratës, për projektin me objekt "*Ofrimi i Shërbimeve të Specializuara Ligjore dhe Rregullatorë në lidhje me Energjinë nga burime të Rinovueshme në favor të HEC Lanabregas SHA*", që i përket periudhës viti 2019, e cili për periudhën

pas realizimit nuk ka afruar shërbime për operatorë të tjerë pra nuk ka përmbushur qëllimin për të realizuar të ardhura.
- Bazuar në parashikimin vitit 2025, si dhe nevojës për pasjen e siguracioneve të automjeteve ka kërkuar kryerjen e shërbimit si vijon: Siguracioni vjetor TPL për 4 automjete, si dhe për automjetin KIA Sportage me targë AB ... KL siguracion ndërkombëtar (Kartoni jeshil), siguracion Full Kasko si dhe për vjedhje brenda dhe jashtë Shqipërisë. Përcaktimi i marrjes së siguracionit ndërkombëtar për 1 vit në vlerën 400 euro është shpenzim jo në përputhje me parimet e eficiencës dhe efektivitetit pasi nuk ka arsye të paguhet për një periudhë 1 vjeçare.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:
- Titullari i Autoritetit Kontraktor të shoqërisë **"**HEC- Lanabregas" Sh.A të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos arkivim të dosjeve, dhe për kualifikimin e OE-ve, të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DT;
- Në çdo rast, gjatë fazës së vlerësimit të një procedure prokurimi, të konsiderohet e vlefshme dhe të kualifikohet vetëm ajo ofertë që është plotësisht në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor i ka vlerësuar të domosdoshme.
- Nga strukturat përkatëse (*Asambleja e ortakut të vetëm dhe Këshilli Mbikëqyrës i HEC Lanabregas*), të merren masa që në zbardhjen e vendimeve mbi ndryshimet apo miratimin e strukturës organike, t'i referohet numrit dhe vendimit të Asamblesë apo të Këshillit Mbikëqyrës të cilit i bëhen ndryshimet respektive duke shprehur, numrin ekzistues të punonjësve dhe rritjen apo pakësimin e tij sipas rastit, me qëllim që ndryshimet të kenë vijimësi dhe të shprehin qartë diapozitivin e vendimit.
- Nga strukturat përgjegjëse Asambleja/Ortaku i vetëm "UKT" SHA dhe Drejtoria Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve/"HEC Lanabregas", të merren masa për të bërë ndryshimet në statut, në lidhje me vendosjen e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimet në punë si dhe procedurat e konkurrimit dhe publikimit të njoftimeve për vende të lira pune.
- Në programet ekonomike të pasqyrohen dhe parashikohen vendet e lira sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, me qëllim planifikimin e nevojave për vende të lira pune.
Administratori i Shoqërinë në bashkëpunim me Këshillim Mbikëqyrës, të marrë masa për:
- Rritjen e monitorimit të kontratave duke kërkuar nga strukturat përgjegjëse për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës, verifikimin e dokumentacionit të dosjeve teknike i cili duhet të jetë në përputhje me aktet ligjore përkatëse.
- Përllogaritjen e sasisë së materialeve të demontuar, jo vetëm për këtë kontratë, por edhe kontrata të mëparshme, me synim përcaktimin e saktë të peshës apo dimensioneve, elementë të domosdoshëm për procese të tjera si nxjerrja jashtë përdorimit, apo shtija për skrap.
- Përcaktimin e sistemeve dhe të procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të tyre të jetës është një mënyrë për parandalimin e mosfunksionimin e papritur të ndonjë aktivi. Dobishmëria e çdo aktivi duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit të aktiveve.
- Hartimin dhe miratimin e një rregulloreje për menaxhimin e aktiveve për ruajtjen e tyre, me qëllim përcaktimin personave përgjegjës për rastet dëmtimeve apo mungesave gjatë procesit të inventarizimit.
- Projektin me objekt "*Ofrimi i Shërbimeve të Specializuara Ligjore dhe Rregullatorë në lidhje me Energjinë nga burime të Rinovueshme në favor të HEC Lanabregas SHA*" në vlerën 12,975,000 lekë të pa vëna në zbatim të përgatis një relacion dhe ta paraqes në Këshillin Mbikëqyrës për analizimin dhe marrjen e masave për vënien në zbatim, për përmbushjen e objektivave për përdorimin e aktiveve nga pikëpamja e vlerave, duke siguruar efiçensën e fondeve të përdorura.

1.1. Konkluzion dhe Opinioni i Auditimit.

<u>Opinion mbi përputhshmërisë</u>:
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë HEC Lanabregas SH.A, me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2023 deri më 30.09.2025, bazuar në mandatin e KLSH-së për auditimin e përputhshmërisë dhe kompetencën për të kryer auditimin sipas parashikimit të Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
Evidencat e marra janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë të arsyeshme për opinionin tonë nga një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord.
Nga auditimi është konstatuar se gjatë veprimtarisë së shoqërisë HEC Lanabregas SH.A janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "*Bazës për Opinionin*", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, situatë e cila justifikon dhënien e një ***opinioni të kualifikuar***[1]**.**
*<u>Baza për opinionin e kualifikuar</u>**:***
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin *"Përgjegjësitë e Audituesit"*, pjesë e Raportit të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e përputhshmërisë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë anomalitë e mëposhtme:
- Nga auditimi i 4 dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, u konstatua se: Dosjet fizike të procedurës se prokurimit, nuk janë të pajisura me inventar të brendshëm për të gjithë përmbajtjen e tyre; Në 3 nga 4 procedurat e auditura, KVO-ja nuk ka vepruar në përputhej me dispozitat e LPP, pasi OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kritereve të DT të miratuara nga AK.
- Nga pikëpamja formale, vendimet e marra nga Asambleja dhe Këshilli Mbikëqyrës, në asnjë rast nuk i referohen vendimit konkret i cili pëson ndryshime, duke mos pasur lidhje logjike pasi në këto vendime nuk pasqyrohet numri ekzistues i punonjësve i cili rritet ose pakësohet në varësi të ndryshimeve të kërkuara, si dhe nuk parashikohet procedura e konkurrimit apo e pranimit në punë, si dhe procedura e publikimit të njoftimit për rekrutim në një pozicion të caktuar.
- Në programet ekonomiko financiare, nuk është planifikuar numri i vendeve vakante të krijuara si rezultat i largimeve nga puna apo daljeve në pension, në një kohë që për vitin 2023, janë 5 largime nga puna për arsye të ndryshme.
- Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, nuk ka hartuar e miratuar rregullore për menaxhimin e aktiveve, për ruajtjen e tyre, përcaktimin e personave përgjegjës për rastet e dëmtimeve apo mungesave gjatë procesit të inventarizimit.
- Nga analiza e llogarisë studime e projektime, pasqyruar në vlerën 17,913,190 lekë, janë projekte të cilat i përkasin periudhave 2017 - 2019 me qëllim zëvendësimin e pajisjeve të vjetra të HEC-it të cilat, nuk janë vënë në zbatim dhe mbartin riskun e mos përmbushjes së objektivave për përdorimin e aktiveve afatgjata nga pikëpamja e vlerave, përmirësimin në strukturën e tyre për një periudhë të caktuar, duke siguruar efiçensën e fondeve të përdorura për përmirësimin e tyre.

[1] SNA-705- Audituesi duhet të shpreh një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftushme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku janë materiale por jo të përhapura.

- Në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe 2024 në Aktivet afatshkurtër, zëri shpenzime të shtyra në vlerën 12,975,000 lekë përfaqëson edhe vlerën e kontratës, për projektin me objekt "Ofrimi i Shërbimeve të Specializuara Ligjore dhe Rregullatorë në lidhje me Energjinë nga burime të Rinovueshme në favor të HEC Lanabregas SH.A" që i përket periudhës vitit 2019, e cili për periudhën pas realizimit nuk ka afruar shërbime për operatorë të tjerë, pra nuk ka përmbushur qëllimin për të realizuar të ardhura.

II. HYRJA.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 983/1, datë 15.10.2025 miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 17.10.2025 deri më datë 23.01.2026, në subjektin HEC Lanabregas Sh.A, u krye auditimi i përputhshmërisë për periudhën nga 01.01.2023 deri në 30.09.2025 nga grupi i auditimit me përbërje:

1. K.GJ. *Përgjegjës grupi*;
2. P.GJ. *auditues;*
3. A.T. *auditues;*
4. M.H. *audituese;*
5. B.SH. *auditues.*

Auditimi u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit në: zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve dhe administrimin e marrëdhënieve të punës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, auditimin me zgjedhje të shpenzimeve operative (sipas periudhave), zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimet të fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, mbi organizimin dhe mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, inventarizimi fizik i pasurisë, dhe planifikimin dhe zbatimin e treguesve ekonomik dhe financiarë të shoqërisë.

1. Objektivat, Fushëveprimi dhe Metodologjia.

- Objekti dhe qëllimi i auditimit. Në objektivat dhe qëllimet e auditimit, synohet dhënia e opinionit të përputhshmërisë mbi një vlerësim objektiv, profesional dhe të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga shoqëria "HEC Lanabragas" Sh.A të rregullave, ligjeve. Qëllimi i tij është përcaktimi i nivelit të zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me aktivitetin e "HEC Lanabragas" SHA, për periudhën në auditim.

Auditimi synon gjithashtu në përcaktimin nga ana e audituesve:

- *Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar publik;*
- *Dhënien e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së HEC-it.*

- Identifikimi i çështjes. Përcaktimi i nivelit të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të shoqërisë dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e shoqërisë HEC Lanabregas Sh.A.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë

vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i adituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të HEC Lanabregas Sh.A.

- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Strukturat drejtuese të HEC Lanabregas Sh.A, kanë për detyrë që të përgjigjen për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe financiar. Gjithashtu, strukturat drejtuese janë përgjegjëse për vënien në dispozicion të dokumenteve zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionit të kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

- Përgjegjësitë e audituesve. Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktiviteti i njësisë dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara, i cili shprehet nëpërmjet dhënies së opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), si dhe Kodin e Etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni. Këto standarde kërkojnë që audituesit të respektojë kërkesat etike si dhe të planifikojë e kryejë auditimin, me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar. Përgjegjësia jonë (Audituesit e KLSH-së) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:
- Nëse janë zbatuar dispozitat ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, prokurimet e fondeve publike,
- Vlerësimin mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve operative, kapitale, administrative etj. Zbatimin e ligjshmërisë në procedurat e prokurimet të fondeve publike, si dhe lidhja e zbatimi i kontratave,
- Vlerësimin e parimeve kontabël të përdorur dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

- Kriteret e vlerësimit. Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin përkatës që rregullon çështjet si drejtime të auditimit, si: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*"; Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 '*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*'', i ndryshuar; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 "*Për procedurat e prokurimit*", i ndryshuar; Ligji nr. 9584 "*Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura dhe Institucioneve të tjera Kushtetuese*", i ndryshuar; Ligji nr. 29/2024 "*Për Burimet Ujore*"; Ligji nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*"; VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar; Statuti i shoqërisë, (i ndryshuar), miratuar me Vendim të Aksionerit të vetëm (UKT) nr. 13, datë 30.09.2013; Rregullore e Brendshme miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 15, datë 13.12.2016; Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

- Standardet e auditimit. Standardet e zbatuara nga grupi i auditimit gjatë kryerjes së angazhimit të auditimit: ISSAI 100 (*Parime themelore të auditimit të sektorit publik*), që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 400 (*Parime parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë),* që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato, duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 "*Prezantimi i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";* Manuali i Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve/ECA; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë";* etj.; Praktikat më të mira të fushës.

- Metodat e auditimit. Si metodë auditimi gjatë procesit të auditimit është përdorur metoda me

auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit[2]. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik*. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.
- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese*. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese, konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.
- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese*. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
- *Kontrolli i vlerësimit*. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
- *Konfirmim nga të tretët*. Përcakton nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
- *Kontrolli sipas një treguesi*. Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna "jashtë normales", që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu

[2] **ISSAI 1320 (ISA 320)** trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.
Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat, shpenzimet për kontribute të sigurimeve, shpenzimet operative, transferimet korrente si dhe investimet. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja[3].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetentë dhe të mire informuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.
Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:
a. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:
b. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe drejtimet e auditimit;
d. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

- Dokumentimi i auditimit. Audituesit e KLSH, mbi bazën e dokumentacionit (evidencave) të kërkuar/a dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me përfaqësuesit e HEC Lanabregas Sh.A, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit, natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, e-mail-ve, të finalizuar këto në akt konstatimet e mbajtura në subjekt të cilat u dorëzuan në datë 23.01.2026 në protokollin e shoqërisë HEC Lanabregas Sh.A, sipas afatit të përcaktuar në programin e auditimit, nr. 983/1, datë 15.10.2025 dhe më pas me shqyrtimin e observacioneve të subjektit, u hartua dhe dërgua, Projekt Raport Auditimi.

[3] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm ∗ Risku i kontrollit ∗ Risku i Zbulimit

Në përfundim të afateve mbi Projekt Raport Auditimit, përcjellë me shkresën nr. 983/3 prot, datë 11.05.2026, nga subjekti audituar HEC Lanabregas Sh.A me shkresën nr. 143/1 prot, datë 11.06.2026 *(prot KLSH nr. 983/4, dt. 11.06.2026)*, janë përcjellë observacionet mbi Projekt raportin e Auditimit, të cilat pasi u lexuan me kujdes dhe paanshmëri, hartohet ky Raport Përfundimtar të Auditimit, i cili i përcillet subjektit për njohje dhe zbatim.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.


1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Shoqëria HEC Lanabregas Sh.A është organizuar si shoqëri aksionare në bazë të aktit të themelimit datë 06.11.2013 dhe regjistruar në QKR më datë 18.07.2014, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
Objekti kryesor i veprimtarisë së saj është shitja dhe prodhimi i energjisë elektrike. Aksionet e shoqërisë zotërohen 100% nga aksioneri i vetëm UK Tiranë sha. Organet drejtuese të saj janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës. Administratori i shoqërisë si dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga Asambleja e ortakëve. Struktura organizative e shoqërisë përbëhet nga Administratori, Drejtoria Administrative (*Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori Ekonomik*), Drejtoria Teknike (*Sektori i Mirëmbajtjes dhe Sektori i Prodhimit*) si dhe staf mbështetës teknik (*P/Turni , Panelist dhe Turbinist*).

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, *(Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre*).

Shoqëria HEC Lanabregas Sh.A, është shoqëri aksionare me aksionar të vetëm-Shoqëria e Ujësjellës Kanalizime, SHA Tiranë, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë. Ajo funksionon në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, dhe Statutit të Shoqërisë (i ndryshuar) miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, me Vendimin nr.13, datë 30.09.2013. Organet drejtuese të HEC, referuar nenit 10 të Statutit të shoqërisë janë: Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli Mbikëqyrës, përbërja e të cilave paraqitet në grafikun më poshtë:



Asambleja e Përgjithshme (AP), përfaqësohet nga aksioneri i vetëm (*Shoqëria e Ujësjellës Kanalizime, SHA Tiranë e përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë*) dhe thirret në mbledhje sa herë që është e nevojshme për interesat e shoqërisë, minimumi një herë në vit.

☞Asambleja e Përgjithshme/aksioneri i vetëm është mbledhur më shumë se një herë në vit, në përputhje me nenin 12, pika 2, të Statutit të shoqërisë. Vendimet e marra prej saj për periudhën 2023 - 9 mujori 2025 paraqiten në tabelë:

Periudha	Mbledhjet e Asamblesë/Ortakut të vetëm	Vendime
Viti 2023	8	10
Viti 2024	10	10
Janar-Gusht 2025	5	5
TOTALI	**23**	**25**

***Burimi**: HEC Lanabregas SHA*

Referuar Regjistrit të mbledhjeve të Asamblesë, rezultoi se në të gjitha rastet për periudhën nën auditim, Asambleja është thirrur brenda afateve nga Kryetari dhe Zv/kryetari Këshilli i Mbikëqyrës, në përputhje me nenin 12, pika 1, të Statutit të shoqërisë.

☛Asambleja/Aksioneri i vetëm është asistuar rast pas rasti, nga Sekretari i Këshillit të Mbikëqyrës i cili kryen dhe funksionet e Sekretarit për Asamblenë. Asambleja/Aksioneri i vetëm, nuk ka emëruar një Sekretar, jo në përputhje me nenin 14, pika 1, të Statutit të shoqërisë.

☛Asambleja e Përgjithshme përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë UKT SHA, për periudhën nën auditim është shprehur me vendim në përputhje me nenin 11, pika 1, të Statutit të shoqërisë, kryesisht për:

- planin ekonomiko financiar (Vendimi nr. 40, datë 27.12.2023, nr. 6, datë 08.07.2024, nr. 10, datë 31.12.2024);

- pasqyrat financiare, (Vendimi nr. 33, datë 18.04.2023 për vitin 2022, Nr. 2, datë 03.04.2024 për vitin 2023 dhe Nr. 5, datë 20.06.2025 për vitin 2024);

- veprimtarinë shoqërisë (Vendimi nr. 7, datë 17.09.2024);

- emërimin e ekspertit/ve kontabël të autorizuar (Vendimi 32, datë 07.02.2023 dhe Nr.1, datë 14.02.2024).

☛Mbajtja e procesverbaleve të mbledhjes së Asamblesë, përgjegjësi e Sekretarit të saj, është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 15 të Statutit. Procesverbalet nga forma janë nënshkruar nga Aksioneri i vetëm dhe nga Sekretari i Asamblesë, në përputhje me nenin 15, pika 4 të Statutit;

☛Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm janë regjistruar në Regjistrin e vendimeve, në përputhje me nenin 15, pika 5, e Statutit.

<u>Konstatim</u>: Nga pikëpamja formale, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme mbi ndryshimet në strukturë, në pjesën arsyetuese të tyre, në asnjë rast nuk i referohen vendimit konkret të Asamblesë i cili pëson ndryshime duke mos pasur lidhje logjike pasi, nuk pasqyrohet numri ekzistues i punonjësve i cili rritet ose pakësohet në varësi të ndryshimeve të kërkuara.

Këshilli Mbikëqyrës (KM), është organi drejtues i shoqërisë që ushtron funksionet e mbikëqyrjes së shoqërisë, zgjidhet me një mandat 3 vjeçar dhe mblidhet jo më pak se 3 herë në vit dhe në mënyrë të jashtëzakonshme, sa herë që kërkohet nga K/Këshilli Mbikëqyrës, nga 1/3 e KM apo Administratori i shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës është mbledhur për periudhën nën auditim dhe ka marrë vendime pasqyruar në tabelë:

Periudha	Mbledhjet e Këshillit të Administrimit	Vendime
Viti 2023	9	10
Viti 2024	9	9
Janar-Gusht 2025	4	4
TOTALI	**22**	**23**

Burimi: HEC Lanabregas SHA

☛Për çdo mbledhje të Këshillit, janë mbajtur procesverbalet përkatëse, vendimet e marra nga KM pasqyruar në procesverbalet respektive janë nënshkruar nga Kryetari dhe Sekretari. KM ka mbajtur një Regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje i cili është nënshkruar për çdo mbledhje të mbajtur nga anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Për çdo mbledhje ka patur njoftim me shkrim jo më vonë se 3 ditë para mbledhjes dhe çdo njoftim është bërë në rrugë zyrtare/postë elektronike, në përputhje me nenin 20, pika 3, të Statutit të shoqërisë.

Me Vendimin Nr. 32, datë 01.02.2023 i ndryshuar KM, ka emëruar Sekretarin e tij, në përputhje me nenin 18, pika 3, të Statutit.

☞Këshilli Mbikëqyrës për periudhën objekt auditimi është shprehur me vendim në përputhje me nenin 19, të Statutit të shoqërisë për:
-pasqyrat financiare të shoqërisë;
-miratimin e planit ekonomiko financiar;
-realizimin e treguesve ekonomiko – financiar.

Konstatim: Nga pikëpamja formale, vendimet e Këshillit Mbikëqyrës mbi propozimet për ndryshimet në strukturë paraqitur nga Administratori i Shoqërisë për miratim në Asamble, në pjesën arsyetuese të tyre, në asnjë rast nuk i referohen vendimit konkret të Asamblesë i cili pëson ndryshime duke mos pasur lidhje logjike pasi, nuk pasqyrohet numri ekzistues i punonjësve i cili rritet ose pakësohet në varësi të ndryshimeve të kërkuara.

Emërimi i anëtarëve të KM. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për periudhën objekt auditimi është bërë me Vendimin Nr**.** 16, datë 01.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme/Aksionerit të vetëm, me ndryshimet respektive në përputhje me neni 10, pika 1, germa "b" dhe nenin 16, pika 1, të Statutit. Ai përbëhet prej 5 anëtarëve, si më poshtë:

1 (një) Kryetar - (i jashtëm)
1 (një) Zv/Kryetar- (përfaqësues nga UKT)
3 (tre) anëtar- (2 përfaqësues nga UKT dhe 1 (një) i jashtëm),

Anëtarë kanë zgjedhur mes tyre Kryetarin dhe Zëvendësin, në përputhje me nenin 18, pika 1 të Statutit.

Konstatimi:
1. Sipas Ligjit nr. 55/2015 "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 3, pika 15 dhe neni 8, pika 1, germa a), sektorë strategjikë në kuptim të këtij ligji, janë sektorët ekonomikë, të cilët konsiderohen nga shteti shqiptar me potencial të lartë për zhvillimin e ekonomisë së këtij vendi të vlerësuar si të tillë konsiderohet edhe sektori energjetik. Nisur nga ky përcaktim ligjor edhe shoqëria HEC Lanabregas, gëzon statusin e një shoqërie të sektorit strategjik dhe si e tillë krijimi dhe përbërja e Këshillit Mbikëqyrës bazohet në VKM nr. 570, datë 3.10.2018 "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionere Shtetërore", pika 1, germa b), ku sanksionohet në mënyrë eksplicite se "*Numri i anëtarëve të këshillave mbikëqyrës të shoqërive aksionere shtetërore që krijohen nga transferimi i ndërmarrjeve shtetërore të jetë:*
a) Gjashtë, për shoqëritë e sektorëve strategjikë me rëndësi të veçantë". Kjo shoqëri konsiderohet e tillë pasi është krijuar nga transferimi i ndërmarrjes shtetërore HEC Lanabregas në shoqëri aksionere.
Nëse i referohemi Statutit të vetë shoqërisë, neni 10, pika 1, germa "b", Këshilli Mbikëqyrës i HEC Lanabregas, përbëhet nga 5 anëtarë, gjë që bie në kundërshtim me VKM Nr. 570, datë 3.10.2018 pika 1, germa a), pasi në hierarkinë ligjore, VKM-ja është akt nënligjor ku për zbatimin e saj dalin aktet të tjera nënligjore siç është në rastin konkret statuti i shoqërisë.
2. Gjithashtu në statutin e Shoqërisë nuk është parashikuar detyrimi për plotësimin e deklaratës për konfliktin e interesit, pasi një detyrim i tillë i parashikuar në Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", duhet të përfshihet në këtë akt nënligjor pasi, "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, që shfaqet rast për rast dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë...". Veprimet e sipërme janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të aksionerëve/Aksionerit të vetëm bazuar në nenin 11, pika 1, germa "b", të Statutit të Shoqërisë, në të cilin përcaktohet qartë se "*Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e më poshtme të shoqërisë…. **ndryshime të statutit***…"

Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është bazuar në VKM nr. 570, datë 3.10.2018 "*Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Aksionere Shtetërore*", neni 1, germa "b".
Për vitin 2023, anëtarët e KM janë shpërblyer në vlerën 2,195,640 lekë ose 98.74% në krahasim me parashikimin në planin ekonomik të vitit 2023 në vlerën 2,223,631 lekë, *për vitin 2024*, janë shpërblyer në vlerën 3,229,200 lekë ose 100% referuar parashikimit të planit ekonomik të vitit 2024 në vlerën 3,229,200 lekë.

Konkluzion:
Nga auditimi mbi ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori), për periudhën objekt auditimi rezultoi se:

☞ nga pikëpamja formale, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me ndryshimet në strukturë, në pjesën arsyetuese të tyre, në asnjë rast nuk i referohen vendimit konkret të Asamblesë/Këshillit i cili pëson ndryshime duke mos pasur lidhje logjike pasi, nuk pasqyrohet numri ekzistues i punonjësve i cili rritet ose pakësohet në varësi të ndryshimeve të kërkuara.

☞ nuk është parashikuar në Statutin e Shoqërisë, detyrimi për plotësimin e deklaratës për konfliktin e interesit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;

☞ nuk ka emërim të Sekretarit për Asamblenë/Aksioneri i vetëm.

Veprimet e sipërme në kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për periudhën 2023-9 mujor 2025.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar HEC Lanabregas SH.A nuk janë paraqitur observacione.

2.2. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Struktura Organizative.
Shoqëria HEC Lanabregas Sh.A, ka në strukturë të saj: Asamblenë e Aksionarëve përfaqësuar nga Asisonari i vetëm/Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA, Këshillin Mbikëqyrës, Administratorin e Shoqërisë, Drejtorinë Administrative (*Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Sektori Ekonomik*), Drejtorinë Teknike (*Sektori i Mirëmbajtjes dhe Sektori i Prodhimit*), bazuar në Rregulloren e Brendshme "HEC Lanabgregas" Sh.A, miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr.15, datë 13.12.2016.
Referuar Statutit të shoqërisë, Administratori ka të drejtën e hartimit të strukturës organizative të shoqërisë e cila miratohet nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i vetëm, në përputhje me nenin 24, pika 1, germa "h" të Statutit të Shoqërisë.
Me vendimet respektive të Asamblesë së Përgjithshme janë miratuar strukturat organizative dhe ndryshimet, të cilat paraqiten në tabelë:

Viti 2023 Numri i punonjësve miratuar nga Asambleja e Përgjithshme aksionerëve/Aksioneri i vetëm (UKT)		
Periudha	**Nr. Punonjësve**	Vendimi Asamblesë së Përgjithshme
Prill 2016-Maj 2024	34	Nr. 12/2, datë 11.04.2016
Viti 2024/9 mujori 2025 Numri i punonjësve miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e aksionerëve/Aksioneri i vetëm (UKT)		
Periudha	Nr. Punonjësve	Vendimi Asamblesë së Përgjithshme
maj 2024-shtator 2025	43	Nr. 04, datë 16.05.2024

***Burimi**: HEC Lanabregas SHA*

Referuar të dhënave të tabelës konstatohet se:

☛Për periudhën maj 2024 – 9/mujori/ 2025, ka rritje të numrit të punonjësve si pasojë e ndryshimeve strukturore. Rritja totale e numrit të punonjësve shkon me (9) për vitin 2024 e në vijim, nga (34) që ishte nga viti 2023 deri në maj 2024.

Konstatimi: **1**.Referuar realizimit të treguesve Ekonomiko-Financiar për periudhën janar-dhjetor 2023, në relacionin shpjegues në pjesën III të planit ekonomik "Treguesit e punës", numri mesatar i punonjësve i parashikuar është (34), realizuar (numri faktik i punonjësve 28), ndërsa për vitin 2024, referuar realizimit të treguesve Ekonomiko-Financiar për periudhën janar-dhjetor 2024, në relacionin shpjegues në pjesën III të planit ekonomik "Treguesit e punës", numri mesatar i punonjësve i parashikuar është (34), realizuar (numri faktik i punonjësve) 31.17, ndërsa po ti referohemi Vendimit nr. 04, datë 16.05.2024 të Asamblesë numri mesatar i punonjësve duhet të jetë 43.

Gjithashtu në Planin Ekonomiko-Financiar për vitin 2025, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me Vendimin nr. 10, datë 31.12.2024, në pjesën III "*Treguesit e punës* ", numri mesatar i punonjësve për vitin 2025 është 34 (tridhjetë e katër) referuar strukturës së riorganizuar të Shoqërisë.
Për pasojë, ndryshimet në strukturë (ku nga 34 bëhet 43 punonjës) të miratuara me Vendimet respektive të Asamblesë së Përgjithshme për vitin 2024 dhe 2025, nuk pasqyrojnë drejt nevojat për rritjen e numrit të punonjësve, në raport me situatën ekonomiko financiare të Shoqërisë si dhe me situatën faktike të numrit të punonjësve, në kundërshtim me Vendimin Nr. 04, datë 16.05.2024 të Asamblesë së Përgjithshme.
Për vitin 2023, fondi i pagave (plan) është parashikuar 26,178,546.00 lekë, realizuar 21,388,103.00 lekë ose 81.70%.
Për vitin 2024, fondi i pagave (plan) është 28.653,650 lekë, realizuar është 27.981,220 lekë ose 97.65%.
Për periudhën janar-tetor 2025, fondi i pagave (plan) është 31,390,259 lekë dhe realizimi 23,859,408 lekë.

Për sa është trajtuar më sipër trajtuar nga subjekti i audituar është paraqitur observacion mbi Projektraportin e auditimit me shkresën nr. 143/1 prot., datë 11.06.2026 *(prot KLSH nr. 983/4, dt. 11.6.2026)*, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

"Me shkresën nr.113 prot., datë 10.05.2024, me lëndë "Relacion shpjegues mbi propozimet e ndryshimit të strukturës së HEC Lanabregas SH.A. drejtuar Këshillit Mbikqyeës .... janë detajuar të gjitha pozicionet e reja që jnë propozuar të krijohen…".Për këtë arsye duke qenë në gjendje të mirë financiare … ky propozim i iniciuar prej administratorit të shoqërisë është miratuar prej Këshillit Mbikëqyrës ….".

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Pretendimet e ngritura nga subjekti nuk argumentojnë qartë rritjen e numrit të punonjësve në raport me gjendjen financiare të shoqërisë dhe pse argumentimi lidhet me rritjen e treguesve ekonomiko financiarë por, fakti që numri i punonjësve nuk pëson ndryshime tregon për një raport jo të drejtë mes planit dhe realizimit. Për rrjedhorë observacioni **nuk merret në konsideratë**.

Rekrutimi i punonjësve.

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të "HEC Lanabgregas" Sh.A, rregullohen me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, kontratat individuale të punës si dhe Kontratën Kolektive nr. 168 prot., datë 02.04.2015.
Kontrata Kolektive e punës e lidhur me Sindikatën e Pavarur të Minatorëve të Shqipërisë datë 02.04.2015, nuk ka më fuqi juridike pasi ka mbaruar afati 10 vjeçar sipas përcaktimeve të nenit 4 të saj. Me mbarimin e këtij afati nuk rezulton të kenë filluar bisedime për ripërtëritjen e kontratës në përputhje me nenin 163, 164 dhe 165 të Kodit të Punës. Në Rregulloren e brendshme për

funksionimin e HEC Lanabregas, si dhe në kontratën individuale të punës, janë bërë përshkrimet e punës për çdo pozicion në mënyrë specifike, si dhe janë parashikuar rregullat e etikës në punë.

Konstatimi:
1. Në lidhje me rekrutimin e punonjësve, në Rregulloren e brendshme apo në ndonjë akt tjetër administrativ në lidhje me procedurat e shpalljes apo njoftimit për rekrutimin në punë, nuk janë parashikuar kritere të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në punë, shpallja e tyre bëhet rast pas rasti në varësi të nevojave për rekrutim.
2. Gjithashtu në Rregullore nuk parashikohet procedura e konkurrimit apo e pranimit në punë, si dhe procedura e publikimit të njoftimit për rekrutim në një pozicion të caktuar. Në kontratat individuale të punës është parashikuar vetëm dokumentacioni që duhet të paraqesë punëmarrësi në rastin e pranimit në punë. Nuk evidentohet të ketë raste të deklarimeve për vende të lira në të cilat të jenë të publikuara.
3.Në planet ekonomiko financiare për periudhën nën auditim, nuk është planifikuar numri i vendeve vakante të krijuara si rezultat i largimeve nga puna apo daljeve në pension, në një kohë që për vitin 2023, kemi 5 largime nga puna për arsye të ndryshme (4 me *dorëheqje, 1, dalje në pensin*), për vitin 2024, kemi 8 largime nga puna *(dorëheqje*) dhe për vitin 2025 kemi 3 largime nga puna (*dorëheqje*).

Për periudhën objekt auditimi rekrutimet e punonjësve paraqiten në tabelën më poshtë:

Nr. punonjësve	**Viti 2023**	**Viti 2024**	**9 mujori 2025**
	3	10	1
Totali	**14**		

***Burimi**: HEC Lanabregas SHA*

Dosjet e Personelit.

Konstatimi:
1. Në dosjet e personelit (përveç personelit teknik) nuk gjendet i administruar dokumenti "*raport mjekësor për aftësitë në punë*" sipas kërkesave për pranimin në punë të punonjësve parashikuar në kontratën individuale të punës, në kundërshtim me nenin 3, të kontratës individuale të punës.
2. Dosjet e personelit nuk përmbajnë vlerësimin për performancën në punë të punonjësve, si dhe listën e inventarit të dokumentacionit të administruar në dosje, jo në përputhje me Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Procedurat e ndjekur për dhënien në shpërblimeve.

Shoqëria HEC Lanabregas Sh.A, për periudhën nën auditim ka dhënë shpërblime ndarë sipas kategorive dhe nevojave (*shpërblim për fundviti, vdekje, sëmundje etj*.)
Për vitin 2023, vlera totale e shpërblimit miratuar me Vendim të Asamblesë së Aksionerëve nr. 30, datë 06.12.2022 "Për miratimin e Planit Ekonomiko-Financiar për vitin 2023" është parashikuar në vlerën 2,610,000 lekë. Me Urdhër të brendshëm të Administratorit HEC Lanabregas nr. 217 prot. datë 04.12.2023, është dhënë shpërblim për punonjësit për fundvitin në vlerën në vlerën 1,563,507 lekë.
Për vitin 2024, vlera totale e shpërblimit miratuar me Vendim të Asamblesë së Aksionerëve nr. 40, datë 27.12.2023 "Për miratimin e Planit Ekonomiko-Financiar për vitin 2024" është parashikuar në vlerën 3,070,000 lekë. Me Urdhër të brendshëm të Administratorit Nr.23, datë 21.11.2024, është dhënë shpërblim për punonjësit për fundvitin në vlerën 2,072,763 lekë, në përputhje me Nenin 13, pika 2, germa g) të Rregullores së Brendshme.
Nga auditimi i listë pagesave për periudhën nën auditim, rezultoi se shuma e përgjithshme e listë pagesave përputhet me vlerën e urdhër xhirimit përkatës. Përmbledhëset e listë pagesave në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamentit etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori.

Konkluzion:

Nga auditimi mbi strukturën organike për periudhën objekt auditimi, u konstatua:

☛Për periudhën maj 2024 – 9/mujori/2025, ka rritje (9) të numrit të punonjësve si pasojë e ndryshimeve strukturore nga (34) që për periudhën 2023-maj 2024, e cila nuk pasqyron drejt nevojat për rritjen e numrit të punonjësve, në raport me situatën ekonomiko financiare të Shoqërisë si dhe me situatën faktike të numrit të punonjësve.

☛ Në Rregulloren e brendshme apo në ndonjë akt tjetër administrativ në lidhje me procedurat e shpalljes apo njoftimit për rekrutimin në punë, nuk janë parashikuar kritere të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në punë, shpallja e tyre bëhet rast pas rasti në varësi të nevojave për rekrutim.

☛Në planet ekonomiko financiare nuk planifikohet numri i vendeve vakante të krijuara si rezultat i largimeve nga puna apo daljeve në pension.

☛Dosjet e personelit (përveç personelit teknik) nuk përmbajnë: dokumentin "*raport mjekësor për aftësitë në punë*" sipas kërkesave parashikuar në kontratën individuale të punës, vlerësimin për performancën në punë të punonjësve, listën e inventarit të dokumentacionit të administruar në dosje. *Veprimet e sipërme janë kompetencë e Administratorit, Drejtorisë Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe specialistit të burimeve njerëzore, arkivës dhe protokollit*.

2.3. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve operative, kapitale, administrative *(auditimin e procedurave me vlerë të vogël)*.

Më datë 04.01.2023 me urdhrin nr. 1 prot., titullari i autoritetit kontraktor O.I ka krijuar komisionin e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga *XH.K, A.A dhe K.F*.

Për vitin 2023, janë realizuar 18 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 9,622,083 lek për shërbime dezinfektimi, deratizimi, mirëmbajte të sistemeve kompjuterike, sigurimi i shëndetit dhe jetës për punonjësit, sigurimi i pronës, blerje kancelarie, kolaudim punimesh, blerje vaj transformatori, blerje materiale elektrike, mirëmbajtje të automjeteve etj. Për këto procedura janë lidhur kontratat me vlerë 7,990,008 lekë.

Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: *"Detergjente për mirëmbajtje"*, me date të zhvillimit 10.08.2023. Në listën për ofertë për mallrat e kërkuar janë përdorur emrat e markave, emërtimet janë jo të qarta dhe jo të plota. Në specifikimet teknike nuk janë përdorur standardet shqiptare sipas VKM-ve përkatëse. Lidhur me standardet kombëtare për kimikatet dhe detergjentet, këto përcaktohen në Ligjin nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", VKM nr. 488, datë 29.06.2016, "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", VKM nr. 669, datë 28.9.2011, "Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve të detergjenteve".

Në specifikimet e përgjithshme është kërkuar: *"Operatori ekonomik fitues për nënshkrimin e një kontrate/dorëzimin e faturës tatimore duhet të ketë:* ***Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit,*** *për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave. -Kopje të Certifikatës Elektronike të Fiskalizimit dhe* ***kopje të vlefshme të kontratës së lidhur me Kompaninë e Certifikuar për zgjidhjen softuerike në përdorim,*** *për tatimpaguesit që lëshojnë fatura përmes zgjidhjes së softuerit."*

Kritere të tilla janë jo thelbësore dhe jo të nevojshme për procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Në specifikimet e përgjithshme është kërkuar: "*Operatorit ekonomik të shpallur fitues do t'i kërkohet së bashku me dorëzimin e dokumentacionit provues edhe paraqitja e mostrave për artikujt Nr. 24, 25 dhe 26 të renditura si më sipër, me qëllim që produktet të jenë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga AK*."

Ky kriter është i tepërt pasi përputhshmëria e produkteve sipas specifikimeve nuk mund të bëhet me paraqitjen e mostrave por me plotësimin standardeve përkatëse ose me analiza laboratorike.

Për vitin 2024, janë realizuar 13 procedura të blerjeve me vlera të vogla me vlerë të fondit limit 5,639,862 lek për blerje veshje pune, blerje gomash, sigurim prone, blerje vaj transformatorësh, sigurimin e shëndetit dhe jetës së punonjësve, mirëmbajtje të sistemit kompjuterik, blerje kancelari, blerje detergjente dhe siguracion automjetesh. Vlera totale e kontratave të lidhura është 4,536,026 lek.

Më datë 03.01.2024 me urdhrin nr. 1 prot., titullari i autoritetit kontraktor O.I ka krijuar komisionin e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga *XH.K, A.A dhe K.F*.

Më datë 08.09.2024, me urdhrin 01/2 Prot., komisioni është ndryshuar në përbërjen me L.V, kryetare, dhe R.S e XH.K *anëtarë*.

Në vijim të kërkesës me nr. 388 Prot., datë 23.12.2024, të specialistit të logjistikës O.M, për shërbim dezinfektimi dhe deratizimi, dhe aprovimit të saj, titullari i AK ka urdhëruar komisionin e blerjeve me vlera të vogla për hartimin e specifikimeve teknike, kritereve të veçanta për kualifikimin e operatorëve ekonomik dhe përllogaritjen e fondit limit.

Në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit pika 2. janë kërkuar dhe ” ***2.*** *Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mëposhtme të akredituara nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

- ISO 9001:2015 mbi Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë;

- ISO 14001: 2015 mbi Sistemin e për Menaxhim Mjedisor;

- ISO 45001: 2018 mbi Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë;

- ISO 99:2012 mbi Sistemin e Menaxhimit te Integruar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e mësipërme, sipas natyrës së punimeve që marrin përsipër në aktmarrëveshjen e bashkëpunimit.”

Kritere të tilla janë jo thelbësore dhe jo proporcionale për procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Sa më sipër është në kundërshtim me nenin 40, “Kërkesat e veçanta” të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021).

Kërkesat e mësipërme janë jo thelbësore dhe jo të nevojshme për procedurat e blerjeve me vlera të vogla duke zvogëluar numrin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurë.

Komisioni i blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga *L.V, kryetare, dhe R.S e XH.K* anëtarë ka hartuar relacionin e përllogaritjes së fondit limit.

KPVV ka specifikuar shërbimet dhe ka bërë studimin e tregut për të marrë çmimet për këto shërbime. Çmimet për shërbim Dezinfektimi, Dezinsektimi, Deratizimi të HEC janë marrë në disa subjekte që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre kryerjen e shërbimeve për DDD. Fondi limit i përllogaritur është në vlerën 997,700 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatëmijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.

Më datë 13.01.2025 nga Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël të krijuar me Urdhrin nr. 20, datë 08.11.2024 për konfirmimin e operatorit ekonomik fitues për procedurën e prokurimit me objekt "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i HEC" është mbajtur proces verbali nr.5.

Ofertuesi i renditur i pari në klasifikim A. ShPK, me NUIS L5... me vlerë oferte 498,850 lekë pa TVSH, është njoftuar më datë 07.01.2025 nga sistemi elektronik se është fitues dhe për paraqitjen e dokumenteve sipas ftesës për ofertë. Operatori ekonomik A. ShPK më datë 08.01.2025 është paraqitur pranë "HEC Lanabregas" SHA me dokumentacionin fizik sipas ftesës për ofertë dhe dokumentacioni është pranuar nga KPVV.

Në zbatim të pikës 19, të Udhëzimit nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", ku përcaktohet se: "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, operatorët ekonomikë të refuzuar ose të renditur deri në vendin e dhjetë, kanë të drejtën të ankohen vetëm në autoritetin/entin kontraktor brenda 2 (dy) ditëve nga konfirmimi i njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe pikës 5, të manualit "Njoftim fituesi", nëpunësi autorizues ka konfirmuar operatorin ekonomik fitues në SPE. Më datë 13.01.2025 kanë përfunduar afatet e ankimit për operatorët

ekonomikë pjesëmarrës. Asnjë nga operatorët ekonomik nuk ka paraqitur ankesë për procedurën e prokurimit.
Për sa më sipër, KPVV ka konfirmuar se operatori ekonomik fitues për objektin "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi i HEC" është A. ShPK, i klasifikuar i pari në renditje, me vlerë oferte 498,850 lekë pa TVSH.
Më datë 13.01.2025 Autoriteti Kontraktor me nr. 388/8 Prot., ka lidhur kontratën e shërbimit me OE A. ShPK me Nipt L.... me vlerë 498,850 lekë pa TVSH dhe 598,620 lekë me TVSH.
Nga shqyrtimi i fondit limit të procedurës dhe procesit të ofertimit konstatohet se vlera e ofertës fituese është 50 % ose sa ½ e vlerës së fondit limit të përllogaritur nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla. Procesi i testimit të tregut nuk është i besueshëm dhe i saktë duke sjellë rritje të panevojshme të fondit limit efektet e të cilit ndikojnë në ekonomicitetin e shfrytëzimit të burimeve financiare të HEC Lanabregas.
Me kërkesën nr. 118 prot., datë 16,4,2025, të specialistit të logjistikës O.M, Zyra e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore e HEC Lanabregas Sh.A, bazuar në parashikimin vitit 2025, si dhe nevojës për pasjen e siguracioneve të automjeteve ka kërkuar kryerjen e shërbimit si vijon: Siguracioni vjetor TPL për 4 automjete, si dhe për automjetin KIA Sportage me targë AB ... KL siguracion ndërkombëtar (Kartoni jeshil), siguracion Full Kasko si dhe për vjedhje brenda dhe jashtë Shqipërisë.
Pas kërkesës së mësipërme titullari i AK ka miratuar kërkesën e zyrës së shërbimeve dhe burimeve njerëzore dhe me shkresën nr. 118/2 ka urdhëruar komisionin e blerjeve me vlera të vogla për hartimin e specifikimeve teknike, kritereve të veçanta për kualifikimin e operatorëve ekonomik dhe përllogaritjen e fondit limit.
Me procesverbalin nr. 2 komisioni pasi ka testuar tregun ka konkluduar se vlera e fondit limit është 538,861 lekë pa TVSH. Më datë 18.04.2025 titullari i AK ka urdhëruar zhvillimin e procedurës për siguracionin e automjeteve.
Në specifikimet teknike është kërkuar dhe shërbimi me GPS, kërkesë jo në përputhje me objektin e procedurës që është sigurimi i automjeteve.
Në ftesën për ofertë, në pikën 5 të tabelës së çmimeve përshkrimi i shërbimit është "Siguracion ndërkombëtar (karton jeshil) për mjetin KIA Sportage me targë AB ... KL dhe sasia 1. Komisioni nuk ka përcaktuar periudhën e sigurimit (javë, muaj, ditë).
Përcaktimi i marrjes së siguracionit ndërkombëtar për 1 vit në vlerën 400 euro është shpenzim jo në përputhje me parimet e eficiencës dhe efektivitetit pasi nuk ka arsye të paguhet për një periudhë 1 vjeçare, në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenet 1,2,3 dhe 12. Më datë.06.01.2025 me urdhrin nr. 1 Prot., titullari i autoritetit kontraktor F.S ka krijuar komisionin e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga *L.V, kryetare, dhe R.S e XH.K anëtarë.*
Më datë 14.04.2025 me urdhrin nr. 01/1 Prot., titullari i autoritetit F.S, ka ndryshuar përbërjen e komisionit me R.S kryetar, A.P dhe XH.K anëtarë.
Për periudhën e 9-mujorit 2025, janë zhvilluar 4 procedura të blerjeve me vlera të vogla për siguresa, kolaudime të ndryshme, sigurancione automjetesh dhe blerje filtra vaji për mirëmbajtjen e automjeteve me një vlerë të fondit limit 2,170,438 lek dhe vlerë të kontratave të lidhura 1,747,953 lekë.
Për periudhën 01.01.2023 – , shoqëria HEC Lanabregas ka lidhur kontratë me shoqërinë V. për shërbimin e telefonisë për 24 numra celulari. Në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës aprovimi është për vetëm tre pozicione në administratën e shoqërisë si dhe janë përcaktuar kuotat për disbursim.
Dhënia e garancisë ndaj shoqërisë V. për mbulimin e shpenzimeve për të gjithë numrat e kontraktuar përfshirë dhe pozicionet e tjera jo të aprovuara në vendimin e KM, ekspozon shoqërinë për efekte të mundshme ekonomike negative.
Këto veprime janë bërë në kundërshtim me LPP, si dhe pikat 12 dhe 14 të VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "*Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik*". ku përcaktohet: *"..12. Drejtuesit e shoqërisë tregtare, me kapital 100% shtetëror, kanë të drejtë të urdhërojnë*

pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe në varësi të mundësive financiare që kanë, të miratuar nga organet përkatëse, sipas specifikimeve të mësipërme. Shpenzimet për këtë shërbim, në nivel vjetor, të jenë në çdo rast jo më shumë se 2% e totalit të shpenzimeve administrative, të miratuara në planin financiar përkatës.," , dhe pikës 14. ku përcaktohet se*: "Për përfitimin e shërbimit funksionarët e përcaktuar në pikat 5–12 të këtij vendimi, lidhet kontratë individuale me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm që veprojnë në vend, për një numër të vetëm celular. Detyrimi financiar paguhet nga funksionari i cili kompensohet nga institucioni, kundrejt dokumentit të blerjes së shërbimit të numrit telefonik celular, por jo më shumë se kufijtë përkatës mujorë."*
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi administratori i shoqërisë dhe anëtarët e komisioneve të blerjeve me vlera të vogla*: XH.K, A.A dhe K.F, L.V, R.S.*

2.4. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 30.09.2025, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e tipologjisë se procedurave të prokurimit, llogaritjen e fondit limit, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.
Dokumentacioni i shqyrtuar në auditim*:*

- *Regjistri i prokurimeve për periudhën 01.01.2023 – 30.09.2025;*
- *Dokumentacioni i OE të shpallur fitues dhe të paraqitur në sistemin e APP;*
- *Dosja e procedurës së auditimit të sipërcituar;*
- *Dokumentacioni i prokurimit në sistemin elektronik të APP;*
- *Dokumentacioni mbi përllogaritjen e fondit limit.*

Regjistrat e planifikimit dhe të realizimit të prokurimeve, janë dërguar në APP nëpërmjet sistemit elektronik, si dhe për çdo ndryshim të kryer në to gjatë vitit financiar, në zbatim me nenet 3 dhe 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Nga grupi i auditimit nëpërmjet shkresave në zbatim të programit të auditimit (pika 4), është kërkuar informacion mbi regjistrin e planifikimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2023 – . E konkretisht:
Për vitin 2023, janë parashikuar gjithsej 34 procedura prokurimi me fond limit 57,942 mijë lekë, nga e cila: me vlerë të lartë 4 procedura prokurimi me fond limit 45,896 mijë lekë dhe me vlerë të vogël janë 30 procedura prokurimi me fond limit 12,046 mijë lekë. Janë realizuar gjithsej 22 procedura prokurimi me fond limit 55,518 mijë lekë, duke mos bërë të mundur realizimin e 12 procedura me fond limit 2,424 mijë lekë të llojit blerje me vlerë të vogël, kjo për mungesë fondi.
Për vitin 2024, janë parashikuar gjithsej 30 procedura prokurimi me fond limit 46,577 mijë lekë, nga e cila: me vlerë të lartë 2 procedura prokurimi me fond limit 37,745 mijë lekë dhe me vlerë të vogël janë 28 procedura prokurimi me fond limit 8,832 mijë lekë. Janë realizuar gjithsej 15 procedura prokurimi me fond limit 43,384 mijë lekë, duke mos bërë të mundur realizimin e 15 procedura prokurimi me fond limit 3,193 mijë lekë të llojit blerje me vlerë të vogël, kjo për mungesë fondi.
Për periudhën e 9/mujorit/2025, janë parashikuar gjithsej 36 procedura prokurimi me fond limit 14,673 mijë lekë, nga e cila: me vlerë të lartë 3 procedura prokurimi me fond limit 6,407 mijë lekë dhe me vlerë të vogël janë 23 procedura prokurimi me fond limit 8,266 mijë lekë. Janë realizuar gjithsej 4 procedura prokurimi me fond limit 2,170 mijë lekë me vlerë të vogël, duke mos bërë të mundur realizimin e 4 procedura me fond limit 6,407 mijë lekë me vlerë të lartë dhe 16 procedura

me fond limit 6,096 mijë lekë me vlerë të vogël, të dhëna të cilat paraqiten në Aneksin 4.1, 4.2, 4.3, 4.4 dhe 4.5 bashkëlidhur PRA.
Grupi i Auditimit mbi bazën e materialitetit dhe riskut për periudhën objekti auditimi 01.01.2023 – 30.09.2025, bëri vlerësimin e procedurave për auditim, ku nga 6 procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit 83,641 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim 4 procedura prokurimi me fond limit 80,914 mijë lekë 96.7% e fondit të prokuruar, nga e cila: **<u>3</u>** procedura për vitin 2023 dhe **1 (një)** procedurë për vitin 2024.

Nga auditimi rast pas rasti, kemi këtë situatë:

1- Procedura me objekt: *"Rikonstruksion i seksionit 6KV në Hec-Lanabregas faza e dytë, Viti 2023".*

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i procedurës "Rikonstruksion i seksionit 6KV në Hec-Lanabregas faza e dytë".</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 131/1, dt. 01.8.2023.</td><td rowspan="2">2. Komisioni ST: nuk ka

2.1. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit (NJP) nr. 131/1, dt. 01.8.2023
1- F.D
2- K.F
3- A.A</td><td rowspan="2">3. Komisioni i vlerësimit të ofertave nr. 131/2 prot, dt. 3.8.2023:
1- XH.K
2- A.S
3- A.P.</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i procedurës
"E hapur me mjete elektronike, referuar nenin 42 të LPP dhe nenit 47 të VKM nr. 285, dt. 19.5.2021 "Për RrPP"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi limit
35,866,371 lekë pa TVSh
REF-77437-08-15-2023</td><td>6. Oferta fituese:
BOE "I." ShPK, me vlerë oferte 34,731,300 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
1,135 mijë lekë ose 3.1% e fondit të prokuruar.</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së procedurës
Datë 01.9.2023 me afat zbatimi 3 muaj, i ndryshuar me shtojcën nr. 140/4 prot, dt. 24.8.2023 për datën 8.9.2023</td><td>9. Burimi i financimit
Të ardhurat e HEC- Lanabregas</td><td>10. Operator Ekonomik.
a) Pjesëmarrës 3 OE
b) S'kualifikuar 2 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK:
JO</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK:
JO</td><td>13. Përgjigje nga APP apo KPP:
JO</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës
Nr. 208, datë 24.11.2023, me afat zbatimi 3 MUAJ nga data e nënshkrimit</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSH):
34,563,000 lekë</td><td></td></tr>
</table>

Me shkresën nr. 131 prot, datë 28.7.2023, nga Përgjegjësi i sektorit të Prodhimit është bërë kërkesë për realizimin e procedurës, në adresë të Administratorit të shoqërisë "Hec-Lanabregas" O.I, e shoqëruar dhe me preventivin përkatës. Me urdhër nr. 131/1 prot, datë 01.8.2023 të administratorit është urdhëruar zhvillimi i procedurës me objekt "*Rikonstruksion i seksionit 6KV në Hec-Lanabregas faza e dytë*", me fond limit 35,866,371 lekë pa TVSh.
Sipas të dhënave të dosjes, konstatohet se nga titullari i AK (O.I), është përcaktuar personi përgjegjës për procedurën (K.F referuar shkresës nr. 01/1 prot, datë 4.01.2023 të titullarit të AK, paraqitur në observacionet e subjektit). Evidentohet fakti se dosja fizike e cila përmban procesverbale për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurën e përcaktimit të fondit limit dhe fituesit, etj., nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes për të gjithë përmbajtjen e tyre, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor të R.SH, si dhe të shoqëruara me inventarë paraprak dhe të numëruara në çdo faqe, në kundërshtim me germën g) të nenit 8- "*Përpunimi tekniko-shkencor i DT*", të Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritet publike në R.SH", të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi personin përgjegjës të procedurës K.F.*

<u>Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikues</u>. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës, rezultoi se nga NJP është mbajtur procesverbali *140/1 prot, datë 14.8.2023* "për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim", ku konstatohet se kriteret e aplikuara dhe specifikimet teknike janë në përputhje me tipologjinë e procedurës dhe dispozitat e LPP, respektivisht të nenit 77- Kërkesa për kualifikim.

<u>Zhvillimi procedurës</u>. Referuar dokumentacionit në dosje, konstatohet se me procesverbal nr. 140/6 prot, datë 8.9.2023 është bërë hapja e procedurës nga KVO-ja në prani të anëtarëve të Nj.P. Sipas këtij procesverbali kanë shprehur interes për pjesëmarrje 3 OE, konkretisht:

1- *Shoqëria A. ShPK me Nipt L...F me ofertë 35,250,534 lekë (**skualifikuar**);*
2- *Shoqëria H. ShPK me Nipt K...D me ofertë 28,334,050 lekë (**skualifikuar**);*
3- *B/OE I. me Nipt L...Q/L...G me ofertë 34,731,300 lekë (**kualifikuar/fitues**).*

Referuar faqes së APP, asnjë nga OE pjesëmarrës nuk është i përjashtuar nga procedurat e prokurimit. Me procesverbal nr. 140/7 prot, datë 18.9.2023, nga KVO-ja është bërë vlerësimi, ku nga 3 OE pjesëmarrës janë skualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 (një) OE, konkretisht është kualifikuar me kritere të plotësuara B/OE I. ShPK me ofertë 34,731,300 lekë, siç tregtohet në tabelën sipër:

- **<u>Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm</u>***:*

*1- **Operatori Ekonomik H. ShPK**, për faktin se:*

***- Nuk plotëson pikën 1.a.** "Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit", sipas shtojcës 8, ku OE nuk ka plotësuar saktë/siç është kërkuar Shtojcën 8 - Formulari përmbledhës i Vetëdeklarimit, në kundërshtim me Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit piken B. DEKLARATA, pika 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt, ne Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit A: DEKLARATË, OE ka deklaruar "Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor", ndërkohë që është kërkuar të deklarohet si në vazhdim: "Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.". Në këtë rast, deklarata e OE nuk është e plote dhe e saktë në çdo aspekt.*

***- Nuk plotëson piken 2.3 Kapaciteti Teknik: "2.3.1** Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën: a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. ose b. Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH)". Kontrata e paraqitur si pune e ngjashme nga OE nuk është kontrate punimesh, por kontratë furnizimi mallrash, siç është cilësuar dhe në kontratën mes palëve H. ShPK dhe "F" ShPK e paraqitur nga OE, dhe në certifikatat e marrjes ne dorëzim të mallrave që OE ka furnizuar nëpërmjet kësaj kontrate.. Pra, (i) objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), (ii) duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% dhe (iii) duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej këtyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Në këtë rast OE nuk ka dorëzuar asnjë dokument që vërteton se ka kryer punë të ngjashme të realizuara me sukses.*

***- Nuk plotëson piken 2.3.5, pika 1**:"Autorizim të prodhuesit/ve/distributorit të autorizuar për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëebsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij". OE ka paraqitur autorizim nga distributori "Albaelettrica", nga i cili është i autorizuar vetëm për produktet: Kabllo te kontrollit te tensionit te ulet, kapikorda CU-Al me seksion 35-150mm2, kapikorda CU me seksion 35-150mm2 dhe rrjedhimisht nuk përfshin autorizimin për mallrat: Pjesët rezerve: Çelës fuqie i tipit me tërheqje. Un=6/7.2 kV, 630A, 25kA/3s (për pjese rezerve), Bobina ckyçje për çelësin 6/7.2 kV, Bobina kyçje për çelësin 6/7.2 kV, Bobine cbllokimi e karrocës se çelësit 6/7.2 kV, Kontakte ndihmese për pjesën e lëvizshme te çelësit 6/7.2 kV, Kontakte për pjesën fikse te çelësit 6/7.2 kV, Motor për kërkimin e sustës se çelësit 6/7.2 kV, Transformator tensioni 6 kV të çelës se gjeneratorit sipas specifikimeve teknike, Transformator tensioni 6 kV*

të çelës se matjes sipas specifikimeve teknike, Rele mbrojtje inteligjente elektronike për mbrojtjen e gjeneratorit (për pjese rezerve), Siguresa 6/7.2 kV63A, Siguresa 6/7.2 kV16A.
- Nuk plotëson piken 2.3.5, pika 2. *"Katalog/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedë teknike të prodhuesit për listën e materialeve të mësipërme që do të ofrohen, në të cilën të paraqiten të dhënat teknike bazë të përkthyera në gjuhën shqipe". Skeda teknike e paraqitur për çelat tregon mospërputhje me dimensionet e çelës nga ato qe janë kërkuar, pasi është kërkuar me dimensione 800*2300*1500mm, ndërkohë OE ka ofertuar dimensionet 600*2510*1550. Siç është cilësuar dhe ne specifikimet teknike, faqe 3, paragrafi i fundit: Dimensionet janë te rëndësishme të jenë fikse, në mënyrë që të përshtaten me dimensionet e çelave ekzistuese. Mospërshtatja me dimensionet e çelave ekzistuese mund te çojë ne pamundësi te montimit te zbarave ndërmjet çelave te reja dhe atyre ekzistuese.*

2- Operatori Ekonomik A. ShPK*, për faktin se:*

Nuk ka ngarkuar në Sistemin e Prokurimeve Publike asnjë dokument që vërteton kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë:
Pika 1.a*. nuk ka paraqitur sigurim oferte;*
Pika 2.1.1 *nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 45001: 2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë";*
Pika 2.3.1 *nuk ka ngarkuar asnjë dokument që tregon përvojën me punët e ngjashme të mëparshme;*
Pika 2.3.2 *nuk ka paraqitur Deklaratë për Drejtuesin Teknik;*
Pika 2.3.3 *nuk ka deklaruar Drejtues Teknik Ing. Mekanik në Formularin e Vetëdeklarimit;*
Pika 2.3.4 *nuk përmbush minimumin prej 10 punonjësish të punësuar pranë shoqërisë për 3 muajt e fundit, sipas të dhënave të Shtojcës Nr. 8;*
Pika 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7 *nuk ka ngarkuar asnjë dokument në lidhje me kriteret e përcaktuara.*

Sipas grupit të auditimit, nga verifikimi i dokumentacion mbi vlerësimin e KVO-së për skualifikimin e OE si mësipërm, grupi shpreh dakortësinë se vlerësimi është i saktë, ***pasi OE e s'kualifikuar nuk plotësonin kriteret kualifikuese për të cilat ato janë s'kualifikuar.***

*** * ***

Referuar procedurës së lartpërmendur, B/OE "I." me NIPT L...Q & L...G sipas KVO plotëson kriteret e DST, dhe se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 34,731,300 lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.
Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak). **Nuk ka.**
Me shkresën nr. 140/8 prot, datë 18.9.2023 nga KVO-ja është plotësuar formulari i njoftim fituesit paraprak. Me shkresën nr. 140/9 prot, datë 29.9.2023 është plotësuar formulari i njoftim fituesit përfundimtar, dhe me shkresën nr. 169 prot, datë 29.9.2024, është hartuar Raporti Përmbledhës në adresë të titullarit të AK, dhe miratuar prej tij.
Në respektim të afateve ligjore midis AK "Hec- Lanabregas" SHA përfaqësuar nga O.I dhe B/OE "I." ShPK është lidhur kontrata e zbatimit nr. 208 prot, datë 24.11.2023. Me shkresën nr. 208/1 prot, datë 24.11.2023 është plotësuar njoftimi i kontratës.

Vlerësimi i procedurës. Referuar dokumentacionit në dosjen e auditimit (dokumentet e OE), dhe të dhënëve të sistemit, mbi OE të shpallur fitues, sipas vlerësimit të grupit të auditimit, KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt OE fitues, duke e shpallur dhe lidhur kontratë me një OE në kushtet e mos plotësimit të të gjitha kritereve të DST. E konkretisht:
Sipas grupit të auditimit B/OE "I." ShPK, ka mangësi në këto kritere:
Nga shoqëria I. ShPK, nuk plotësohet pika 2.3.6 për kategoritë e licencës NP-11/B dhe NS-14/B, pasi referuar kontratës së bashkëpunimit nr. 4359rep/1100kol, datë 7.9.2023 (neni 3), shoqëria ka marrë përsipër 48.5% të volumit të punimeve, dhe duhet të jetë e disponushme licenca me kategoritë e kërkuara (NP-11/B dhe NS-14/B).
Për sa trajtuam më sipër, KVO-ja nuk ka vlerësuar saktë, pasi B/OE i shpallur fitues nuk është në plotësim të të gjitha kritereve të DST. Nisur nga fakti dhe në kushtet kur në garë nuk ka OE me dokumentacion të rregullt, KVO-ja duhet të anulonte procedurës dhe vijonte me procedurën e re, me kushte më favorizues, kjo për të rritur numrin e pjesëmarrësve në procedurë e cila do çonte në

përdorim më efektiv të fondit të prokuruar, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, **Neni 2** i ku përcaktohet: "*Qëllimi i këtij ligji është... b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve ...; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë OE, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik....", **Neni 3 pika 1,** ku përcaktohet: "*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për OE, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale*....", **Neni 92 pika 3 dhe 4**, ku përcaktohet: "*Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit*"**.**
Personat përgjegjës për vlerësimin e procedurës: XH.K, A.S dhe A.P, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar HEC-Lanabregas janë paraqitur observacioni me shkresën nr. 143/1 prot, datë 11.06.2026 *(prot KLSH nr. 983/4, dt. 11.06.2026)* "*Mbi Projekt Raportin e Auditimit*" nga F.S me detyrë Administrator i shoqërisë HEC-Lanabregas, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subiektit</u>:

Në lidhje me konstatimin se shoqëria "I..." sh.p.k nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6 të DST për kategoritë e licencës NP-11/B dhe NS-14/B, sqarojmë se operatori ekonomik ka marrë pjesë në procedurë në bashkim me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë, bazuar në Akt-marrëveshjen Nr. 4356 Rep., Nr. 1109 Kol., datë 07.09.2023.

Sipas Akt-Marrëveshjes së bashkëpunimit janë përcaktuar qartë detyrat, përgjegjësitë dhe përqindjet e realizimit të kontratës për secilin anëtar. Shoqëria "I..." sh.p.k është përcaktuar për realizimin e pjesës së furnizimit të pajisjeve dhe materialeve elektrike, ndërsa shoqëria "M..." sh.p.k është përcaktuar për realizimin e punimeve të instalimit, montimit dhe zbatimit të punimeve ndërtimore e elektrike.

Shoqëria "M..." sh.p.k disponon licencën profesionale të vlefshme në kategoritë NP-11/B dhe NS-14/B duke përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.6 të dokumenteve të tenderit për pjesën e punimeve që mbulohen nga këto kategori licence.

Për rrjedhojë, kriteri nuk është vlerësuar mbi bazën e një operatori të vetëm, por mbi bazën e kapaciteteve të bashkuara të BOE-së, në përputhje me Akt-Marrëveshjen dhe legjislacionin e prokurimit publik, i cili lejon që anëtarët e bashkimit të mbështeten në kapacitetet profesionale dhe licencat e njëri-tjetrit për realizimin e pjesëve përkatëse të kontratës. Për sa kohë licencat e kërkuara ekzistojnë Brenda BOE-së dhe mbulojnë pjesën e punimeve të marrë përsipër nga anëtari përkatës, kriteri I pikës 2.3.6 konsiderohet I përmbushur.

Në lidhje me certifikatat e kërkuara bashkimi i operatorëve në kontratën e lidhur me (Akt-Marrëveshjen) Nr.repertori 4359, Nr. koleksioni 1109 dt 07/09/2023 specifikohet në Nenin 1 ku shprehet se Bashkimi i Operatorëve bashkojnë kapitalet, licencat, bilancet etj.

Sa më sipër Neni 3 pika 3.2 sqaron se Shoqëria "I..." sh.p.k si operator i specializuar në fushën e furnizimeve përfshirë këtu eksperiencat e mëparshme të ngjashme të realizuara me sukses të pasqyruara dhe në xhiron e shoqërisë, staf i reduktuar dhe mungesame licencës profesionale në kategorinë NP-11/B NS-14/B përkatëse e bën operatorin të kualifikuar vetëm për pjesën e furnizimit të pjesëve të Seksionit I Pajisje dhe Materiale TM.....

Shoqëria "M..." sh.p.k si operator i pajisur me licencën (MIE) në kategorinë NP-11/B dhe NS-14/B përkatëse për instalim,ndërtim,montim,aftësitë punëtore, specialistët dhe inxhinierët, si dhe eksperienca shumëvjeçare në fushën e ndërtimit etj.....

Mjeti me targë AB…E më kontratë qiraje me shoqërinë "I...", i mungon certifikata e kontrollit teknik (kërkese DST)

Në lidhje me konstatimin se mjeti me targë AB…E, i vënë në dispozicion nëpërmjet kontratës së qirasë me shoqërinë "I...", nuk disponon certifikatën e kontrollit teknik sipas kërkesave të DST-së, ju bëjmë me dije se nuk qëndron.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se për mjetin në fjalë është depozituar certifikata e kontrollit teknik e vlefshme, e cila provon se mjeti ka kaluar kontrollin teknik periodik dhe plotëson kushtet ligjore për qarkullim dhe përdorim. Dokumenti përkatës ka qenë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik dhe gjendet i administruar në dosjen e procedurës.
Gjithashtu, qëllimi i kërkesës së DST-së për paraqitjen e certifikatës së kontrollit teknik është të verifikohet disponueshmëria dhe aftësia operacionale e mjetit për realizimin e kontratës. Ky qëllim është përmbushur plotësisht, pasi dokumentacioni i paraqitur vërteton se mjeti është i ligjshëm për përdorim dhe mund të angazhohet në realizimin e punimeve objekt kontrate.
Sa më sipër, Komisioni vlerëson se mjeti me targë AB…E plotëson kërkesën e DST-së lidhur me kontrollin teknik dhe se pretendimi për mungesë të certifikatës nuk qëndron.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Për sa keni observuar, grupi i auditimit pasi analizoi me kujdes ato, arrin në përfundimin se pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore, pasi nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazë terreni dhe të observimeve të akteve. Gjithashtu mangësitë e evidentuara për dokumentacion të cilat nuk ishin pjesë e dosje së procedurës dhe të paprotokolluara nuk vërtetojnë origjinalitetin e tyre nëse kanë qenë të disponushme gjatë fazës së vlerësimit të procedurës nga KVO-ja ose jo. **Në këto kushte procedura mbetet me shkelje në vlerësim**.

2- Procedura me objekt: "*Zëvendësim i paneleve të kontrollit, Sinkronizimit, Mbrojtjes dhe Pajisjeve Matëse të Agregateve AG.1/AG.2 me sistem digjital SCADA*".

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i procedurës “Zëvendësim i paneleve të kontrollit, Sinkronizimit, Mbrojtjes dhe Pajisjeve Matëse të Agregateve AG.1/AG.2 me sistem digjital SCADA”.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 49, prot, dt. 26.2.2024.</td><td rowspan="2">2. Komisioni ST, nr. 39/1, dt. 13.2.2024:
1. O.M
2. A.H
3. A.V

2.1. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit (NJP) nr. 49, dt. 26.2.2024
1- XH.K
2. K.F
3. A.A</td><td rowspan="2">3. Komisioni i vlerësimit të ofertave nr. 49/:
1. A.S
2. A.L
3. S.C</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i procedurës
“E hapur me mjete elektronike, referuar nenin 42 të LPP dhe nenit 47 të VKM nr. 285, dt. 19.5.2021 “Për RrPP”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi limit
36,745,000 lekë pa TVSh
REF-97575-03-06-2024</td><td>6. Oferta fituese:
JV “L. + A.” ShPK, me vlerë oferte 35,616,225 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
1,129 mijë lekë ose 3% e fondit të prokuruar.</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së procedurës
Datë 25.3.2024 me afat zbatimi 3 muaj, nga nënshkrimi i kontratës</td><td>9. Burimi i financimit
Të ardhurat e HEC- Lanabregas</td><td>10. Operator Ekonomik.
a) Pjesëmarrës 3 OE
b) S’kualifikuar 2 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK:
JO</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK:
JO</td><td>13. Përgjigje nga APP apo KPP:
JO</td></tr>
<tr><td>14. Formularë njoftimi:
- Njoftim paraprak nr. 79/2, dt. 3.4.2024;
- Njoftim përfundimtar 79/3, dt. 26.4.2024;
- Raporti përmbledhës nr. 79/4, dt. 26.4.2024</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSH):
35,616,225 lekë</td><td>16. Lidhja e kontratës
Nr. 141, datë 14.6.2024, me afat zbatimi 5 MUAJ nga data e nënshkrimit</td></tr>
</table>

Me shkresën nr. 39/1 prot, datë 13.2.2024 të titullarit të AK (O.I), është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim lidhur me kapacitet teknike, i përberë nga O.M, A.H dhe A.V. Sipas të dhënave të dosjes, konstatohet se nga titullari i AK (O.I), është përcaktuar personi përgjegjës për procedurën (*K.F referuar shkresës nr. 01/1 prot, datë 4.01.2023 të titullarit të AK, paraqitur në observacionet e subjektit*). Evidentohet fakti se dosja fizike e cila përmban procesverbale për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurën e përcaktimit të fondit limit dhe fituesit, etj., nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes për të gjithë përmbajtjen e tyre, në kundërshtim me nenet 21,58,59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor të R.SH, ku fletët nuk janë të shoqëruara me inventarë paraprak dhe të numëruara në çdo faqe, në kundërshtim me germën g) të nenit 8- “Përpunimi tekniko-shkencor

i DT", të Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritet publike në R.SH", dhe me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi personin përgjegjës të procedurës (K.F).*

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikues. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës, rezultoi se nga NJP është mbajtur procesverbali nr. 49/1 prot, datë 05.03.2025 "për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim", ku konstatohet se kriteret e aplikuara dhe specifikimet teknike janë në përputhje me tipologjinë e procedurës dhe dispozitat e LPP, respektivisht të nenit 77- Kërkesa për kualifikim.

Zhvillimi procedurës. Referuar dokumentacionit në dosje, konstatohet se me procesverbal nr. 79 prot, datë 25.03.2024 është bërë hapja e procedurës nga KVO-ja në prani të anëtarëve të Nj.P. Sipas këtij procesverbali në këtë procedurë kanë shprehur interes për pjesëmarrje 3 OE, konkretisht:

*1- Shoqëria N. ShPK me Nipt K...O dhe ofertë 34,838,496 lekë **s'kualifikuar**);*
*2- B/OE "L.+A."ShPK, me Nipt L...S/L8...16F dhe ofertë 35,616,225 lekë (**kualifikuar/fitues**);*
*3- Shoqëria M. ShPK me Nipt L...G dhe ofertë 36,263,375 lekë (**s'kualifikuar**).*

Referuar faqes së APP, asnjë nga OE pjesëmarrës nuk është i përjashtuar nga procedurat e prokurimit.

Me procesverbal nr. 79/1 prot, datë 29.3.2025, nga KVO-ja është bërë vlerësimi, ku nga 3 OE pjesëmarrës janë s'kualifikuar 2 OE dhe kualifikuar 1 OE, konkretisht B/OE " L. + A." ShPK me ofertë 35,616,225 lekë, siç tregohet më sipër.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Shoqëria N. ShPK, për arsyet e mëposhtme:

Referuar Kritereve te Veçanta te Kualifikimit, te pasqyruara ne DST eTenderit, sqarojmë se:
a) *Oferta ekonomike e paraqitur nga OE konsiderohet e pasaktë pasi në Shtojcën 1- **Formularin e Ofertës** dhe Shtojcën 2 – **Lista e çmimeve të artikujve** ,nuk i ka paraqitur sipas formateve të përcaktuara në shtojcat përkatëse të llojit te procedurës "E hapur – Pune", sipas te cilave janë hartuar dokumentet e tenderit te publikuar ne APP. Specifikisht ne Shtojcën 1, pika c) ka cituar: "Ne ofrojmë ti furnizojmë Autoritetit Kontraktor HEC Lanabregas SHA ne përputhje me Dokumentet e Tenderit, **mallrat** për 45232200-4- Punime ndihmese për linja te energjisë elektrike ne përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura ne Listën e Artikujve dhe ne përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, te cilat reflektohen ne Dokumentet e Tenderit", ndërkohë ne DST citohet "Ne ofrojmë të realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), **punimet** për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit". Persa i përket pikës d) ka pasaktësi, pasi ne Shtojcën e plotësuar nga OE nuk janë pasqyruar te 10 pikat te renditura sipas DST por vetëm 7 prej tyre. KVO gjykon se në rastin konkret jemi ne kushtet e mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumenteve të procedurës objekt prokurimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligj zbatuese. Për këtë shkak shtojca 1 e dorëzuar nga operatori ekonomik nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për t'u plotësuar. Në rast se, operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor të parashikuar nga neni 75 i LPP-së.*
Gjithashtu OE nuk ka plotësuar Shtojcën 2 sipas preventivit të dhënë nga Autoriteti Kontraktor. Konkretisht OE ka përllogaritur fond rezerve mbi te gjithë artikujt e preventivit dhe jo vetëm për "Kabllot e Kontrollit/komandimit/ushqimit" siç përcaktohet në preventivin e publikuar në APP, rrjedhimisht kjo përllogaritje sjell një gabim ekonomik në ofertë dhe e bën ofertën të pavlefshme. Në LPP Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji". Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të

Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme".

***b) Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit (Shtojca 8)** i paraqitur nga N. ShPK nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar në DST e procedurës.*

Ne pjesën II – Shkaqet e Përjashtimit pika A: Deklarata për përmbushjen e kritereve te përgjithshme te kualifikimit, OE citon "Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.", ku ka deklaruar vetëm administratorin e kompanisë, ndërkohë sipas Shënimit te vendosur ne DST e procedurës dhe te publikuara duhet te deklaronte te gjithë personat qe kane vendimmarrje qofte edhe teknike, si Drejtuesi Teknik.

Ne Pjesën III - Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit, pika A "Për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut të realizimit të objektit të kontratës" teksti i deklaruar nuk është sipas formatit në DST specifikash nder te tjera thuhet: "... dhe marrim përsipër te realizojmë objektin ne përputhje me Listën e Mallrave dhe grafikun e Lëvrimit te përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor" ndërkohë qe sipas dokumenteve te tenderit do te ishte "... dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me preventivin e punimeve dhe grafikun e zbatimit të punimeve të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor".

Ne pjesën III Pika B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate" nuk është deklaruar numrin i punonjësve sipas Kriterit 2.3.3 si dhe teksti i deklaruar nuk është sipas formatit në DST.

Gjithashtu për piken C ne lidhje me deklarimin e makinerive dhe mjeteve te nevojshme për realizimin e punimeve, OE ka pranuar vetëm disponimin e tyre (përveç deklarimit te informacionit te plote për mjetin Daimler Chrysler dhe te dhënat e tij) por pa specifikuar me të dhëna konkrete për pjesën tjetër te mjeteve si me poshtë sipas Kriterit 2.3.8, siç kërkohen në Formularin e Vetëdeklarimit: Megaohmeter 1000 volt, Multimeter dixhital 1000VDC 750VAC CAT IV, Aparat testimi për relete e mbrojtjes dhe kontrollit me rryme maksimale ne dalje 3x75A, Dare ampermetrike 1500A, Indikator i sensit të fazave

Për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur një deklaratë për disponueshmerinë e mjeteve por në këtë deklaratë nuk vërteton pronësinë e tyre me anë të dokumenteve të njohura ligjërisht (fature blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj.).

***c)** OE nuk vërteton se plotëson piken 2.3.4: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i releve për instalimin dhe konfigurimin e tyre, si dhe 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i sistemit SCADA për instalimin dhe konfigurimin e SCADA-s, pasi për të dy inxhinierët elektrik të paraqitur nuk ka deklaruar në formularin e përgjithshëm të deklarimit se janë të certifikuar nga prodhuesi ose certifikim ekuivalent dhe gjithashtu në dokumentet e paraqitura për këta inxhinierë nuk rezulton asnjë certifikim, i cili vërteton plotësimin e kësaj pike të kritereve të veçanta për kualifikim.*

***d)** OE nuk plotëson piken 2.3.5. Për listën e mëposhtme të komponentëve përbërës të secilit panel, si dhe për kabllot e kontroll-komandimit; OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi dhe as katalog për komponentët: Moduli i hyrjeve dixhitale, Moduli i daljeve dixhitale, Moduli i hyrje-daljeve analoge, Moduli i procedimit të të dhënave, Monitoruesi i rrjetit, Ekrani 15" HMI, Lëshues manual i motorave, Testblloqe, Automatë katër polarë AC 380 V, 2A (Me kontakte ndihmëse), Automatë dy polarë 220 V DC, 10/16/20/25/A (Me Kontakte ndihmëse).*

***e)** Nga kontrolli i dokumentacionit të hedhur në SPE, rezultoi se dokumentacioni i emërtuar "Paneli AC.pdf" nuk hapet dhe në të pasqyrohet shënimi: (Error) (Failed to load PDF dokument).*

2.Shoqëria M. ShPK, për arsyet e mëposhtme:

***a) Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit (Shtojca 8)** i paraqitur nga M. ShPK nuk është plotësuar sipas formatit të kërkuar në DST e procedurës.*

Ne pjesën III B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate" është deklaruar vetëm një inxhinier elektrik, ndërkohë qe ne kriterin 2.3.4 është specifikuar qe nevojiten dy inxhiniere elektrike te certifikuar sipas prodhuesit përkatës.

Ne pjesën III pika C ne lidhje me deklarimin e makinerive dhe mjeteve te nevojshme për realizimin e punimeve, OE ka pranuar vetëm disponimin e tyre por pa specifikuar me të dhëna konkrete secilin mjet qe është kërkuar sipas kriterit 2.3.8.
Për plotësimin e kësaj pike, OE ka paraqitur një deklaratë për disponueshmerinë e mjeteve por në këtë deklaratë nuk vërteton pronësinë e tyre me anë të dokumenteve të njohura ligjërisht (fature blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj.).
b) *OE nuk ka dorëzuar ne Sistemin e Prokurimeve Publike asnjë dokument qe vërteton Kriterin 2.2.1 mbi kopje te deklaratave te xhiros vjetore dhe bilanceve te kërkuar sipas viteve përkatëse, si dhe Kriterin 2.2.2 mbi Vërtetimin për shlyerjen e tarifave dhe taksave nga Pushteti Vendor për Vitin 2023.*
c) *OE nuk përmbush Kriterin 2.3.2, sipas se cilës duhet te përcaktonte me ane te një Deklarate drejtuesin teknik te punimeve i cili do te ishte i paangazhuar ne asnjë kontrate tjetër, gjate kohëzgjatjes se punimeve. Nuk rezulton ne dokumentet e dorëzuar asnjë deklarate e tille.*
d) *OE nuk vërteton se plotëson piken 2.3.4: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i releve për instalimin dhe konfigurimin e tyre, si dhe 1 (një) inxhinier elektrik, të certifikuar nga prodhuesi i sistemit SCADA për instalimin dhe konfigurimin e SCADA-s, pasi për të dy inxhinierët elektrik të paraqitur nuk ka deklaruar në formularin e përgjithshëm të deklarimit se janë të certifikuar nga prodhuesi ose certifikim ekuivalent dhe gjithashtu në dokumentet e paraqitura për këta inxhinierë nuk rezulton asnjë certifikim, i cili vërteton plotësimin e kësaj pike të kritereve të veçanta për kualifikim.*
e) *OE nuk ka përmbushur Kriterin 2.3.5 pasi nuk ka dorëzuar asnjë dokument te përkthyer dhe te noterizuar mbi pajisjet e kërkuara ne këtë kriter.*
f) *OE nuk ka përmbushur Kriterin 2.3.8 pasi nuk ka dorëzuar asnjë dokument qe vërteton pronësinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike te përcaktuara për kryerjen e punimeve, me anë të dokumenteve të njohura ligjërisht (fature blerje, kontrate qiraje, deklarate doganore-import, akt dhurimi etj.).*

Sa më sipër KVO-ja, bazuar në nenin 92, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, vendosi te refuzojë ofertat e OE të mësipërm, për mos përmbushje të kritereve të veçanta kualifikuese.

Sipas grupit të auditimit, nga verifikimi i dokumentacion mbi vlerësimin e KVO-së për s'kualifikimin e OE si mësipërm, grupi shpreh dakortësinë se vlerësimi është i saktë, ***pasi OE e*** *s'kualifikuar* ***nuk plotësonin kriteret*** *kualifikuese* ***për të cilat ato janë*** *s'kualifikuar****.***

*** * ***

Referuar sa sipër, KVO-ja ka kualifikuar B/OE "L." & A. ShPK me NUIS L...S & L.F me vlerë totale prej 35,616,225 lekë pa TVSH.
Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraprak)
PO **JO X**
Me shkresën nr. 79/2 prot, datë 3.4.2024 nga KVO është plotësuar formulari i njoftim fituesit paraprak. Me shkresën nr. 79/3 prot, datë 26.4.2024 është plotësuar formulari i njoftim fituesit përfundimtar, dhe me shkresën nr. 79/4 prot, datë 26.4.2024, nga KVO-ja është hartuar Raporti Përmbledhës në adresë të titullarit të AK, dhe miratuar prej tij nga titullari i AK (F.S)
Në përfundim të afateve ligjore midis AK Hec- Lanabregas SHA përfaqësuar nga F.S dhe *B/OE L. ShPK & A. ShPK* është lidhur kontrata e zbatimit nr. 141 prot, datë 14.6.2024, me afat zbatimi 5 muaj nga data e lidhjes.
Me shkresën nr. 141/1 prot, datë 14.6.2024 është plotësuar njoftimi i kontratës.

Vlerësimi i procedurës. Referuar dokumentacionit në dosjen e Auditimit (dokumentet e OE), dhe të dhënëve të sistemit SPE, mbi OE të shpallur fitues, sipas vlerësimit të grupit të auditimit, KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt OE fitues, duke e shpallur dhe lidhur kontratë në kushtet e mos plotësimit të të gjitha kritereve të DST dhe duke mos mbajtur të njëjtin qëndrim si për OE e skualifikuar. E konkretisht:
- Është parashikuar çmim për të gjithë zërat e preventivit, dhe jo vetëm për kabllot, ashtu siç është përcaktuar në preventivin e publikuar.

- Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit (Shtojca 8), në Pjesën III, pika A, është cituar lista e mallrave dhe jo lista e punimeve;
- Në pikën B, nuk është deklaruar numri i punonjësve sipas formatit të DST-së dhe nuk është përmbushur kriteri 2.3.3.
- Në pikën C, mungon dokumentacioni provues për makineritë dhe pajisjet, konkretisht: Megaohmeter 1000V, Multimetër dixhital, aparat testimi për RL, darë ampermetrike 150A, indikator i sensit të fazave.
- Nuk vërtetohet përmbushja e pikës 2.3.4 për inxhinierin elektrik të certifikuar nga prodhuesi i releve (vetëdeklarim). Ndërkohë, ky është deklaruar në Shtojcën 8.
- Nuk është paraqitur autorizim nga prodhuesi për komponentët si më poshtë: Moduli i hyrjeve dixhitale, moduli i daljeve dixhitale, moduli i hyrje-daljeve analoge, moduli i procedimit të të dhënave, monitoruesi i rrjetit, ekran 15 inç, lëshues manual i motorëve, testblloqe, automat 4-polësh dhe 2-polësh.
- Janë paraqitur vetëm dy autorizime prodhuesi: një nga Siemens dhe një nga Tim Kabel d.o.o.
- Nuk është bërë kërkesë në APP për hapje folderi në lidhje me verifikimin e dokumentacionit të sipërpërmendur.

Për sa trajtuam më sipër, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë nga KVO-ja, konstatohet se vlerësimi nuk është i drejt dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi B/OE i shpallur fitues nuk është në plotësim të të gjitha kritereve të DST. Nisur nga fakti dhe në kushtet kur në garë nuk ka OE me dokumentacion të rregullt, KVO-ja duhet të anulonte procedurën dhe vijonte me procedurën e re, me kushte më favorizues, kjo për të rritur numërin e pjesëmarrësve në procedurë e cila do çonte në përdorim më efektiv të fondit të prokuruar, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 2, Neni 3 pika 1, Neni 92 pika 3 dhe 4.

Personat përgjegjës për vlerësimin e prcedurës: A.S, A.L, S.C, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar HEC-Lanabregas janë paraqitur observacioni me shkresën nr. 143/1 prot, datë 11.06.2026 *(prot KLSH nr. 983/4, dt. 11.06.2026)* "*Mbi Projekt Raportin e Auditimit*" nga F.S me detyrë Administrator i shoqërisë HEC- Lanabregas, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subiektit:

Në dokumentet e tenderit (DST) është përcaktuar qartë objekti dhe përmbajtja e ofertës ekonomike. Megjithatë, në praktikë, në disa raste furnizimi i mallrave mund të jetë pjesë përbërëse e ekzekutimit të punimeve, për shkak të natyrës së procesit (p.sh. materialet ndërtimore, pajisjet, elementet e instalimeve etj.). Për këtë arsye, përfshirja e mallrave në përllogaritjen e ofertës ekonomike nuk cënon thelbin e kërkesës, por përbën pjesë integrale të punimeve që duhej të ofertoheshin.

Formati i ofertës është përmbajtur në thelb kërkesave të DST-së, pasi janë paraqitur çmimet për realizimin e zbatimit të punimeve të kërkuara. Terminologjia apo kategorizimi i disa pozicioneve si "mallra" në tabelë nuk ka ndikuar në përmbajtjen ekonomike të ofertës dhe nuk ka sjellë ndryshim në vlerën apo mënyrën e përllogaritjes së saj.

Në procesin e vlerësimit, Komisioni ka verifikuar përputhshmërinë e ofertës me kërkesat teknike dhe ekonomike, duke konstatuar se oferta i përgjigjej qëllimit të kontratës garanton realizimin e punimeve të kërkuara dhe mbulon të gjitha kërkesat funksionale të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

Për pasojë, konsiderojmë se konstatimi është i natyrës formale dhe nuk ndikon në ligjdhmërinë e procedurës, në vlefshmërinë e vlerësimit të procedurës së prokurimit, pasi oferta përmbush qëllimin ekonomik dhe teknik të kontratës dhe përfshirja e elementeve të natyrës "mallra" në ofertë është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin e punimeve të kërkuara dhe nuk cenon përputhshmërinë me kërkesat e DST-së.

Nga verifikimi i dokumentacionit të procedurës rezulton se preventivi i publikuar në Dokumentet Standarde të Tenderit, si dhe Formulari i Ofertës Ekonomike janë publikuar nga Autoriteti Kontraktor në mënyrë të qartë dhe të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës. Në dokumente janë përcaktuar të gjithë zërat që duhen ofertuar, si dhe mënyra e paraqitjes së cmimeve për secalin zë të punimeve përfshirë si mallra ashtu edhe punime. Për rrjedhojë, nuk rezulton mospërputhje ndërmjet preventivit të publikuar dhe mënyrës së paraqitjes së ofertës ekonomike nga operatorët ekonomikë.
Struktura e ofertës ekonomike dhe çmimet përkatëse janë përcaktuar paraprakisht nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e procedurës dhe janë zbatuar në mënyrë të barabartë nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, pa sjellë paqartësi, kufizim të konkurrencës apo devijim nga kriteret e vlerësimit të përcaktuara në DST.

Operatori ekonomik ka paraqitur ofertën ekonomike në përputhje me strukturën dhe formatin e kërkuar në dokumentet e tenderit, duke ofertuar cmim për të gjithë zërat e preventivit të publikuar.

fakti që në preventive janë përfshirë zëra që lidhen me furnizimin e materialeve, pajisjeve, kabllove apo komponentëve të tjerë teknikë nuk përbën shkak për të konsideruar ofertën të papërshtatshme, pasi këta element janë pjesë përbërëse dhe të domosdoshme për realizimin e objektit të kontratës.

Në këtë kuptim, Komisioni i Vleresimit te ofertave ka vlerësuar se konstatimi në fjalë nuk gjen mbështetje në dokumentacionin e publikuar të procedurës dhe nuk ka sjellë pasoja në ligjshmërinë, transparencën apo rezultatin e procesit të prokurimit.
Në lidhje me konstatimin tuaj për procedurën e prokurimit, ku evidentohet se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 8), në Pjesën III, pika A, është cituar lista e mallrave dhe jo lista e punimeve, ju informojmë sa vijon:

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përbën dokument që plotësohet nga operatori ekonomik mbi bazën e modelit standard të publikuar në dokumentet e tenderit. qëllimi i këtij formulari është deklarimi paraprak i informacionit dhe jo përcaktimi i natyrës së kontratës apo i objektit të procedurës së prokurimt, të cilat përcaktohen në mënyrë të qartë në Njoftimin e Kontratës, DST-të dhe specifikimet teknike.

Referimi ndaj "listës së mallrave" në këtë pjesë të formularit rezulton nga mënyra e plotësimit të formularit nga ana e operatorit ekonomik dhe përbën pasaktësi të karakterit formal të prezumuar
Sipas Akt-Marreveshje nr. Repertori 1220, Nr.koleksioni 418 , dt 21.03.2024 per bashkepunimin e perkohshem te shoqerive tregtare "AZ TRADING" shpk dhe 'LIGUS" shpk shoqerite bashkojne kapitalet ,licencat ,bilancet e tyre,eksperiencat e mepareshme, pajisjet, mjetet, makinerite e renda, fuqine punetore, stafin Teknik, etj dhe jane pergjegjese solidare per punimet e kryera

Kriteri 2.3.3 i DST-së ka si qëllim verifikimin e disponueshmërisë së fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës dhe jo domosdoshmërisht paraqitjeb e saj në format të caktuar, por ky informacion rezulton i provuar nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar nëpërmjet të cilit rezulton se numri minimal i punonjësve i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor është përmbushur nëpërmjet listëpagesave dhe listës së kontributeve të paraqitura nga të dy operatorët ekonomikë pjesëmarrës si BOE.

Dokumentacioni i depozituar provon në mënyrë objective dhe të verifikueshme ekzistecën e stafit të kërkuar, marrëdhëniet e punës dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore përkatëse. Për rrjedhojë, kapaciteti njerëzor i kërkuar nga kriteti 2.3.3 është provuar në mënyrë të plotë.
Ne lidhje me konstatimin se mungojnë dokumentat provuese për pajisjet dhe makineritë e kërkuara në pikën C të DST-së, ky konstatim nuk qëndron. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin përkatës në mbështetje të kapaciteteve teknike, nëpërmjet Deklaratës për Mbështetje në kapacitete Teknike sipas Nr.REF 97575-03-06-2024, si dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur nga subjekti mbështetës KIGUS sh.p.k, në përputhje me kërkesat e DST-së.

Në dokumentacionin e depozituar janë identifikuar pajisjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor dhe është deklaruar disponueshmëria e tyre për ealizimin e kontratës. Përmes deklarimit të kapaciteteve teknike dhe angazhimit të subjektit mbështetës provuar se operatori ekonomik ka në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e objektit të kontratës.

Qëllimi I kriterit të vendosur në DST është të garantojë se operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës dhe jo të penalizojë operatorin për mënyrën e paraqitjes së dokumentacionit kur ekzistenca dhe disponueshmëria e pajisjeve provohet nëpërmjet dokumentave të paraqitura. Në rastin konkret dokumentacioni I paraqitur I ka dhënë KVO-së mundësinë të verifikojë ekzistencën dhe disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara.

Në lidhje me konstatimin se nuk vërtetohet përmbushja e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.4 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, për disponimin e inxhinierit elektrik të certifikuar nga prodhuesi i releve, ju bëjmë me dije se ky konstatim nuk qëndron dhe nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar në procedurë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (Shtojca 8) disponimin e personelit të kërkuar, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit. Në zbatim të legjislacionit të prokurimit publik, Shtojca 8 përbën deklarim paraprak të operatorit ekonomik mbi përmbushjen e kritereve të kualifikimit, ndërsa dokumentacioni mbështetës shërben për verifikimin e deklarimeve të kryera.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin përkatës nëpërmjet Deklaratës për Mbështetje në Kapacitete Teknike Nr. REF 97575-03-06-2024, si dhe dokumentacionin shoqërues që provon disponueshmërinë e personelit teknik të kërkuar dhe kualifikimet e tij profesionale. Bashkëlidhur janë paraqitur dëshmitë, certifikimet dhe dokumentet profesionale të inxhinierëve të angazhuar për realizimin e kontratës.

Qëllimi i kriterit 2.3.4 është të garantojë që operatori ekonomik disponon ekspertizën teknike të nevojshme për realizimin e objektit të kontratës. Ky qëllim është përmbushur plotësisht, pasi dokumentacioni i paraqitur provon ekzistencën dhe disponueshmërinë e personelit të kualifikuar, si dhe certifikimet profesionale të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.
Në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe praktikën e konsoliduar të prokurimit publik, vlerësimi i ofertës duhet të mbështetet në përmbajtjen reale të dokumentacionit dhe në përmbushjen efektive të kriterit, jo në interpretime formale që nuk ndikojnë në aftësinë e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën. Për sa kohë dokumentacioni provues është paraqitur dhe kriteri është përmbushur në substancë, nuk mund të konkludohet për mosplotësim të kriterit vetëm mbi bazën e një interpretimi të izoluar të formularit të vetëdeklarimit.

Për më tepër, sipas parimeve të trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive të parashikuara në legjislacionin e prokurimit publik, një operator ekonomik nuk mund të penalizohet kur dokumentacioni i paraqitur provon qartë përmbushjen e kriterit të kërkuar dhe kur nuk ekziston asnjë dyshim mbi disponueshmërinë e personelit teknik të kërkuar nga DST-ja.
Në lidhje me konstatimin se nuk janë paraqitur autorizimet e prodhuesve për komponentët e kërkuar në dokumentet e tenderit dhe se janë paraqitur vetëm dy autorizime, përkatësisht nga Siemens dhe Tim Kabel d.o.o., ju bëjmë me dije se ky konstatim nuk qëndron.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në procedurën e prokurimit rezulton se operatori ekonomik ka depozituar autorizimet dhe dokumentacionin mbështetës për prodhuesit e komponentëve të propozuar për realizimin e objektit të kontratës. Përveç dokumentacionit të Komponentët e ofertuar nuk i përkasin një prodhuesi të vetëm, por janë pjesë e një sistemi të integruar teknologjik të përbërë nga pajisje dhe elementë të specializuar të prodhuesve të ndryshëm. Për këtë arsye, autorizimet janë paraqitur në përputhje me prodhuesin përkatës të secilit komponent dhe duhet të vlerësohen në tërësinë e dokumentacionit teknik të administruar në procedurë.

Gjithashtu, qëllimi i kërkesës së Autoritetit Kontraktor për paraqitjen e autorizimeve është të garantojë origjinën e produkteve, lidhjen e operatorit ekonomik me prodhuesin ose distributorin e autorizuar dhe mundësinë reale të furnizimit të komponentëve të kërkuar. Ky qëllim është përmbushur plotësisht nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, i cili provon burimin dhe autorizimin përkatës të produkteve të ofertuara.

Për rrjedhojë, nuk rezulton mungesë autorizimi për komponentët e kërkuar, por një interpretim jo i plotë i dokumentacionit të paraqitur. Dokumentacioni i administruar në procedurë provon se operatori ekonomik ka paraqitur autorizimet dhe dokumentet mbështetëse për prodhuesit e komponentëve të ofertuar, duke përmbushur kërkesat e DST-së dhe duke garantuar furnizimin e rregullt të pajisjeve objekt kontrate.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>*:*

Për sa keni observuar, grup i auditimit pasi analizojë me kujdes ato, arrin në përfundimin se argumentet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazë terreni dhe të observacioneve të akteve. Gjithashtu mangësitë e evidentuara

për dokumentacion të cilat nuk ishin pjesë e dosje së procedurës dhe të paprotokolluara nuk vërtetojnë origjinalitetin e tyre nëse kanë qenë të disponushme gjatë fazës së vlerësimit të procedurës nga KVO-ja ose jo. *Në këto kushte procedura mbetet me shkelje në vlerësim.*

3- Procedura me objekt: "*Blerje mjet transporti*", viti 2023.

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i procedurës “Blerje mjet transporti”.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 87/1, prot, dt. 6.6.2023.</td><td rowspan="2">2. Komisioni ST, nr. ---, dt. ---:
Nuk është krijuar nga AK

2.1. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit (NJP) nr. 87/1, dt. 6.6.2023
1- XH.K
2. K.F
3. A.A</td><td rowspan="2">3. Komisioni i vlerësimit të ofertave nr. 87/2, DT. 8.6.2023:
1. A.A
2. A.P
3. F.D</td></tr>
<tr><td>2. Lloi i procedurës
“E hapur e thjeshtuar”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi limit
4,500,000 lekë pa TVSh
REF-72470-06-14-2023</td><td>6. Oferta fituese:
“A.” ShPK, me vlerë oferte 4,398,000 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
102 mijë lekë ose 2.26% e fondit të prokuruar.</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së procedurës
Datë 26.6.2023 me afat zbatimi 3 muaj, nga nënshkrimi i kontratës</td><td>9. Burimi i financimit
Të ardhurat e HEC- Lanabregas</td><td>10. Operator Ekonomik.
a) Pjesëmarrës 1 OE
b) S’kualifikuar 0 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK:
JO</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK:
JO</td><td>13. Përgjigje nga APP apo KPP:
JO</td></tr>
<tr><td>14. Formularë njoftimi:
- Njoftim paraprak nr. 96/3, dt. 26.6.2023;
- Njoftim përfundimtar , dt. 30.6.2023;
- Raporti përmbledhës nr. ----, dt. ---</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSH):
4,398,000 lekë</td><td>16. Lidhja e kontratës
Nr. 96/4 prot, datë 4.7.2023, me afat zbatimi 3 muaj nga data e nënshkrimit</td></tr>
</table>

Me shkresën nr. 87 prot, datë 01.6.2023 miratuar nga Drejtori Administrativ XH.K në adresë të Administratorit (O.I), është kërkuar që për nevojat e Administratës HEC-Lanagregas SHA, realizimin e procedurës për blerje automjeti.
Sipas të dhënave të dosjes, konstatohet se nga Titullari i AK (O.I), është përcaktuar personi përgjegjës për procedurën (K.F referuar shkresës nr. 01/1 prot, datë 4.01.2023 të titullarit të AK, paraqitur në observacionet e subjektit). Evidentohet fakti se dosja fizike e cila përmban procesverbale për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurën e përcaktimit të fondit limit dhe fituesit, etj., nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes për të gjithë përmbajtjen e tyre, në kundërshtim me nenet 21,58,59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor të R.SH, ku fletët nuk janë të shoqëruara me inventarë paraprak dhe të numëruara në çdo faqe, në kundërshtim me germën g) të nenit 8- “Përpunimi tekniko-shkencor i DT”, të Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritet publike në R.SH”, dhe Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi personin përgjegjës të procedurës (K.F).*

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikues. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës, rezultoi se nga NJP është mbajtur procesverbali nr. 87/3 prot, datë 12.6.2023 “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”, ku konstatohet se kriteret e aplikuara dhe specifikimet teknike janë në përputhje me dispozitat e LPP, respektivisht të nenit 77- Kërkesa për kualifikim.

Zhvillimi procedurës. Referuar dokumentacionit në dosje, konstatohet se me procesverbal nr. 96/1 prot, datë 26.6.2023 është bërë hapja e procedurës nga KVO-ja në prani të anëtarëve të Nj.P, nga ku konstatohet se ka shprehur interes për pjesëmarrje vetëm shoqëria A. ShPK me ofertë ekonomike 4,398,000 lekë pa TVSh. KVO-ja, në përfundim të vlerësimit është mbajtur procesverbali nr. 96/2, datë 26.6.2023, duke kualifikuar OE e vetëm pjesëmarrës. Me shkresën nr. 96/3 prot, datë 26.6.2023 është plotësuar formularin e njoftim fituesit paraprak. Me datë 30.6.2023, nga KVO-ja në përfundim

të afateve është plotësuar formulari i njoftim fituesit përfundimtar dhe me datë 30.6.2023 njoftimi i lidhjes së kontratës.

Vlerësimi i procedurës. Referuar dokumentacionit në dosjen e auditimit (dokumentet e OE), dhe të dhënave të sistemit SPE, mbi OE të shpallur fitues, konstatohet se KVO-ja ka vlerësuar drejt OE fitues, duke e shpallur dhe lidhur kontratë, pasi plotëson të gjitha kriteret të DST.

4- Procedura me objekt: "*Riparim i transformatorit të dëmtuar 3200 KVA, 6/35 Kv*", viti 2023.

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i procedurës “Riparim i transformatorit të dëmtuar 3200 KVA, 6/35 Kv”.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi
Nr. 16 prot, dt.30.01.2023.</td><td rowspan="2">2. Komisioni ST, nr. . 12 prot, dt. 12.01.2023
G.D
A.G
SH.B

2.1. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit (NJP) nr. 16 prot, dt. 30.01.2023
F.D
A.A
K.F</td><td rowspan="2">3. Komisioni i vlerësimit të ofertave nr. 16/1, DT. 30.01.2023:
1. XH.K
2. A.S
3. J.D</td></tr>
<tr><td>2. Lloi i procedurës
“E hapur e thjeshtuar”</td></tr>
<tr><td>5. Fondi limit
3,803,000 lekë pa TVSh
REF-57511-01-31-2023</td><td>6. Oferta fituese:
“E.” ShPK, me vlerë oferte 3,735,000 lekë pa TVSh.</td><td>7. Diferenca me fondin limit
68 mijë lekë ose 1.7% e fondit të prokuruar.</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së procedurës
Datë 13.02.2023 me afat zbatimi 90 ditë, nga nënshkrimi i kontratës</td><td>9. Burimi i financimit
Të ardhurat e HEC- Lanabregas, planifikuar në buxhetin e vitit 2023 (shpenzime të jashtëzakonshme)</td><td>10. Operator Ekonomik.
a) Pjesëmarrës 1 OE
b) S’kualifikuar 0 OE
c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK:
JO</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK:
JO</td><td>13. Përgjigje nga APP apo KPP:
JO</td></tr>
<tr><td>14. Formularë njoftimi:
- Njoftim paraprak nr. 25/3, dt. 24.2.2023;
- Raporti përmbledhës , dt. 27.02.2023-</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSH):
3,735,000 lekë</td><td>16. Lidhja e kontratës
Nr. 25/5 prot, datë 9.3.2023, me afat zbatimi 90 ditë nga data e nënshkrimit</td></tr>
</table>

Me shkresën nr. 06 prot, datë 6.01.2023 të Drejtorit Teknik F.D në adresë të administratori O.I është paraqitur kërkesë për riparimin e transformatorit të dëmtuar 3200 KVA, 6/35 kv, kjo shoqëruar dhe me relacion shpjegues. Me shkresën nr. 10 prot, datë 12.01.2023 është përcjellë akti teknik për zëvendësimin e transformatorit me fuqi 3.2 MV dhe AG 2.
Me shkresën nr. 10/1 prot, datë 12.01.2023 hartuar nga P/Sektorit të Prodhimit A.S dhe miratuar nga Drejtori teknik F.D, është kërkuar nga Administratori i shoqërisë O.I kërkesë për riparimin e transformatorit me fuqi 3.2 mẇ.
Me urdhër nr. 12 prot, datë 12.01.2023 të titullarit të AK (O.I), është ngritur komisioni për hartimin e preventivit, specifikimeve teknike dhe hartimin ne fondit limit, me përbërje: G.D, A.G dhe SH.B. Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se, nga ana e komisionit është hartuar procesverbali mbi fondin limit, referuar çmimeve të treguar të marrë nga 3 OE të ndryshëm. Sipas këtij procesverbali thuhet se ofertat janë bashkëlidhur, por që nga verifikimi rezultoi se ato janë pa datë dhe njëra nga ofertat nuk lexohet se i kujt OE është dhe çfarë vlere ka paraqitur. Gjithashtu dhe dy ofertat e tjera të paraqitura nuk kanë datë se kur janë marrë, gjë e cila tregon se nuk dihet se në çfarë periudhe është bërë testimi i treguar, kjo për shoqëritë “E.” ShPK dhe “E.” ShPK, veprime në kundërshtim me pikën 4 të nenit 12, pikës 1 dhe 2, të nenit 76, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*“ i ndryshuar, *për të cilën mban përgjegjësi komisioni i ngritur me urdhër nr. 12 prot, datë 12.01.2023, i përbërë nga: G.D, A.G dhe SH.B.*

<u>Në lidhje me administrimin e dokumentacionit</u>. Sipas të dhënave të dosjes, konstatohet se nga titullari i AK (O.I), është përcaktuar personi përgjegjës për procedurën (K.F referuar shkresës nr.

01/1 prot, datë 4.01.2023 të titullarit të AK, paraqitur në observacionet e subjektit). Evidentohet fakti se dosja fizike e cila përmban procesverbale për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurën e përcaktimit të fondit limit dhe fituesit, etj., nuk janë të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes për të gjithë përmbajtjen e tyre, në kundërshtim me nenet 21,58,59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor të R.SH, ku fletët nuk janë të shoqëruara me inventarë paraprak dhe të numëruara në çdo faqe, në kundërshtim me germën g) të nenit 8- "Përpunimi tekniko-shkencor i DT", të Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritet publike në R.SH", dhe Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat", *veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi personin përgjegjës të procedurës (K.F).*

Hartimi i specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikues. Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës, rezultoi se nga NJP është mbajtur procesverbali nr. 16/2 prot, datë 30.01.2023 "për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim", ku konstatohet se kriteret e aplikuara dhe specifikimet teknike janë në përputhje me dispozitat e LPP, respektivisht të nenit 77- Kërkesa për kualifikim.

Zhvillimi procedurës. Referuar dokumentacionit në dosje, konstatohet se me procesverbal nr. 25/1 prot, datë 13.02.2023 është bërë hapja e procedurës nga KVO-ja në prani të anëtarëve të Nj.P, nga ku konstatohet se ka shprehur interes për pjesëmarrje vetëm shoqëria "E." ShPK me ofertë ekonomike 3,735,000 lekë pa TVSh. KVO-ja, në përfundim të vlerësimit është mbajtur procesverbali nr. 25/2, datë 15.2.2023, duke kualifikuar dhe shpallur fitues shoqërinë "E." ShPK.
Me shkresën nr. 25/3 prot, datë 24.01.2023 është plotësuar formularin e njoftim fituesit paraprak, duke kualifikuar shoqërinë e vetme pjesëmarrëse dhe raporti përmbledhës datë 27.02.2023.

Vlerësimi i procedurës. Referuar dokumentacionit në dosjen e auditimit (dokumentet e OE), dhe të dhënave të sistemit SPE, mbi OE të shpallur fitues, sipas vlerësimit të grupit të auditimit, rezultoi se KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt OE fitues (E. ShPK), duke e shpallur dhe lidhur kontratë në kushtet e mos plotësimit të të gjitha kritereve të DST. E konkretisht:
- Nuk plotëson pikën 2.3.3 mbi makineritë e pajisjet, pasi një pjesë e tyre nuk është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, dhe për një pjesë nuk është dokumentacioni që vërteton se këtë mjete janë në pronësi të shoqërisë. Referuar deklaratës noteriale nr. 2170 rep/ 423 kol, datë 7.5.2019, vetëm një pjesë e mjeteve është deklaruar në pronësi por e pashoqëruar me dokument vërtetues (faturë tatimore ose deklaratë doganore), të dhëna të cilat paraqiten sipas kërkesave të DST, si më poshtë:
a. Nuk janë deklaruar në formularin e vetëdeklarimit (shtojca 8), makineri: (Mjet Test Vane për realizimin e testimit (shërbimit) pranë çdo objekti; Mjeti duhet të ketë të instaluar të gjitha pajisjet e nevojshme për të realizuar testimet: Aparat për matjen e tangent ð nga 0 deri në 12 kv; Aparat për analizën e karakteristikës së frekuencës; Aparat për diagnostifikimin e izolimit (analizator); Aparat për matjen e rezistencës Ohmike të përshtjellave të transformatorit; Aparat për matjen e qëndrueshmërisë elektrike të vajit (tensionit të çmimit); Aparat për matjen e koeficientit të transformimit të transformatorëve; Aparat për matjen e izalocionit të transformatorit);
b. Nuk kanë dokumentacion vërtetues që janë në pronësi të shoqërisë (faturë blerje ose deklaratë doganore), këto makineri: (Filtër prese për pastrimin e vajit të transformatorëve; Filtër vakum për pastrimin kimik të vajit të transformatorëve me kapacitet deri në 6000 lit /orë; Furrë elektrike e montuar në fabrikë; Mjet ngritës (pirun) deri 2.5 ton; Pajisje saldimi për hekur, bakër dhe alumin; Vinç elektrik 2.5 ton i montuar në fabrikë; Pajisje për matjen e humbjeve të transformatorëve pa ngarkesë dhe lidhjes së shkurtër; Pajisje për testimin e transformatorëve me tension të aplikuar deri në 100 kV; Pajisje për testimin e transformatorëve me tension të induktuar dyfish (2Un) dhe frekuencë dyfishe (100 Hz); Pajisje për matjen e tensionit të çmimit të vajit të transformatorëve deri në 80 kV; Mjet Test Vane për realizimin e testimit (shërbimit) pranë çdo objekti; Mjeti duhet të ketë të instaluar të gjitha pajisjet e nevojshme për të realizuar testimet: Aparat për matjen e tangent ð nga 0 deri në 12 kv; Aparat për analizën e karakteristikës së frekuencës; Aparat për diagnostifikimin e izolimit (analizator); Aparat për matjen e rezistencës Ohmike të pështjellave të transformatorit;

Aparat për matjen e qëndrueshmërisë elektrike të vajit (tensionit të çmimit); Aparat për matjen e koeficientit të transformimit të transformatorëve; Aparat për matjen e izalocionit të transformatorit); **c.** Sipas deklaratës noteriale nr. 2170 rep/ 423 kol, datë 7.5.2019, nuk ka të deklaruara këto makineri: (Bobinatrice për avolzhim transformatorësh me tel bakri dhe alumini; Trapano kolone; Pajisje për matjen e humbjeve të transformatorëve pa ngarkesë dhe lidhjes së shkurtër; Pajisje për testimin e transformatorëve me tension të induktuar dyfish (2Un) dhe frekuencë dyfishe (100 Hz); Pajisje për matjen e tensionit të çmimit të vajit të transformatorëve deri në 80 kV; Mjet Test Vane për realizimin e testimit (shërbimit) pranë çdo objekti; Mjeti duhet të ketë të instaluar të gjitha pajisjet e nevojshme për të realizuar testimet: Aparat për matjen e tangent ð nga 0 deri në 12 kv; Aparat për analizën e karakteristikës së frekuencës; Aparat për diagnostifikimin e izolimit (analizator); Aparat për matjen e rezistencës Ohmike të pështjellave të transformatorit; Aparat për matjen e qëndrueshmërisë elektrike të vajit (tensionit të çmimit); Aparat për matjen e koeficientit të transformimit të transformatorëve; Aparat për matjen e izalocionit të transformatorit).

Për sa trajtuam më sipër, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë nga KVO-ja, konstatohet se vlerësimi nuk është i drejt dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi OE i shpallur fitues nuk është në plotësim të të gjitha kritereve të DST. Nisur nga fakti se nuk ka OE të tjerë të mbetur në garë, KVO duhet të anullonte procedurës dhe vijonte me procedurën e re, me kushte më favorizuese, kjo për të rritur numërin e pjesëmarrësve në procedurë e cila do çonte në përdorim më efektiv të fondit të prokuruar, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Neni 2, Neni 3 pika 1, Neni 92 pika 3 dhe 4.

Personat përgjegjës për vlerësimin e procedurës: XH.K, A.S dhe J.D, në cilësinë e anëtarit të KVO,

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar HEC-Lanabregas janë paraqitur observacioni me shkresën nr. 143/1 prot, datë 11.06.2026 *(prot KLSH nr. 983/4, dt. 11.06.2026)* "*Mbi Projekt Raportin e Auditimit*" nga F.S me detyrë Administrator i shoqërisë HEC-Lanabregas, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- *Nuk kane dokumentacionin vertetues qe jane ne pronesi te shoqerise(fature blerje ose deklarate doganore), keto makineri:Filter prese per pastrimin e vajit te tranformatoreve Filtër vakum për pastrim kimik të vajit të trasformatoreve me kapacitet deri në 6000 litër/orë.Furrë elektrike e montuar në fabrikë.Mjet ngritës (pirun) deri 2.5 ton.Paisje saldimi për hekur,bakër dhe alumin.Vinç elektrik 2.5 ton i montuar në fabrikë.Paisje për matjen e humbjeve të trasformatorëve pa ngarkësë dhe lidhjes së shkurtër.Paisje për testimin e trasformatorëve me tension të aplikuar deri në 100kV.Paisje për testimin e trasformatorëve me tension të induktuar dyfish(2Un) dhe frekuencë dyfishe (100Hz). Paisje pë matjen e tensionit të çpimit të vajit të trasformatorëve deri në 80kV.Mjet test vane pë realizimin e testimit (shërbimit) pranë çdo objekti, mjeti duhet të ketë të instaluar të gjitha paisjet e nevojshme për të realizuar testimet,aparat për matjen e tangent ð nga o deri në 12kV,aparat për analizën e karakteristikës së frekuencës ,aparat për diagnostifikimin e izolimit(analizator),aparat për matjen e rezistencës Omike të pështjellave të trasformatorit,aparat për matjen e qëndrueshmerise elektrike të vajit (tensionit të çpimit),aparat për matjen e koeficientit të trasforminit të trasformatorëve ,aparat për matjen e izolacionit të trasformatorit.*

Kthim Përgjigje

Bazuar ne piken 2.3.3. te DST.Operatori ekonomik duhet te vertetoje pronesine e makinerive/pajisjeve te mesiperme nepermjet faturave tatimore te blerjes, kontrate blerje, kontrate dhurimi apo cdo forme tjeter e fitimit te pronesise sipas kodit civil, ***ose nepermjet deklarates noteriale te shoqeruar me fotografite e makinerive/pajisjeve,*** ose nepermjet kontrates se qirase per makinerite/pajisjet e marra me qira, e cila duhet te shoqerohet me aktin e pronesise mbi makinerite/pajisjet qe merren me qira.

Referuar Kriterit te DST pika 2.3.3. Operatori ekonomik duhet te vertetoje pronesine e makinerive/pajisjeve te mesiperme nepermjet faturave tatimore te blerjes, kontrate blerje, kontrate dhurimi apo cdo forme tjeter e fitimit te pronesise sipas kodit civil, *ose nepermjet deklarates noteriale te shoqeruar me fotografite e makinerive/pajisjeve*, ose nepermjet kontrates se qirase per makinerite/pajisjet e marra me qira, e cila duhet te shoqerohet me aktin e pronesise mbi makinerite/pajisjet qe merren me qira.

Referuar ketij kriteri pronesia vertetohet me ane te faturave tatimore te blerjes dhe te deklarates noteriale te paraqitur nga operatori ekonomik fitues, deklarate e cila eshte e shoqeruar me fotografite, kataloget perkates per mjetet e kerkuara si meposhte:

- Bobinatriçe për avolzhim trasformatorësh me tel bakri dhe alumini ("Deklarate Noteriale Nr 2170 Re, Nr 423 Kol" pika 11, fature e thjeshte tatimore nr 30 dt 02.03.2006 dhe deklarate zhdoganimi dt 19.07.2019, foto)
- Trapano kolone ("Deklarate Noteriale Nr 2170 Re, Nr 423 Kol" pika 5, fature e thjeshtetatimore nr 484 dt 23.07.2014, foto)
- Paisje për matjen e humbjeve të trasformatorëve pa ngarkësë dhe lidhjes së shkurtër. ("Deklarate Noteriale Nr 2170 Re, Nr 423 Kol" pika 21, foto)

Paisje për testimin e trasformatorëve me tension të induktuar dyfish(2Un) dhe frekuencë dyfishe (100Hz). ("Deklarate Noteriale Nr 2170 Re, Nr 423 Kol" pika 11, fature e thjeshte tatimore nr 30 dt 02.03.2006 dhe deklarate zhdoganimi dt 19.07.2019)
Paisje pë matjen e tensionit të çpimit të vajit të trasformatorëve deri në 80kV (Katalog dhe specifikimet per paisjet ne brendesi te "Deklarate Noteriale Nr 2170 Re, Nr 423 Kol" pika 5, foto)

Mjet test vane pë realizimin e testimit (shërbimit) pranë çdo objekti, mjeti duhet të ketë të instaluar të gjitha paisjet e nevojshme për të realizuar testimet.(Deklarate ne pronesi te tije mjet me Targe AA428YC, foto)

Aparat për matjen e tangent ô nga o deri në 12kV
Aparat për analizën e karakteristikës së frekuencës .
Aparat për diagnostifikimin e izolimit(analizator).
Aparat për matjen e rezistencës Omike të pështjellave të trasformatorit .
Aparat për matjen e qëndrueshmerise elektrike të vajit (tensionit të çpimit).
Aparat për matjen e koefiçientit të trasformimit të trasformatorëve .
Aparat për matjen e izolacionit të trasformatorit.

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>:
Për sa keni observuar, grupi i auditimit pasi analizoi me kujdes ato, arrin në përfundimin se argumentet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur asnjë element i ri nga ato të paraqitura në fazë terreni dhe të observimeve të akteve. Gjithashtu mangësitë e evidentuara për dokumentacion të cilat nuk ishin pjesë e dosje së procedurës dhe të paprotokolluara nuk vërtetojnë origjinalitetin e tyre nëse kanë qenë të disponushme gjatë fazës së vlerësimit të procedurës nga KVO-ja ose jo. *Në këto kushte procedura mbetet me shkelje në vlerësim.*

2.4.4. Mbi zbatimin e kontratave të punëve publike (investime).

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezultoi se për periudhën 01.01.2023 – , në HEC- Lanabregas SHA janë realizuar gjithsej 3 procedura me vlerë të lartë për investime, si vijon:

Nr.	Elementi i Regjistrit	Fondi Limit	OE fitues	Vlera kontratës	Periudha
1	Riparimi i Transformatorit te demtuar 3200KVA 6/35KV	3,803,000	3,735,000	E...	2023
2	Rikonstruksioni i Seksionit 6 kV ne HEC Lanabregas SHA. (Faza e Dyte)	35,866,372	34,731,300	I...	2023
3	Zëvendësimi i paneleve te kontrollit, sinkronizimit, mbrojtjeve dhe pajisjeve matëse te agregateve AG.1, AG.2 me sistemin digjital SCADA	36,745,000	35,616,225	L...	2024
	T O T A L I	**76,414,372**	**35,616,225**		

Pas vlerësimit të riskut në auditim, grupi vlerësojë për auditim kontratën me objekt: **"***Rikonstruksion i seksionit 6 kV në HEC Lanabregas (Faza e dytë"),* ku nga shqyrtimi i dokumentacionit si: - *Dokumentacioni i kontratës, shtesa dhe ndryshime; - Zbatimi i afateve kontraktore (ditari i punimeve, miratime, procesverbale); - Libreza e masave, situacionet progresive dhe situacioni përfundimtar); - Verifikim i disa zërave të punimeve në objekt,* rezultoi se:

- <u>Mbi zbatimin e kontratës</u>.

Kontrata "Rikonstruksion i seksionit 6 Kv në HEC Lanabregas (Faza e dytë)" është nënshkruar me nr. 208 prot., datë 24.11.2023, me BOE "I. & M." sh.p.k, me vlerë 34,731,300 lekë pa TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 3 muaj. Për mbikëqyrjen e punimeve titullarit i AK O.I, me Urdhër nr. 208/3 prot., datë 04.12.2023, ka caktuar F.D, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike. Për administrimin e kontratës është caktuar R.Z i cili sipas Urdhrit nr. 209/2 prot., është zëvendësuar me S.C.

Kontrata përfshin punime elektrike dhe është e ndarë në dy seksione. Sipas seksionit të parë është parashikuar furnizimi dhe vendosja e 6 çelave për funksione të ndryshme, si dhe vendosje kabulli TM dhe TU. Në seksionin e dytë është parashikuar furnizimi i një çele me kabllot përkatës, si dhe punime demontimi.

Njoftimi i fillimit të punimeve dhe procesverbali përkatës janë hartuar me datë 13.12.2023. Po ashtu, akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe akti i piketimit janë hartuar me datë 13.12.2023.

Gjatë zbatimit të kontratës janë mbajtur në mënyrë periodike akt-kontrolle teknike, është plotësuar ditari i objektit. Bazuar në ditarin e punimeve dhe në njoftimin përkatës, punimet kanë përfunduar me date 13.03.2024, brenda afatit të parashikuar në kontratë. Është paraqitur dokumentacion nga prodhuesi për materialet e vendosura në objekt. Është paraqitur dokumentacion për kolaudimin e pajisjeve të veçanta.

Gjatë zbatimit është certifikuar situacioni nr. 1, me vlerë 32,193,600 lekë pa TVSH dhe situacioni nr. 2 (përfundimtar) me vlerë 2,537,700 lekë. Për këtë kontratë janë certifikuar punime me vlerë 34,731,300 lekë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dispozicion, nga ana e Shoqërisë HEC Lanabregas Sh.a, nuk janë miratuar ndryshime të volumit të punimeve, krahasuar me ato të përshkruara në prevetivin e tenderuar.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike u konstatua se libreza e masave është hartuar duke shënuar vetëm sasitë përfundimtare, të cilat janë të njëjta me sasitë e parashikuara në preventiv, pa skica apo p ërllogaritje të tyre. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 610, datë 22.09.2022 "Për caktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjate zhvillimit të punimeve", neni 41, pika l, ku përcaktohet: "*Mbikëqyrësi i punimeve dhe zhvilluesi, për çdo objekt që ndërtohet, administrojnë në kantier dokumentacionin teknik dhe mbajnë përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e tij, si: librezën e masave, ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e punimeve, sipas shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*".

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. F.D.

Më poshtë paraqiten foto nga realizimi i punimeve.





Komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve është ngritur me Urdhër nr. 209/1 prot., i përbërë nga S.C, Z.GJ dhe A.V. Akti i marrjes në dorëzim të punimeve nga komisioni i mësipërm është mbajtur me nr. 105/2 prot., datë 15.05.2024.

Komisioni i marrjes në dorëzim të materialeve të demontuar është ngritur me Urdhër nr. 12 prot., datë 08.01.2024, i përbërë nga S.C, A.L dhe A.V. Bazuar në Procesverbalin nr. 109/1 prot., datë 15.05.2024, janë marrë në dorëzim materialet e demontuar si më poshtë:


Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Panele komandimi 6 kV, karrocë, B.S H/C Tiranë	copë	8
2	Demontim kabllo ekzistues kontrolli dhe fuqie	set	1
3	Demontim kanalin dhe aksesorë të tjerë montimi	set	1

Materialet e demontuar janë bërë hyrje në magazinë sipas fletë hyrjes nr. 1, datë 14.05,2024. Marrja në dorëzim e materialeve kabllo ekzistues kontrolli dhe fuqie, në formën e set-it, pa përcaktuar dimensione dhe peshë (specifikimet), është bërë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar, pika 38, ku përcaktohet: "*Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes në dorëzim të aktiveve, referuar kushteve të përcaktuara në kontratë*).

Për kolaudimin e punimeve është përzgjedhur Shoqëria "V." ShPK. Akti i kolaudimit është mbajtur me datë 24.09.2024.

Me datë 05.12.2025, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt. Nga verifikimi rezultoi se linjat e rikonstruktuara janë në funksionim normal. Çelat e vjetra, të cilat janë vendosur në ruajtje në ambientet e HEC janë zëvendësuar me të reja. Kabllot e vendosura janë të pa matshme, për arsye të funksionimit me ngarkesë të lartë energjie. kabllot e vjetra janë magazinuar në ambientet e HEC Lanabregas, korridore apo ambiente pune, por jo në një magazinë të caktuar për këtë qëllim. Ato janë grumbulluar së bashku me kabllo të tjerë të dala nga zëvendësimi i kabllove të një kontrate të mëparshme të realizuar në këtë HEC (Faza e parë) dhe është i pamundur identifikimi i sasisë së tyre.

Më poshtë paraqiten foto të materialit të demontuar.



Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Materialeve të Demontuara i përbërë nga: S.C, A.L dhe A.V.

<u>Konkluzion</u>: Investimi i realizuar ka dhënë një ndikim pozitiv, duke marrë në konsideratë se pajisjet ekzistuese ishin shumë të amortizuara, si pasojë e një përdorimi në një kohë shumë të gjatë.
Materialet e demontuar nuk janë bërë hyrje në magazinë sipas specifikimeve, apo sasisë, por në set, në pamundësi për verifikim të tyre. Sa i përket vendosjes së kabllove, saktësimi i sasisë reale të hequr, do të kolaudonte me saktësimin e sasisë së vendosur. Vendosja e tyre në vende të papërshtatshme, ka krijuar problematika në funksionimin normal të ambienteve të punës së këtij HEC-i.

Për sa konstatohet në situatën e mësipërme kanë përgjegjësi: Mbikëqyrësi i punimeve F.D, dhe Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Materialeve të Demontuara i përbërë nga S.C, A.L dhe A.V.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar HEC-Lanabregas janë paraqitur observacioni me shkresën nr. 143/1 prot, datë 11.06.2026 *(prot KLSH nr. 983/4, dt. 11.06.2026)* "*Mbi Projekt Raportin e Auditimit*" nga F.S me detyrë Administrator i shoqërisë HEC-Lanabregas, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit</u>:

Bazuar në të dhënat e librezave të masave të paraqitura në situacionin nr. 1 dhe situacionin nr.2 janë paraqitur me të njëjtin format, nuk janë pasqyruar vetëm "skica" e zërit. Kjo për arsye se njësite matëse të të gjithë zërave të punimeve janë ml, copë dhe set, nuk ka pasur prerje tërthore kanalesh apo shtresave për të pasqyruar dimensionet. Dimensionimi vetëm në gjatësi është paraqitur në librezën përkatëse të masave dhe në situacionet nr.1 dhe nr.2. të gjitha zërat e punimeve.

Gjatë paraqitjes së volumeve për secilin prej librezave të masave dhe situacioneve janë hedhur të gjithë zërat sipas punimeve të realizuara. Gjatë zbatimit të investimit, dhe në përfundim të tij (pasqyruar në situacionin nr.2 - përfundimtar) sasitë e situacionit nr.1, situacionit nr.2, përfundimtar, situacioni progresiv dhe realizimi në përqindje.

F.V. të pajisjeve në copë (Çela), janë të numërueshme në çdo moment, janë të pasqyruara në situacion.

F.V. të pajisjeve në copë në pjesët rezervë (Seksioni 5), janë të numërueshme në çdo moment (hyrje në magazinë), janë të pasqyruara në situacion.

F.V. të kabllove të niveleve të ndryshme të tensionit, janë të montuar kryesisht në kanalin, apo fiksuar në gjendje ku mund të aksesohen në çdo moment pa pasur nevoje për të ndërprere prodhimin apo stakuar energjinë.

F.V. të kabllove të tensionit 6-7.2 kV apo aksesorët në pjesët e hyrjeve të çelave apo lidhjes në gjenerator matjet e kabllove realizohet në momente të shkurtra të ndërprerjes së gjenerimit të energjisë.

Ndodhur në kushtet kur sasia e kabllove TM apo edhe TU që janë montuar për t'u mundësuar lidhjen e të gjithë nyejve, transmetimin e energjie dhe për realizimin e investimit të plotësuar, sasitë e parashikuara në preventivin fillestar rezultoi se ishte i njëjtë apo i pamjaftueshëm, në disa zëra u desh të vendosej sasi më shumë nga preventivi.

Për sa më sipër, sasitë mbi ato të parashikuara në preventive nuk janë pasqyruar pasi kalonte vlera totale e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik.
Marrja në dorëzim set është bërë bazuar në zërat e preventivit, seksioni II pika 4. Miratimi i bërë në situacionin 2, përfundimtar dhe zërat e punimeve nuk mundet të ndryshojmë përshkrimin e punës dhe njësitë.
Qëndrimi i Grupit të Auditimit:
- Në lidhje me hartimin e librezës së masave, sqarojmë se është i domosdoshëm realizimi i skicave, në këtë rast i vendosjes së kabullit sipas kateve, gjatësisë së kanalinave etj., me qëllim justifikimin e sasive të cilat dalin nga skicat respektive.
Sa i përket çelave, pajisjeve në copë etj., janë verifikuar dhe nuk kanë rezultuar diferenca. Në lidhje me kabllot kishte vështirësi matjeje në prezencë të energjisë elektrike, por që gjithsesi nuk është konsideruar se ka diferenca. Sasitë më tepër të vendosura duhet të reflektoheshin në librezën e masave.
- Në lidhje me zërin e preventivit, seksioni II, pika 4, sqarojmë se përcaktimi set, ka të bëjë me shpenzime punëtorie dhe makinerie për demontimin dhe jo me sasinë e materialit. Pavarësisht se në preventiv është përcaktuar set, në marrjen në dorëzim të këtyre materialeve dhe më tej magazinimin, duhet të përcaktohet saktë masa (gjatësi, peshë etj).

2.5. Mbi auditimin e organizimit dhe mbajtjes së evidencës kontabël, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprore; zbatimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj., ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

Shoqëria "HEC Lanabregas SHA është regjistruar në QKR më datë 18.07.2014 dhe është pajisur me NIPT L.....E. Adresa e selisë qendrore së shoqërisë është "Tiranë Dajt Lanabregas, Komuna Dajt". Aktiviteti kryesor i kësaj është prodhimi e shitja i energjisë elektrike.

- *Për organizimin dhe mbajtjen e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen e miratimin e pasqyrave financiare.*

Kuadri ligjor: Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 " Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar si dhe gjithë paketës ligjore fiskale në fuqi për periudhën ushtrimore kontabël viti 2023 dhe 2024.
Kuadri kontabël i aplikuar: Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara në Shqipëri, SKK hyrë në fuqi nëpërmjet Urdhrit nr. 64, datë 22.07.2014 "Për shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe komunikimet mbi mbajtjen e evidencës kontabël dhe miratimit të bilancit, rezultoi se:
Për vitin 2023, auditimi i pasqyrave financiare nga audituesit sipas kontratës ka përfunduar me datë 19.03.2024 dhe me shkresë nr. 80 prot., datë 26.03.2024 është dërguar për miratimin e pasqyrave financiare, ku Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA, Aksioner i Vetëm i Shoqërisë HEC Lanabregas SHA me Vendim nr. 2, datë 03.04.2024 ka vendosur Miratimin e bilancit dhe pasqyrave financiare të shoqërisë HEC Lanabregas SHA për vitin 2023 dhe fitimi neto në vlerën 69,366,443 lekë, të shpërndahet si divident për Aksionerin e shoqërisë HEC Lanabregas SHA, shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA.
Për vitin 2024, auditimi i pasqyrave financiare nga audituesit sipas kontratës ka përfunduar me datë 27.03.2025 dhe me shkresë nr. 168 prot., datë 29.05.2025 është dërguar për miratimin e pasqyrave financiare, ku Ujësjellës Kanalizime Tiranë SHA, Aksioner i Vetëm i Shoqërisë HEC Lanabregas SHA me Vendim nr. 5, datë 20.06.2025 ka vendosur Miratimin e bilancit dhe pasqyrave financiare të shoqërisë HEC Lanabregas SHA për vitin 2024 dhe fitimi neto në vlerën 23,603,534 lekë, të kalojë për investime e kryera të shoqërisë HEC Lanabregas SHA.

- **Pasqyra e pozicionit Financiar më 31.12.2023.**

Analiza e aktiveve afatgjata për vitin 2023

Gjendjet e Aktiveve Afatgjata Materiale në Pasqyrat Financiare për vitin 2023, paraqitet si vijon:

Në lekë

Nr.	Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	Gjendja me datë 01.01.2023	Blerë e krijuar	Pakësuar	Gjendja në datë 31.12.2023
1	**Toka troje terrene**	**26,050,738**	**0**	**0**	**26,050,738**
2	**Ndërtesa Ndërtime**	**69,930,475**	**0**	**0**	**69,930,475**
a	*Ndërtesa ndërtime*	*52,017,285*	*0*	*0*	*52,017,285*
b	*Studime projektime*	*17,913,190*	*0*	*0*	*17,913,190*
2	**Makineri e pajisje**	**141,235,066**	**5,930,100**	**0**	**147,165,166**
a	*Instalime teknike*	*130,899,391*	*652,500*	*0*	*131,551,891*
b	*Mjete transporti*	*10,335,675*	*5,277,600*	*0*	*15,613,275*
3	**Të tjera AAGJ Materiale**	**5,167,365**	**100,000**	**0**	**5,267,365**
a	*Pajisje Zyre*	*2,145,265*	*100,000*	*0*	*2,245,265*
b	*Pajisje informatike*	*3,022,100*	*0*	*0*	*3,022,100*
	Totali	**242,383,644**	**6,030,100**	**0**	**248,413,744**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi.*

Nga auditimi u konstatua se vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAGJM, të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të periudhës.

Pasqyrimi i tyre në Pasqyrat financiare është bërë me vlerën kontabël neto pas zbritjes së amortizimit të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	Gjendja me datë 01.01.2023	Amortizimi akumuluar	Baza llogaritjes	%	Amortizimi vjetor	Amortizimi i Akumuluar	Gjendja në mbyllje
1	**Toka troje terrene**	**26,050,738**	**0**	**26,050,738**		**0**	**0**	**26,050,738**
2	**Ndërtesa Ndërtime**	**69,930,475**	**4,886,057**	**65,044,418**		**652,641**	**5,538,698**	**64,391,777**
a	*Ndërtesa ndërtime*	*52,017,285*	4,886,057	*47,131,228*	5%	*652,641*	*5,538,698*	**46,478,587**
b	*Studime projektime*	*17,913,190*		*17,913,190*		*0*	*0*	**17,913,190**
2	**Makineri e pajisje**	**141,235,066**	**34,001,000**	**107,234,066**		**7,620,195**	**41,621,195**	**105,543,971**
a	*Instalime teknike*	*130,899,391*	*26,476,325*	*104,423,066*	20	*5,820,435*	*32,296,760*	*99,255,131*
b	*Mjete transporti*	*10,335,675*	*7,524,675*	*2,811,000*	20	*1,799,760*	*9,324,435*	*6,288,840*
3	**Të tjera AAGJM**	**5,167,365**	**4,137,648**	**1,029,717**		**445,552**	**4,583,200**	**684,165**
a	*Pajisje Zyre*	*2,145,265*	*1,983,048*	*162,217*	20	*115,552*	*2,098,600*	*146,665*
b	*Pajisje informatike*	*3,022,100*	*2,154,600*	*867,500*	20	*330,000*	*2,484,600*	*537,500*
	Totali	**242,383,644**	**43,024,705**	***199,358,939***		**8,718,388**	**51,743,093**	**196,670,651**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Sa më lart në llogaritjen e amortizimit janë mbajtur parasysh kërkesat e Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 22, me vlerën e mbetur të aktivit.

Analiza e aktiveve afat shkurtra.

Gjendja në fillim lëvizjet gjatë vitit dhe gjendja në fund të vitit e aktiveve afatshkurtra paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Aktive afatshkurtër	Gjendja me datë 01.01.2023	Shtesa	Pakësuar	Gjendja në datë 31.12.2023
1	Vlera monetare në Bankë	**19,417,095**	295,014,881	255,659,798	**58,772,178**
2	Inventarët	**5,983,531**	88,402,906	86,471,406	**7,915,031**
3	Klientë	**46,890,359**	274,419,762	295,014,881	**26,295,240**
4	Të tjera të arkëtueshme	**1,863,082**	210,000	1,485,877	**614,205**
5	Shpenzime të shtyra	**13,021,667**	58,275	46,650	**13,033,292**
	Totali	**87,175,734**	**658,105,824**	**638,651,612**	**106,629,946**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Nga të dhënat rezultoi se në zërin "*Të drejta të arkëtueshme*" janë pasqyruar te drejtat (llogaritë e arkëtueshme) që HEC Lanabregas ka për klientin Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) për detyrimet e pashlyera ndaj furnizimeve te faturuara për energji elektrike, gjatë vitit ushtrimor 2023, të cilat në fund të periudhës janë për vlerën 26,295,240 lekë dhe kanë të bëjnë me faturimet në fund të periudhës muaji dhjetor i cili shlyhet në janar të vitit pasardhës.

3 Analiza e Detyrimeve afatshkurtër

Nga të dhënat rezultoi se detyrimet në fund të periudhës paraqiten në tabelën si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Detyrime sipas zërave	Gjendja me datë 01.01.2023	Shtesa	Pakësuar	Gjendja në datë 31.12.2023
1	Furnitorë për mallra e shërbime	**(21,938,761)**	145,293,892	133,818,517	**(10,463,386)**
2	Të pagueshme ndaj punojsave	**(2,444,275)**	29,236,298	29,328,935	**(2,536,912)**
a	*Paga e shpërblime*	*(1,394,475)*	*20,788,564*	*20,782,589*	*(1,388,500)*
b	*Sigurime shoqërore*	*(1,049,800)*	*8,447,734*	*8,546,346*	*(1,148,412)*
3	Detyrime Tatimore	**(937,971)**	6,796,115	12,723,337	**(6,865,193)**
a	*Tatim fitimi*	*(911,994)*	*8,938,165*	*12,393,985*	*(4,367,814)*
b	*TVSH*	*-*	*(2,469,933)*	*-*	*(2,469,933)*
c	*Tatim në burim*	*-25,977*	*327,883*	*329,352*	*(27,446)*
4	Të pagueshme të tjera	**-134,453**	1,845,228	1,866,288	**(155,513)**
a	*Këshilli mbikëqyrës*	*-134,453*	*1,845,228*	*1,866,288*	*(155,513)*
	Totali	**(25,455,460)**	**183,171,533**	**177,737,077**	**(20,021,004)**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Zërat e "*Detyrimeve afatshkrutra*" në bilanc janë të detajuara në llogaritë përkatëse të furnitorëve, pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim të cilat deklarohen dhe janë likuiduar në janar të vitit pasardhës, rezultoi se detyrime të pashlyera të periudhave të mëparshme nuk ka.

Detyrimet për furnitorët në fund të periudhës 31.12.2023, në vlerën 10,463,386 lekë janë të analizuara si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Detyrime për Furnitorë.	Gjendja me datë 31.12.2023
1	A.... SHA	304
2	Ujësjellës Kanalizime Tiranë	693
3	A... SHA	12,000
4	Furnizuesi i shërbimit universal	20,882
5	V...	51,664
6	A...	130,500
7	F.A	167,460
8	Furnizuesi i Tregut të Lirë	187,849
9	I.G	425,748
10	Ujësjellës Kanalizime Tiranë	9,466,286
	Totali	**10,463,386**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Në totalin e detyrimeve për furnitorë peshën më të madhe e zënë detyrimet që shoqëria HEC Lanabregas SHA ka ndaj UKT për furnizimin me ujë në vlerën 9,466,286 lekë ose 90% e totalit, për të cilat janë fatura të muajit të fundit të vitit që likuidohet në muajin pasardhës të vitit.

Pasqyra e pozicionit Financiar më 31.12.2024.

Analiza e aktiveve afatgjata për vitin 2024

Gjendjet e Aktiveve Afatgjata Materiale në Pasqyrat Financiare për vitin 2024, paraqitet si vijon:

Në lekë

Nr.	Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	Gjendja me datë 01.01.2024	Blerë e krijuar	Pakësuar	Gjendja në datë 31.12.2024
1	**Toka troje terrene**	**26,050,738**	**0**	**0**	**26,050,738**
2	**Ndërtesa Ndërtime**	**69,930,475**	**0**	**0**	**69,930,475**
a	*Ndërtesa ndërtime*	*52,017,285*	*0*	*0*	*52,017,285*
b	*Studime projektime*	*17,913,190*	*0*	*0*	*17,913,190*
2	**Makineri e pajisje**	**147,165,166**	**34,680,953**	**0**	**181,846,119**
a	*Instalime teknike*	*131,551,891*	*34,680,953*	*0*	*166,232,844*
b	*Mjete transporti*	*15,613,275*	*0*	*0*	*15,613,275*
3	**Të tjera AAGJ Materiale**	**5,267,365**	**837,547**	**0**	**6,104,912**
a	*Pajisje Zyre*	*2,245,265*	*0*	*0*	*2,245,265*
b	*Pajisje informatike*	*3,022,100*	*837,547*	*0*	*3,859,647*
	Totali	**248,413,744**	**35,518,500**	**0**	**283,932,244**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Nga auditimi u konstatua se vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAGJM, të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të periudhës.
Pasqyrimi i tyre në Pasqyrat financiare është bërë me vlerën kontabël neto pas zbritjes së amortizimit të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	Gjendja me datë 01.01.2024	Amortizimi akumuluar	Baza llogaritjes	%	Amortizimi vjetor	Amortizimi i Akumuluar	Gjendja në mbyllje
1	**Toka troje terrene**	**26,050,738**	**0**	**26,050,738**		**0**	**0**	**26,050,738**
2	**Ndërtesa Ndërtime**	**69,930,475**	**5,538,689**	**64,391,777**		**652,641**	**6,191,339**	**63,739,136**
a	*Ndërtesa ndërtime*	*52,017,285*	5,538,698	*46,478,587*	5%	*652,641*	*6,191,339*	**45,825,946**
b	*Studime projektime*	*17,913,190*	0	*17,913,190*		*0*	*0*	**17,913,190**
2	**Makineri e pajisje**	**147,165,166**	**41,621,195**	**105,543,971**		**7,486,149**	**49,107,344**	**132,738,775**
a	*Instalime teknike*	*131,551,891*	*32,296,760*	*99,255,131*	20	*5,746,629*	*38,043,389*	*128,189,455*
b	*Mjete transporti*	*15,613,275*	*9,324,435*	*6,288,840*	20	*1,739,520*	*11,063,955*	*4,549,320*
3	**Të tjera AAGJM**	**5,267,365**	**4,583,200**	**684,165**		**559,387**	**5,142,586**	**962,326**
a	*Pajisje Zyre*	*2,245,265*	*2,098,600*	*146,665*	20	*40,000*	*2,138,600*	*106,665*
b	*Pajisje informatike*	*3,022,100*	*2,484,600*	*537,500*	20	*519,387*	*3,003,987*	*855,660*
	Totali	**248,413,744**	**51,743,093**	***196,670,651***		**8,698,177**	**60,441,270**	**223,490,974**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Sa më lart në llogaritjen e amortizimit janë mbajtur parasysh kërkesat e Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 22, me vlerën e mbetur të aktivit.

Analiza e aktiveve afat shkurtra.

Gjendja në fillim lëvizjet gjatë vitit dhe gjendja në fund të vitit e aktiveve afatshkurtra paraqitet si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Aktive afatshkurtër	Gjendja me datë 01.01.2024	Shtesa	Pakësuar	Gjendja në datë 31.12.2024
1	Vlera monetare në Bankë	**58,772,178**	176,390,944	181,016,124	**54,146,998**
2	Inventarët	**7,915,031**	55,067,767	57,037,377	**5,945,421**
3	Klientë	**26,295,240**	181,613,400	176,255,880	**31,652,760**
4	Të tjera të arkëtueshme	**614,205**	7,366,352	473,287	**7,507,270**
5	Shpenzime të shtyra	**13,033,292**	1,916,215	58,292	**14,891,215**
	Totali	**106,629,946**	**422,354,678**	**414,840,960**	**114,143,664**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Nga të dhënat rezultoi se në zërin "*Të drejta të arkëtueshme*" janë pasqyruar te drejtat (llogaritë e arkëtueshme) që HEC Lanabregas ka për klientin Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) për detyrimet e pashlyera ndaj furnizimeve te faturuara për energji elektrike, gjatë vitit ushtrimor 2024, të cilat në

fund të periudhës janë për vlerën 31,652,760 lekë dhe kanë të bëjnë me faturimet në fund të periudhës muaji dhjetor i cili shlyhet në janar të vitit pasardhës.

Konkluzion: Në lidhje me vlerën e paraqitura në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe 2024 në Aktivet afatshkurtër, zëri shpenzime të shtyra përfaqëson edhe vlerën e kontratës së lidhur midis shoqërisë HEC Lanabregas sha dhe shoqërisë "D... P...r Ẅ...-T... R... G...", me objekt "*Ofrimi i Shërbimeve të Specializuara Ligjore dhe Rregullatorë në lidhje me Energjinë nga burime të Rinovueshme në favor të HEC Lanabregas SHA*" në vlerën 12,975,000 lekë pa TVSh që i përket periudhës viti 2019 e cila është realizuar nga pala e kontraktuar. Nga Shoqëria HEC Lanabregas për periudhën pas realizimit të saj nuk ka afruar shërbime për operatorë të tjerë pra nuk ka realizuar të ardhura. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu II, pikat 17 18 dhe 23 germa g).

3 Analiza e Detyrimeve afatshkurtër

Nga të dhënat rezultoi se detyrimet në fund të periudhës paraqiten në tabelën si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Detyrime sipas zërave	Gjendja me datë 01.01.2024	Shtesa	Pakësuar	Gjendja në datë 31.12.2024
1	Furnitorë për mallra e shërbime	**(10,463,386)**	110,004,542	124,781,629	**(25,240,473)**
2	Të pagueshme ndaj punonjësve	**(2,536,912)**	39,090,852	39,800,498	**(3,246,559)**
a	*Paga e shpërblime*	*(1,388,500)*	*27,364,834*	*27,751,393*	*(1,775,059)*
b	*Sigurime shoqërore*	*(1,148,412)*	*11,726,018*	*12,049,105*	*(1,471,500)*
3	Detyrime Tatimore	**(6,865,193)**	4,839,275	9,846	**(2,035,764)**
a	*Tatim fitimi*	*(4,367,814)*	*4,367,814*	*0*	*0*
b	*TVSH*	*(2,469,933)*	*0*	*(501,534)*	*(1,968,399)*
c	*Tatim në burim*	*(27,446)*	*471,461*	*511,380*	*(67,365)*
4	Të pagueshme të tjera	**(155,513)**	2,671,610	72,111,263	**(69,595,166)**
a	*Këshilli mbikëqyrës*	*(155,513)*	*2,671,610*	*2,744,820*	*(228,723)*
b	*Dividend për tu paguar*			*69,366,443*	*(69,366,443)*
	Totali	**(20,021,004)**	**156,606,279**	**236,703,236**	**(100,117,962)**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Zërat e "*Detyrimeve afatshkrutra*" në bilanc janë të detajuara në llogaritë përkatëse të furnitorëve, pagave, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhurat, tatim në burim të cilat deklarohen dhe janë likuiduar në janar të vitit pasardhës, rezultoi se shoqëria HEC Lanabregas SHA në fund të periudhës ka detyrime të pashlyera për divitent ndërsa detyrime të pashlyera të periudhave të mëparshme nuk ka.

Detyrimet për furnitorët në fund të periudhës 31.12.2024, në vlerën 25,240,473 lekë janë të analizuara si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Detyrime për Furnitorë.	Gjendja me datë 31.12.2024
1	Furnizuesi tregut të Lirë	548,856
2	P... I...	75,840
3	A... SHA	12,000
4	V... E....g	91,600
5	B/M	114,000
6	F... P... ShPK	117,252
7	M.TH	135,000
8	V... A...	135,248
9	B.TH	153,000
10	F.A	167,460
11	E.XH	237,660
12	I... G... SHA	525,243
13	Al....	920,304
14	I... ShPK	3,045,240
15	UKT	17,997,076
	Totali	**25,240,473**

Burimi: *Të dhëna nga subjekti, përpunuara nga grupi*

Në totalin e detyrimeve për furnitorë peshën më të madhe e zënë detyrimet që shoqëria HEC Lanabregas SHA ka ndaj UKT për furnizimin me ujë në vlerën 17,997,076 lekë ose 71% e totalit, për të cilat janë fatura të muajit të fundit të vitit që likuidohet në muajin pasardhës të vitit.

Konkluzion*:* Nga auditimi u konstatua se nga HEC Lanabregas SHA nuk ka hartuar e miratuar rregullore për menaxhimin e aktiveve, për ruajtjen e tyre, përcaktimin e personave përgjegjës për rastet e dëmtimeve apo mungesave gjatë procesit të inventarizimit. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 9, germa **"ë",** ku përcaktohet .....*përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar* dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 5, ku përcaktohet .....*Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.*

Konkluzion*:* Në vlerën e AAGJM në pasqyrat financiare janë paraqitur studime e projektime në proces në vlerën 17,913,190 lekë që kanë të bëjnë me projekte të cilat i përkasin periudhave 2017 dhe 2019 me qëllim zëvendësimin e pajisjeve të vjetra të HEC-it *(Studim për sistemin e mbrojtjes në vlerën 2,968,000 lekë që i përket periudhës viti 2017, Studim për sistemin hidrmekanik në vlerën 2,955,000 lekë, që përket periudhës viti 2017, Hartim projektit zbatimit dhe preventivit për ndërlidhjen e Turbinës së HEC Guri Bardhë me pajisjet e HEC Lanabregas në vlerën 1,818,960 lekë, që i përket periudhës viti 2019, Studim dhe hartim i projektit zbatimit dhe preventivit të punimeve për rehabilitimin e HEC Lanabregas në vlerën 10,717,230 lekë, që i përket periudhës viti 2019)* për të cilat nga shoqëria HEC Lanabregas SHA, nuk janë vënë në zbatim të cila mbartin riskun e mospërmbushjes së objektivave për përdorimin e aktiveve afatgjata nga pikëpamja e vlerave, përmirësimin në strukturën e tyre për një periudhë të caktuar duke siguruar efiçensën e fondeve të përdorura për përmirësimin e tyre. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", Kreu II, pikat 17 18 dhe 23 germa g).

- *Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore).*

Nga të dhënat rezultoi se për kryerjen e inventarizimit fizik të llogarive inventariale të HEC Lanabregas SHA, nga Administratori i shoqërisë për vitin 2023, ka dalë urdhëri nr. 215, datë 01.12.2023 "Për kryerjen e inventarit fizik dhe kontabël të pasurisë së shoqërisë HEC Lanabregas SHA për vitin 2023", me afat përfundimi brenda datës 31.12.2023 dhe për vitin 2024, urdhëri nr. 345, datë 03.12.2024 "Për ngritjen e grupit të punës për kryerjen e inventarizimit të gjendjes fizike në magazinat e shoqërisë HEC Lanabregas SHA".
Grupi i inventarizimit pas përfundimit të procesit ka përgatitur relacion për vitin 2023, me shkresën nr. 215/3 prot., datë 29.12.2023 dhe për vitin 2024, relacion me shkresën nr. 345/3 prot., datë 30.12.2024 mbi konstatimet dhe rezultatet e inventarizimeve të kryera për periudhën objekt auditimi.
Në relacionet e grupeve të auditimit rezultoi se mungesat apo teprica nuk ka përveçse materialeve në vlerën 450.680 lekë, të vjedhura në vitin 2013 për të cilat është mbajtur procesverbal datë 05.09.2013 dhe është bërë kallëzim në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë e cila ka lëshuar vërtetim nr. 48831 Prot. Datë 14/12/2015 në të cilin është shprehur se çështja është pezulluar për moszbulim të autorit të veprës penale dhe dosja është dërguar për hetime të mëtejshme në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë.

2.6. Auditimi mbi zbatimin e ligjshmërisë për planifikimin dhe zbatimin e treguesve ekonomik dhe financiar të shoqërisë.

- **Periudha 2023**

Në lidhje me realizimin e treguesve të prodhimit, investimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023, vërehet se me datë 01.12.2022, Administratori i HEC Lanabregas SHA, me shkresën nr. 317 Prot., i ka dërguar për miratim Planin Ekonomiko-Financiar për vitin 2023, Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.

Planin Ekonomiko-Financiar për vitin 2023, është miratuar me Vendimin Nr. 37, datë 31/10/2023 "Për Miratimin e Ndryshimeve të Planit Ekonomiko-Financiar të Rishikuar për Vitin 2023", i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë HEC Lanabregas SHA, siç tregohet në tabelën 1.

Tabela 1. *Realizimi i treguesve tekniko-ekonomik për periudhën janar-dhjetor 2023*

Nr.	EMËRTIMI	Njësia	12-Mujori (Janar-Dhjetor) 2023		Diferenca në Vlerë	Realizimi në %
			PLAN	FAKT		
I	**TREGUESIT E PRODHIMIT**					
1	Sasia e energjisë së prodhuar	000/kŵh	25,456.52	23,243.64	-2,212.88	91.31
2	Sasia e ujit të përdorur nga Hec	000/m3	18,328.70	16,735.42	-1,593.28	91.31
II	**INVESTIMET**		**42.74**	**41.28**	**-1.46**	**96.57**
1	Ndërtime dhe Instalime	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Makineri e Pajisje	mln/lekë	36.29	35.11	-1.18	96.75
3	Mjete Transporti	mln/lekë	5.40	5.28	-0.12	97.73
4	Pajisje e Orendi	mln/lekë	1.05	0.89	-0.16	84.50
5	Studime e Projektime	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
6	Investime të Tjera	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
III	**TREGUESIT E PUNËS**					
	Numri i Punonjësve	nr.mes	34	28	-6.00	82.35
	Fondi i pagave	mln/lekë	26.18	21.39	-4.79	81.70
	Paga mesatare mujore	lekë	64,163	63,655	-508.03	99.21
IV	**TË ARDHURAT**		**250.81**	**228.68**	**-22.13**	**91.18**
	Të ardhura nga shitja e energjisë	mln/lekë	250.81	228.68	-22.13	91.18
	Të ardhura të tjera financiare	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
V	**SHPENZIMET**		**170.47**	**148.45**	**-22.02**	**87.08**
1	**Disbalanca nga prodhimi i Energjisë Elektrike**	**mln/lekë**	**6.41**	**3.14**	**-3.27**	**49.02**
2	**Materiale të Para e Materiale të Tjera**	**mln/lekë**	**3.11**	**2.61**	**-0.50**	**83.85**
	Materiale të para, elektrike, ndihmëse etj.	"	3.11	2.61	-0.50	83.85
	Veshje të ndryshme pune	"	0.00	0.00	0.00	0.00
3	**Furnitura dhe Shërbime**	**mln/lekë**	**110.91**	**99.34**	**-11.57**	**89.57**
	Shpenzime uji për prodhimin e en. el.	"	91.64	83.68	-7.97	91.31
	Karburant	"	2.04	1.40	-0.64	68.54
	Qera ambiente zyrash	"	2.16	2.14	-0.02	98.98
	Roje objektesh	"	4.26	4.26	0.00	100.00
	Sigurim Prone	"	0.98	0.98	0.00	100.00
	Sigurim jete dhe shendeti për punonjesit	"	0.98	0.81	-0.18	82.07
	Shërbime, riparime, mirëmbajtje	"	3.30	1.62	-1.68	49.16
	Mirëmbajtje për automjetet	"	0.60	0.17	-0.42	29.05
	Siguracion dhe kontroll teknik i makinave	"	0.29	0.29	0.00	100.91
	Shpenzime kancelarie	"	0.10	0.10	0.00	100.00
	Personel i jashtëm (K/Mbikëqyrës)	"	2.22	2.20	-0.03	98.74
	Shpenzime konsulence tek-ekonomik	"	0.80	0.80	0.00	100.00

Nr.	EMËRTIMI	Njësia	12-Mujori (Janar-Dhjetor) 2023		Diferenca në Vlerë	Realizimi në %
			PLAN	FAKT		
	Shpenzime mbikqyrje dhe kolaudimi	"	0.14	0.09	-0.05	66.37
	Shpenzime Udhëtim e Dieta	"	0.20	0.00	-0.20	0.00
	Shpenzime poste dhe interneti	"	0.06	0.06	0.00	100.00
	Shpenzime telefoni	"	0.13	0.11	-0.02	83.33
	Shërbime bankare	"	0.06	0.06	0.00	105.29
	Shpenzime të përgjithshme	"	0.95	0.58	-0.37	60.87
4	**Shpenzime Personeli**	**mln/lekë**	**35.77**	**29.72**	**-6.06**	**83.07**
	Fondi pagave gjithsej	"	26.18	21.39	-4.79	81.70
	Trajtimi ushqimor i punonjësve	"	2.04	1.65	-0.39	80.88
	Shpërblim	"	2.61	2.60	-0.01	99.81
	Paga jashtë orarit	"	0.20	0.20	0.00	97.86
	Sigurime shoqërore	"	4.75	3.88	-0.87	81.76
5	**Tatime e Taksa**	**mln/lekë**	**1.07**	**1.16**	**0.10**	**109.11**
	Taksa vendore dhe pasurie	"	0.45	0.45	0.00	100.22
	Taksa për automjetet	"	0.02	0.02	0.00	85.61
	Taksa ERE	"	0.60	0.70	0.10	116.56
	Taksa të tjera	"	0.00	0.00	0.00	0.00
6	**Gjoba penalitete dhe dëmshpërblime**	**mln/lekë**	**1.55**	**0.02**	**-1.53**	**1.30**
7	**Shpenzime për Zhvlerësimin e Aktiveve**	**mln/lekë**	**6.65**	**8.72**	**2.07**	**131.10**
8	**Shpenzime të jashtëzakonshme**	**mln/lekë**	**5.00**	**3.74**	**-1.27**	**74.70**
VI	**FITIMI**					
	Fitimi Para Tatimit	**mln/lekë**	**80.34**	**80.23**	**-0.11**	**99.87**
	Tatim Fitimi	**mln/lekë**	**12.05**	**12.04**	**-0.02**	**99.87**
	Fitimi/Humbja Neto	**mln/lekë**	**68.29**	**68.20**	**-0.09**	**99.87**

Burimi: *Nga të dhënat e HEC-Lanabregas, perpunuar nga grupi*

Energjia Elektrike e Prodhuar për vitin 2023 është 23,243,640 kŵh. Krahasuar me planin e rishikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2023 realizimi në përqindje është 91.31%. Krahasuar me realizimin e periudhës Janar-Dhjetor 2022 prodhimi është realizuar 8.57% më pak.

Investimet për vitin 2023, janë realizuar në vlerën 41,278,600 lekë. Krahasuar me planin e rishikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2023 realizimi në përqindje është 96.57%. Në krahasim me realizimin e periudhës Janar-Dhjetor 2022 investimet në total janë realizuar 171.80% më shumë duke qenë se fondi i parashikuar për vitin 2023 për Rikonstruksionin e Seksionit 6KV në HEC Lanabregas (Faza e Dytë), fond i cili zë pjesën më të madhe të totalit të investimeve, është më i lartë krahasuar me fondin e parashikuar për vitin 2022 për Rikonstruksionin e Seksionit 6 KV në HEC Lanabregas (Faza e Parë).

Nga shitja e Energjisë Elektrike janë gjeneruar të ardhura për vitin 2023 në total 228,683,135.38 lekë. Krahasuar me planin e rishikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2023 realizimi në përqindje është 91.18%. Në krahasim me realizimin e periudhës Janar-Dhjetor 2022 të ardhurat në total janë realizuar 5.02% më shumë.

Shpenzimet i përbëhen në pjesën më të madhe për sasinë e ujit të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike, disbalancave nga prodhimi energjisë si dhe plotësimit të nevojave për materiale, furniture e shërbime, shpenzime personeli, tatime e taksa etj. Për vitin 2023 ato janë realizuar në vlerën 148,449,331.92 lekë. Krahasuar me planin e rishikuar për periudhën Janar-Dhjetor 2023 realizimi në përqindje është 87.08%. Në krahasim me realizimin e periudhës Janar-Dhjetor 2022 shpenzimet në total janë realizuar 7.71% më pak.

Fitimi Neto i realizuar për vitin 2023 është 68,198,732.94 lekë. Krahasuar me planin e rishikuar për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 realizimi në përqindje është 99.87%. Në krahasim me realizimin e periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2022 fitimi neto është realizuar 41.00% më shumë.
Sasia e Energjisë së Prodhuar, Sasia e Ujit të përdorur nga Hec. Prodhimi energjisë elektrike do të konsiderohet sasia e energjisë së matur dhe shitur me F... SHA (O... GROUP).

Treguesit e prodhimit kanë të bëjmë me sasinë e energjisë së prodhuar nga HEC dhe sasinë e ujit të përdorur nga HEC. Sasia vjetore e energjisë elektrike të prodhuar në planin e rishikuar është përllogaritur bazuar në sasinë e energjisë së prodhuar për periudhën Janar-Shtator 2023 dhe në planin e pritshëm për periudhën Tetor-Dhjetor 2023. Nga kjo përllogaritje e sasisë së energjisë elektrike ndikohet dhe sasia e ujit të përdorur nga HEC si faktori kryesor për prodhimin e energjisë elektrike. Për prodhimin e fuqisë së instaluar 5000 kŵh është e nevojshme sasia e ujit 1000 litër/sekond. Kjo sasi uji sigurohet nga furnizim i UKT SHA., pra për rrjedhojë realizimi i prodhimit të energjisë elektrike është i varur tërësisht nga prurjet.
Në mënyrë të detajuar, tabela në vijim paraqet realizimin e treguesve të prodhimit të për periudhën Janar-Dhjetor 2023, krahasuar me planin e rishikuar për të njëjtën periudhë të vitit 2023 dhe gjithashtu krahasuar me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit 2022, sipas tabelës 2, si vijon.

Tabela 2: *Realizimi i Treguesve të Prodhimit për periudhën Janar-Dhjetor 2022-2023*

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	2022	2023		Diferenca			
			FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	PLAN 12-Mujori Janar-Dhjetor	FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*
I	**Treguesit e prodhimit**								
1	Sasia e energjisë së prodhuar nga Hec	kŵh	25,423,300.00	25,456,522.08	23,243,640.00	*-2,212,882.08*	*-8.69*	*-2,179,660.00*	*-8.57*
2	Sasia e ujit të përdorur nga Hec	m3	18,304,776.00	18,328,695.90	16,735,420.80	*-1,593,275.10*	*-8.69*	*-1,569,355.20*	*-8.57*

Burimi: *Të dhënat e subjektit, të përpunuara nga grupi*

Sasia e energjisë së prodhuar nga HEC-Lanabregas ashtu edhe sasia e ujit të përdorur janë realizuar 8.69% më pak se parashikimi i bërë për periudhën Janar-Dhjetor 2023, duke qenë se prodhimi i përgjigjet sasisë së ujit të furnizuar. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 këta tregues janë realizuar 8.57% më pak për shkak se prurjet e ujit kanë qenë më të pakta gjatë vitit 2023.

Sasia e energjisë së prodhuar në HEC-Lanabragas. Për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 prodhimi ishte parashikuar 25,456,522.08 kŵh dhe realizimi është 23,243,640.00 kŵh, në ërqindje 91.31%.
Në tabelën nr.3, është pasqyruar realizimi i prodhimit të energjisë elektrike për periudhën Janar-Dhjetor 2023 krahasuar me sasinë e parashikuar për të njëjtën periudhë, detajuara sipas muajve.

Tabela 3. *Realizimi Prodhimit të En. El. për periudhën Janar-Dhjetor krahasuar me planin*

MUAJI	Prodhimi Energjisë Elektrike (kŵh)		Realizimi në (%)
	PLAN	FAKT	
Janar	1,989,520.00	1,989,520.00	100.00
Shkurt	1,983,540.00	1,983,540.00	100.00
Mars	2,351,880.00	2,351,880.00	100.00

MUAJI	Prodhimi Energjisë Elektrike (kŵh)		Realizimi në (%)
	PLAN	FAKT	
Prill	2,230,970.00	2,230,970.00	100.00
Maj	2,259,200.00	2,259,200.00	100.00
Qershor	1,954,820.00	1,954,820.00	100.00
Korrik	1,859,130.00	1,859,130.00	100.00
Gusht	1,819,010.00	1,819,010.00	100.00
Shtator	1,434,630.00	1,434,630.00	100.00
Tetor	2,326,311.62	1,125,730.00	48.39
Nëntor	2,390,848.98	2,043,940.00	85.49
Dhjetor	2,856,661.49	2,191,270.00	76.71
Total 12-Mujori	**25,456,522.08**	**23,243,640.00**	**91.31**

Burimi: *Të dhënat e subjektit, të përpunuara nga grupi.*

Realizimi prej 91.31% do të thotë se është prodhuar 8.69% më pak energji elektrike nga sa është parashikuar në total për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Sasia e ujit të përdorur nga Hec – Lanabragas. Për 1 kë nevojitet 0.72 m^3 ujë. Sasia e ujit të përdorur nga Hec llogaritet si sasia e energjisë së prodhuar shumëzuar me 0.72 m^3/kŵh. Për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 parashikimi ishte 18,328,695.90 m^3 dhe realizimi është 16,735,420.80 m^3, në përqindje 91.31%.

Investimet në HEC-Lanabregas. Investimet në total për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 janë parashikuar 42,743,371.67 lekë dhe realizimi për këtë periudhë është 41,278,600.00 lekë, në përqindje 96.57%. Në tabelën nr. 4, është paraqitur realizimi i të gjithë zërave të investimeve për periudhën Janar-Dhjetor, krahasuar me planin e rishikuar për të njëjtën periudhë të vitit 2023 dhe gjithashtu krahasuar me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit 2022.

Tabela 4. *Realizimi i Treguesve të Investimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2022-2023*

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	2022	2023		*Diferenca*			
			FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	PLAN 12-Mujori Janar-Dhjetor	FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*
II	**INVESTIMET**								
1	Ndërtime dhe Instalime	lekë	0.00	0.00	0.00	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*
2	Makineri e Pajisje Mjete	"	200.00 0.00	6,293,371.67	5,113,800.00	*-1,179,571.67*	*-3.25*	*0,526,600.00*	*0.72 0.00*
3	Transporti	"		5,400,000.00	5,277,600.00	*-122,400.00*	*-2.27*	*5,277,600.00*	
4	Pajisje e Orendi	"	600,000.00	1,050,000.00	887,200.00	*-162,800.00*	*-15.50*	*287,200.00*	*47.87*
5	Studime e Projektime	"	0.00	0.00	0.00	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*
6	Investime të Tjera	"	0.00	0.00	0.00	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*
	TOTALI		**15,187,200.00**	**42,743,371.67**	**41,278,600.00**	**1,464,771.67**	**-3.43**	**26,091,400.00**	**171.80**

Burimi: *Të dhënat e subjektit, të përpunuara nga grupi*

Makineri e Pajisje në HEC- Lanabregas. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 36,293,371.67 lekë dhe realizimi është 35,113,800.00 lekë, në përqindje 96.75%. Realizimi i këtij zëri i përket kryerjes së Rikonstruksionit të Seksionit 6 kv në HEC Lanabregas (faza e dytë) dhe gjithashtu blerjes së makinerive e pajisjeve të nevojshme për operimin në punë, si për mirëmbajtjen e pajisjeve të instaluara për prodhimin e energjisë elektrike ashtu dhe për mirëmbajtjen e ambienteve të jashtme dhe të brendshme. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 140.72% më shumë, duke qenë se fondi i parashikuar për vitin 2023 për kryerjen e Rikonstruksionit të Seksionit 6 kv në HEC Lanabregas (faza e dytë) është më i lartë krahasuar me fondin e parashikuar për vitin 2022 për kryerjen e Rikonstruksionit të Seksionit 6 kv në HEC Lanabregas (faza e parë), rrjedhimisht dhe realizimet i përkasin parashikimeve të bëra.

Mjete Transporti Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 5,400,000.00 lekë dhe realizimi është 5,277,600.00 lekë, në përqindje 97.73%. Realizimi i këtij fondi i përket blerjes së automjetit për plotësimin nevojave të administratës. Për periudhën Janar-Dhjetor 2022 nuk ka qenë parashikuar fond për këtë zë.

Pajisje e Orendi në HEC-Lanabragas. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 1,050,000.00 lekë dhe realizimi është 887,200.00 lekë, në përqindje 84.50%. Realizimi i këtij zëri i përket blerjes së dollapëve të nevojshëm për sistemimin e dokumenteve ndër vite për vijueshmërinë normale të punës, gjithashtu ky realizim i përket dhe pajisjes me kamera për monitorimin 24 orë të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të hidrocentralit dhe ambienteve të jashtme të zyrave të administratës, për të krijuar një siguri për mbarëvajtjen e mirë të punës. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 47.87% më shumë, duke qenë se për vitin 2023 është parashikuar fondi për monitorimin me kamera të ambienteve të jashtme dhe të brendshme të shoqërisë, fond i cili për vitin 2022 nuk ka qenë parashikuar, rrjedhimisht dhe realizimet i përkasin parashikimeve të bëra.

Realizimi i të gjithë treguesve të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2023, është paraqitur në tabelën nr. 5 krahasuar me planin e parashikuar për të njëjtën periudhë të vitit 2023 dhe gjithashtu krahasuar me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit 2022.

Tabela 5: *Realizimi i Treguesve të Punës për periudhën Janar-Dhjetor 2022-2023*

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	2022	2023		Diferenca			
			FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	PLAN 12-Mujori Janar-Dhjetor	FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*
III	**TREGUESIT E PUNËS**								
	Numri i Punonjësve	nr.mes	31.17	34.00	28.00	*-6.00*	*-17.65*	*-3.17*	*-10.16*
	Fondi i pagave	lekë	21,543,616.00	26,178,546.00	21,388,103.00	*-4,790,443.00*	*-18.30*	*-155,513.00*	*-0.72*
	Paga mesatare mujore	lekë	57,757.68	64,163.10	63,655.07	*-508.03*	*-0.79*	*5,897.38*	*10.21*

Burimi: *Të dhënat e subjektit, të përpunuara nga grupi*

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 Numrin Mesatar të Punonjësve është parashikuar 34 punonjës dhe është realizuar në 28 punonjës, në përqindje 82.35%. Paga Mesatare mujore është parashikuar 64,163.10 lekë dhe është realizuar 63,655.07 lekë, në përqindje 99.21%. Fondi i Pagave është parashikuar 26,178,546.00 lekë dhe është realizuar 21,388,103.00 lekë, në përqindje 81.70%, duke qenë se fondit i pagave përllogaritet bazuar në realizimin e numrit mesatar të punonjësve, prandaj kemi këtë përqindje realizimi duke qenë se numri i punonjësve për këtë periudhë nuk është realizuar 100%.

Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 realizimi i Numrit të Punonjësve është 10.16% më pak, ndërsa fondi i pagave është ulur me 155,513.00 lekë, kjo për arsye se numri punonjësve nuk është realizuar për të njëjtën periudhë në të njëjtën masë.

Të ardhurat në HEC- Lanabregas. Për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 Të Ardhurat gjithsej janë parashikuar 250,811,956.20 lekë dhe realizimi është 228,683,135.38 lekë, në përqindje 91.18%. Në tabelën nr. 6, është paraqitur realizimi i të gjithë zërave të të ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor 2023, krahasuar me planin e rishikuar për të njëjtën periudhë të vitit 2023 dhe gjithashtu krahasuar me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit 2022.

Tabela 6: *Realizimi i të Ardhurave për periudhën Janar-Dhjetor të viteve 2022-2023*

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	2022	2023		Diferenca			
			FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	PLAN 12-Mujori Janar-Dhjetor	FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*
IV	**TË ARDHURAT**								
1	Të ardhura nga shitja e energjisë	lekë	217,755,649.16	250,811,956.20	228,683,135.38	*-22,128,820.83*	*-8.82*	*10,927,486.22*	*5.02*
2	Të ardhura të tjera financiare	lekë	3,500.00	0.00	0.00	*0.00*	*0.00*	*-3,500.00*	*-100.00*
	TOTALI		**217,759,149.16**	**250,811,956.20**	**228,683,135.38**	***-22,128,820.83***	***-8.82***	***10,923,986.22***	***5.02***

Burimi: *Të dhënat e subjektit, të përpunuara nga grupi*

Siç shihet në tabelën e mësipërme të ardhurat në total janë realizuar 8.82% më pak se parashikimi i bërë për periudhën Janar-Dhjetor 2023. Kjo përqindje është si rezultat i realizimit më të ulët të zërit të ardhura nga shitja energjisë që vjen si efekt i realizimit më të ulët të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar për shitje i cili bazohet në prurjet e ujit të cilat kanë që të pakta për këtë periudhë. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 të ardhurat në total janë realizuar 5.02% më shumë. Në këtë rezultat ka ndikuar rritja e çmimit të shitjes së energjisë gjatë vitit 2023.

Shpenzimet në HEC-Lanabregas. Për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 Shpenzimet gjithsej janë parashikuar 170,472,599.63 lekë dhe realizimi është 148,449,331.92 lekë, në përqindje 87.08%. Në tabelën nr. 7, është paraqitur realizimi i të gjithë zërave të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2023, krahasuar me planin e rishikuar për të njëjtën periudhë të vitit 2023 dhe gjithashtu krahasuar me realizimin e të njëjtës periudhë të vitit 2022.

Tabela 7: *Realizimi i Shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor të viteve 2022-2023*

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	2022	2023		Diferenca			
			FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	PLAN 12-Mujori Janar-Dhjetor	FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*
V	**SHPENZIMET**								
1	Disbalanca nga prodhimi Energjisë Elektrike	lekë	8,682,084.83	6,412,497.91	3,143,429.80	*-3,269,068.11*	*-50.98*	*-5,538,655.03*	*-63.79*
2	Materiale të Para e Materiale të Tjera	lekë	1,826,380.00	3,112,640.00	2,610,000.00	*-502,640.00*	*-16.15*	*783,620.00*	*42.91*
3	Furnitura dhe Shërbime	lekë	108,119,181.93	110,910,146.83	99,339,470.12	*-11,570,676.71*	*-10.43*	*-8,779,711.81*	*-8.12*
4	Shpenzime Personeli	lekë	29,995,525.50	35,774,314.89	29,718,737.00	*-6,055,577.89*	*-16.93*	*-276,788.50*	*-0.92*
5	Tatime e Taksa	lekë	954,272.00	1,067,000.00	1,164,198.00	*97,198.00*	*9.11*	*209,926.00*	*22.00*
6	Gjoba penalitete dhe dëmshpërblime	lekë	16,385.00	1,546,000.00	20,109.00	*-1,525,891.00*	*-98.70*	*3,724.00*	*22.73*

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	2022	2023		Diferenca			
			FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	PLAN 12-Mujori Janar-Dhjetor	FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*
7	Shpenzime për Zhvlerësimin e Aktiveve	lekë	6,462,040.00	6,650,000.00	8,718,388.00	*2,068,388.00*	*31.10*	*2,256,348.00*	*34.92*
8	Shpenzime të jashtëzakonshme	lekë	4,800,000.00	5,000,000.00	3,735,000.00	*-1,265,000.00*	*-25.30*	*-1,065,000.00*	*-22.19*
	TOTALI		**160,855,869.26**	**170,472,599.63**	**148,449,331.92**	***-22,023,267.71***	***-12.92***	***-12,406,537.34***	***-7.71***

Burimi: *Të dhënat e subjektit, të përpunuara nga grupi*

Zëri që ndikon ndjeshëm në realizimin e shpenzimeve është zëri **shpenzime uji për prodhimin e energjisë elektrike**. Shpenzimet për blerjen e ujit zënë 56.37% të totalit të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023, ndërsa të gjitha shpenzimet e tjera në total zënë 43.63% të totalit të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023.

Siç shihet në tabelën e mësipërme shpenzimet gjithsej janë realizuar 12.92% më pak se parashikimi i bërë për periudhën Janar-Dhjetor 2023. Në uljen e shpenzimeve për këtë periudhë kanë ndikuar disa prej zërave të shpenzimeve si:

Disbalancat nga prodhimi energjisë elektrike, me 50.68% më pak se plani në të cilën ka ndikuar realizimi më i ulët i sasisë së energjisë së prodhuar për shitje mbi të cilën referohet dhe llogaritja e disbalancave nga prodhimi energjisë elektrike

Shpenzime uji për prodhimin e energjisë elektrike, me 8.69% më pak se plani duke qenë se shpenzimet për blerjen e ujit i referohen realizimit të sasisë së ujit të përdorur nga Hec e cila përllogaritet duke u bazuar në sasinë e energjisë së prodhuar

Materiale të para e materiale të tjera, me 16.15% më pak se plani i parashikuar për këtë periudhë, si rezultat i realizimit të procedurave nga proçesi prokurimit

Furnitura e shërbime, të tjera në total 10.43% më pak, në të cilën kanë ndikuar zërat si: karburant 31.46% më pak se parashikimi i bërë për vitin 2023, sigurim jete dhe shëndeti për punonjësit 17.93% më pak se parashikimi, shërbime riparime mirëmbajtje 50.84% më pak se parashikimi, mirëmbajtje për automjetet me 70.95% më pak se parashikimi, shpenzime mbikëqyrje dhe kolaudimi 33.63% më pak se parashikimi, udhëtime e dieta, e të tjera shpenzime të përgjithshme, përqindje të cilat do të argumentohen mëposhtme në zërat përkatës.

Shpenzime personeli, me 16.93% më pak se parashikimi i bërë për këtë periudhë si rezultat i mosrealizimit 100% të numrit të punonjësve i cili prek disa prej zërave të shpenzimeve të personelit si fondi i pagave, trajtimi ushqimor, sigurimet shoqërore

Gjoba penalitete dhe dëmshpërblime, me 98.70% më pak se plani i parashikuar për këtë periudhë, duke qenë së në këtë zë janë parashikuar dëmshpërblimet e mundshme që mund të vijnë si pasojë e vendimeve të gjykatave për punonjës të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës, çështje të cilat janë për rigjykim në Gjykatën e Apelit dhe duke qenë se këto vendime nuk janë marrë gjatë kësaj periudhe nga organet përkatëse rrjedhimisht nuk kemi realizim për këto shpenzimeve

Shpenzime të jashtëzakonshme, me 25.30% më pak se plani i parashikuar për këtë periudhë, përqindje e cila ka ardhur si rezultat i realizimit të procedurës nga procesi prokurimit, procedurë e cila është realizuar bazuar në nevojën e domosdoshme për riparimin e transformatorit të fuqisë për të shmangur humbjet në prodhimin e energjisë .

Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 shpenzimet gjithsej janë realizuar 7.71% më pak. Në këtë rezultat ka ndikuar realizimi më i ulët i disbalancave nga prodhimi energjisë elektrike, shpenzimeve të ujit për prodhim energjie, shërbimeve riparimeve mirëmbajtjeve, mirëmbajtjeve për automjetet, shpenzimeve për mbikëqyrje dhe kolaudim, shpenzimeve të personelit si rezultat i realizimit më të ulët të numrit mesatar të punonjësve për këtë periudhë etj., të cilat do të argumentohen mëposhtme në zërat përkatës.

Disbalancat nga Prodhimi Energjisë Elektrike. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi për disbalancat është 6,412,497.91 lekë dhe realizimi është 3,143,429.80 lekë, në përqindje 49.02% e planit. Detyrimi për pagesën e kostove të disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike buron nga Ligji Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", Vendimi i Entit Rregullator të Energjisë Nr. 106, datë 02.07.2020 "Mbi miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 398, datë 09.06.2022 "Për trajtimin e disbalancave të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike". Sipas këtij vendimi shpërndarja e kostove të disbalancimit faturohet çdo muaj me një vlerë e cila përcaktohet nga vlera totale e faturës së grupit të prodhuesve shumëzuar me koeficientin e energjisë së prodhuar nga ana jonë ndaj totalit të energjisë së grupit. Kësaj vlere i shtohet dhe tarifa për mbulimin e shpenzimeve të liderit të grupit në lekë/kŵh të prodhuar, tarifë e cila caktohet me vendim të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë FTL SHA. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 63.79% më pak si efekt i realizimit më të ulët të sasisë së energjisë së prodhuar për shitje mbi të cilin referohet dhe llogaritja e disbalancave.

Materiale të Para dhe Materiale të Tjera . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 3,112,640.00 lekë dhe realizimi është 2,610,000.00 lekë, në përqindje 83.85%. Kjo përqindje është si rezultat i realizimit në po të njëjtën masë të zërit materiale të para, ndihmëse, elektrike etj., në të cilin është përfshirë blerja e një game të gjerë artikujsh të domosdoshëm për mirëmbajtjen, funksionin, remontet periodike të planifikuara, materiale konsumi etj. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky grup shpenzimesh është realizuar 42.91% më shumë. Në këtë rezultat ka ndikuar fondi i parashikuar për vitin 2023 i cili ka qenë më i lartë si efekt i rritjes së ndjeshme të çmimeve të tregut për këto materiale se fondi i parashikuar për blerjen e këtyre materiale për vitin 2022, rrjedhimisht dhe realizimi është më i lartë.

Materiale të para, elektrike, ndihmëse etj. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 3,112,640.00 lekë dhe realizimi është 2,610,000.00 lekë, në përqindje 83.85%. Në këtë zë shpenzimesh përfshihet blerja e materialeve të domosdoshëm për hidrocentralin, të nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të makinerive, objektit dhe pajisjeve. Puna dhe jetëgjatësia e pajisjeve është e lidhur ngushtë me shërbimet që i bëhen. Me këto materiale është llogaritur që të eliminohen probleme të natyrave të ndryshme si elektrike dhe mekanike, të mirëmbahet ndriçimi i jashtëm dhe i brendshëm, mirëmbajtja e pajisjeve të instaluara kryesore dhe ndihmëse për prodhimin e energjisë elektrike, remontet profilaktike mujore të këtyre pajisjeve, pastrime dhe meremetime të ndryshme në ambientet e jashtme dhe të brendshme të hidrocentralit etj. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 42.91% më shumë. Në këtë rezultat ka ndikuar fondi i parashikuar për vitin 2023 i cili ka qenë më i lartë si efekt i rritjes së ndjeshme të çmimeve të tregut për këto materiale se fondi i parashikuar për blerjen e këtyre materiale për vitin 2022, rrjedhimisht dhe realizimi është më i lartë.

Në zërin e shpenzimeve për furnitura janë llogaritur të gjithë zërat analitike ku shpenzimin kryesor e zë pagesa që bëhet ndaj Ujësjellës Kanalizime Tiranë në masën 5 lekë/m3 për të gjithë sasinë e ujit të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 110,910,146.83 lekë dhe realizimi është 99,339,470.12 lekë, në përqindje 89.57%.

Furnitura dhe Shërbime zënë **66.92%** të totalit të shpenzimeve për periudhën Janar - Dhjetor 2023, duke qenë se zëri që ndikon ndjeshëm në rritjen e shpenzimeve është zëri shpenzime uji për prodhimin e energjisë elektrike.

Shpenzimet për blerjen e ujit zënë 56.37% të totalit të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2023 dhe 84.23% të totalit të furnitura e shërbime. Krahasuar periudhën Janar-Dhjetor 2022 realizimi i këtij zëri është 8.12% më pak, duke qenë se për të njëjtën periudhë të vitit 2023 kemi një rënie në realizimin e disa prej zërave të shpenzimeve si: zëri shpenzime uji prodhimin e energjisë elektrike me 8.57% duke qenë se shpenzimet për blerjen e ujit i referohen realizimit të sasisë së ujit të përdorur nga Hec, karburant me 5.31% më pak si rezultat i rënies së çmimit të karburantit, shpenzime riparime mirëmbajtje me 32.89% më pak si rezultat i mosrealizimit të të gjithë procedurave të parashikuara, mirëmbajtje automjetesh me 69.79% më pak bazuar në nevojat

që kanë patur automjetet për shërbime, shpenzime mbikëqyrje dhe kolaudimi me 80.80% më pak duke qenë se për vitin 2022 ka qenë realizuar dhe fondi për mbikëqyrjen e punimeve i cili për vitin 2023 është zbritur në planin e rishikuar gjatë vitit pasi ky shërbim do të kryhet nga punonjësi i shoqërisë i cili është licesuar me licencën e mbikëqyrësit të punimeve.

Shpenzime ujit për prodhimin e energjisë elektrike . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 91,643,479.50 lekë dhe realizimi është 83,677,104.00 lekë, në përqindje 91.31%. Ky realizim vjen si rezultat i realizimit të sasisë së ujit të përdorur nga Hec e cila përllogaritet duke u bazuar në sasinë e energjisë së prodhuar. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 realizimi i këtij zëri është 8.57% më pak si efekt i realizimit më të ulët të sasisë së energjisë së prodhuar për shitje për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023.

Karburant. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 kemi parashikuar 2,038,237.88 lekë fond për këtë zë dhe realizimi është 1,396,935.14 lekë, në përqindje 68.54%. Kjo përqindje realizimi ka ardhur si rezultat i çmimit të karburantit i cili ka qenë më i ulët në momentin e blerjes krahasuar me çmimin me të cilin është bërë parashikimi i cili ka qenë më i lartë si efekt i rritjes së ndjeshme të çmimit të karburantit gjatë asaj periudhe. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 5.31% më pak. Gjithashtu edhe në këtë përqindje ka ndikuar rënia e çmimit të karburantit gjatë vitit 2023.

Qera ambiente zyrash. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 2,160,000.00 lekë dhe realizimi është 2,138,014.00 lekë, në përqindje 98.98%. Realizimi i këtij zëri i përket vlerës së qerasë për ambientet e zyrave të administratës që paguajmë çdo muaj përcaktuar në kontratën e lidhur ndërmjet qiradhënësit dhe shoqërisë si dhe pagesat për shpenzime uji dhe energjie elektrike për këto ambiente. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 26.03% më shumë, si efekt i rritjes së pagesës mujore të qerasë bazuar në kontratën e lidhur gjatë vitit 2023.

Roje objektesh. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 4,257,481.68 lekë dhe realizimi është 4,257,481.67 lekë, në përqindje 100%. Ky realizim i përket shërbimit të ruajtjes fizike për ambientet e hidrocentralit si objekt i një rëndësie të veçantë. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar në të njëjtën masë.

Sigurim prone . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 980,000.00 lekë dhe realizimi është 980,000.00 lekë, në përqindje 100%. Ky realizim i përket shërbimit të ruajtjes fizike për ambientet e hidrocentralit si objekt i një rëndësie të veçantë. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar në të njëjtën masë.

Sigurim jete dhe shëndeti për punonjësit. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 982,600.00 lekë dhe realizimi është 806,400.00 lekë, në përqindje 82.07%. Realizimi i këtij zëri është bazuar në kontratën e lidhur për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve. Edhe pse fondi i përcaktuar në kontratë është planifikuar për të gjithë numrin total të punonjësve sipas strukturës së miratuar, fondi i realizuar i përket numrit aktual të punonjësve duke qenë se struktura nuk është realizuar 100%. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 9.99% më pak, si efekt i realizimi të numrit mesatar të punonjësve i cili për vitin 2023 është më i ulët krahasuar me realizimin e numrit mesatar të punonjësve për vitin 2022.

Shërbime, riparime, mirëmbajtje. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 3,269,000.00 lekë dhe realizimi është 1,620,260.00 lekë, në përqindje 49.16%. Kjo përqindje realizimi vjen si rezultat i mos realizimit të të gjitha procedurave të parashikuara për tu kryer në këtë periudhë dhe realizimit të procedurave nga procesi prokurimit. Procedura për Certifikimin e Instalimeve të Pajisjeve Elektrike në Hec e cila zë 30.34% të fondit total të zërit shërbime, riparime, mirëmbajtje nuk është realizuar për arsye se nuk mund të kryhej pa u bërë më parë F.V Tokëzimit në HEC. Duke qenë se procedura për F.V Tokëzimi HEC është realizuar në fund të vitit, koha për zhvillimin e procedurës për certifikimin e instalimeve elektrike brenda vitit ishte e pamjaftueshme. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 32.89% më pak, duke qenë se fondi i parashikuar për vitin 2022 për zërin shërbime, riparime, mirëmbajtje ka qenë më i lartë se fondi i parashikuar për këtë zë për vitin 2023, rrjedhimisht dhe realizimet i përkasin parashikimeve të bëra.

Mirëmbajtje për automjetet . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 598,920.00 lekë dhe realizimi është 174,000.00 lekë, në përqindje 29.05%. Kjo përqindje vjen si rezultat i mos ezaurimit të fondit rezervë i cili ka qenë planifikuar për difektet e mundshme të cilat nuk mund të parashikoheshin që mund të dilnin gjatë përdorimit të tyre. Deri në fund të vitit nuk kemi patur probleme të tilla me asnjë nga automjetet që shoqëria ka në pronësi, rrjedhimisht dhe ky fond nuk është realizuar. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 69.79% më pak, duke qenë se fondi rezervë i parashikuar për vitin 2023 për difektet e mundshme të cilat nuk mund të parashikoheshin nuk është realizuar.

Siguracion dhe kontroll teknik i makinave. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 287,540.00 lekë dhe realizimi është 290,160.00 lekë, në përqindje 100.91%. Realizimi i zërit siguracion dhe kontroll teknik i makinave i përket pagesave të kryera për sigurimin vjetor të automjeteve në pronësi të shoqërisë si dhe pagesave të kryera për kontrollin teknik të automjeteve. Tejkalimi prej 0.91% ka ardhur si rezultat i pagesës së bërë për kontrollin teknik (ritestim) për njërin nga mjetet i cilin nuk kaloj me herën e parë. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 3.67% më shumë, si efekt i ritestimit të mjetit për kontrollin teknik i cilin nuk kaloj me herën e parë.

Shpenzime kancelarie . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 99,849.40 lekë dhe realizimi është 99,849.16 lekë, në përqindje 99.99%. Realizimi i këtij zëri i përket blerjes së artikujve të kancelarisë për plotësimin e nevojave të punës. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 100.03% më shumë, duke qenë se fondi i parashikuar për vitin 2023 për shpenzime kancelarie ka qenë më i lartë se fondi i parashikuar për këtë zë për vitin 2022, rrjedhimisht dhe realizimet i përkasin parashikimeve të bëra.

Personel i jashtëm (Këshilli Mbikëqyrës) . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 2,223,631.20 lekë dhe realizimi është 2,195,640.00 lekë, pra në përqindje 98.74%. Këtu kemi përfshirë pagesën e Këshillit Mbikëqyrës të HEC Lanabregas SHA. bazuar në Vendimin Nr. 570, datë 03/10/2018 "Për Këshillat Mbikëqyrës të Shoqërive Anonime Shtetërore". Krahasuar me periudhën Janar Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 5.65% më shumë si efekt i rritjes së pagave.

Shpenzime konsulence teknike-ekonomike . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 800,000.00 lekë dhe realizimi është 800,000.00 lekë, pra në përqindje 100%. Ky realizim i përket pagesës së Ekspertëve Kontabël për hartimin e Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare për vitin 2022, për Shoqërinë HEC Lanabregas SHA. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar në të njëjtën masë.

Shpenzime mbikëqyrje dhe kolaudimi . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 137,196.45 lekë dhe realizimi është 91,058.00 lekë, pra në përqindje 66.37%. Kjo përqindje vjen si rezultat i realizimit të procedurës nga procesi prokurimit për kolaudimin e punimeve për Rikonstruksionin e Seksionit 6 KV (faza e dytë) në HEC Lanabregas. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 80.80% më pak, duke qenë se për vitin 2022 ka qenë parashikuar dhe realizuar fondi për mbikëqyrjen e punimeve, i cili për vitin 2023 është zbritur në planin e rishikuar gjatë vitit pasi ky shërbim do të kryhet nga punonjësi i shoqërisë i cili është licesuar me licencën e mbikëqyrësit të punimeve.

Shpenzime Udhëtim e Dieta . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 200,000.00 lekë. Për vitin 2023 nuk kemi realizim për këtë zë. Edhe për periudhën Janar-Dhjetor 2022 nuk ka patur realizim.

Shpenzime poste dhe interneti . Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 63,000.00 lekë dhe realizimi është 63,000.00 lekë, në përqindje 100%. Realizimi i këtij zëri i përket pagesës për internetin e vendosur në ambientet e zyrave të administratës si dhe pagesës për internetin në ambientet e hidrocentralit, bazuar në kontratat e lidhura. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 0.88% më shumë duke qenë se kontrata për internetin e vendosur në ambientet e hidrocentralit është lidhur në mes të muajt Janar, rrjedhimisht dhe pagesa nuk është bërë e plotë për këtë muaj.

Shpenzime telefoni. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 133,000.00 lekë dhe realizimi është 110,833.22 lekë, në përqindje 83.33%. Realizimi i këtij zëri i përket shpenzimeve për telefonin në ambientet e Hec-it, shpenzimet për numrin e telefonit të vendosur për sistemin e alarmit në ambientet e zyrave si dhe shpenzimeve për telefoni celulare për drejtuesit e shoqërisë. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 11.39% më pak, duke qenë se konsumi për telefonin celulare për vitin 2023 ka qenë më i ulët krahasuar me konsumin e të njëjtës periudhë të vitit 2022.

Shërbime bankare. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 55,000.00 lekë dhe realizimi është 57,907.23 lekë, në përqindje 105.29%. Realizimi i këtij zëri i përket komisioneve që mbajnë bankat për mbajtjen e llogarive dhe tejkalimi prej 5.29% ka ardhur si rezultat i komisioneve që mban banka për transaksionet e kryera për shlyerjen e detyrimeve nga llogaria e shoqërisë kundrejt bankave të tjera. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 0.50% më shumë, referuar pagesave të kryera gjatë vitit 2023 për komisionet e transaksioneve ndërmjet bankave.

Shpenzime të përgjithshme. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 954,210.73 lekë dhe realizimi është 580,827.69 lekë, në përqindje 60.87%. Kjo përqindje realizimi vjen si rezultat i mos realizimit të të gjitha procedurave të parashikuara për tu kryer në këtë periudhë dhe realizimit të procedurave nga procesi prokurimit. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 55.90% më shumë, duke qenë se fondi total i parashikuar për vitin 2023 për shpenzime të përgjithshme ka qenë më i lartë se fondi i parashikuar për këtë zë për vitin 2022, rrjedhimisht dhe realizimet i përkasin parashikimeve të bëra.

Shpenzime Personeli Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi për shpenzime personeli është 35,774,314.89 lekë dhe realizimi është 29,718,737.00 lekë, në përqindje 83.07%. Ky realizim vjen si rezultat i mosrealizimit 100% të numrit të punonjësve i cili prek disa prej zërave të shpenzimeve të personelit si fondi i pagave, trajtimi ushqimor, sigurimet shoqërore etj. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 realizimi i këtij zëri është 0.92% më pak, kjo për arsye se numri mesatar i punonjësve është më i ulët gjatë së njëjtës periudhë të vitit 2023.

Fondi i pagave gjithsej. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 26,178,546.00 lekë dhe realizimi është 21,388,103.00 lekë, në përqindje 81.70%. Realizimi i fondit të pagave përllogaritet duke u bazuar në realizimin e numrit mesatar të punonjësve, prandaj kemi këtë përqindje realizimi duke qenë se numri i punonjësve për këtë periudhë nuk është realizuar 100%. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 0.72% më pak ose thënë ndryshe fondi i pagave është ulur me 155,513.00 lekë. Në këtë ulje të fondit të pagave ka ndikuar realizimi i numrit mesatar të punonjësve për periudhën Janar-Dhjetor 2022 që është treguesi kryesor që ndikon në realizimin e fondit të pagave, i cili është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Trajtimi ushqimor i punonjësve. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 2,040,000.00 lekë dhe realizimi 1,650,000.00 lekë, në përqindje 80.88%. Ky realizim i përket trajtimit prej 5,000 lekë në muaj për çdo punonjës sipas kontratës së punës. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 9.39% më pak, referuar realizimit të numrit të punonjësve.

Shpërblim. Për periudhën Janar-Qershor 2023 parashikimi është 2,609,871.71 lekë dhe realizimi është 2,604,807.00 lekë, në përqindje 99.81%. Realizimi i këtij zëri i përket shpërblimeve të dhëna për punonjësin që ka dalë në pension, shpërblim për lindje fëmije dhe shpërblim në fund të vitit për punonjësit, të parashikuara në Kontratën Kolektive të Punës. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 4.19% më shumë, për arsye se për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2023 rastet e dhënies së shpërblimeve për lindje kanë qenë më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Paga jashtë orarit. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është parashikuar 200,000.00 lekë dhe realizimi është 195,724.00 lekë, në përqindje 97.86%. Realizimi i këtij zëri i përket pagesës që i janë bërë punonjësve për orët e punës jashtë orarit zyrtar që kanë punuar në rastet e avarive të ndodhura në hidrocentral. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 0.31% më pak,

kjo referuar orëve të punës jashtë orarit që kanë punuar punonjësit, krahasuar me ato të punuara gjatë vitit 2022.

Sigurime shoqërore. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 4,745,897.18 lekë dhe realizimi është 3,880,103.00 lekë, në përqindje 81.76%. Realizimi i këtij zëri i përket përllogaritjeve të bëra bazuar në ligjin për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore të detyrueshme për tu paguar. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 1.39% më pak, referuar realizimit të numrit të punonjësve.

V.5 Tatime e Taksa

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 1,067,000.00 lekë dhe realizimi është 1,164,198.00 lekë, në përqindje 109.11%. Ky realizim i përket taksave vendore për dy vendodhjet në të cilat shoqëria ushtron aktivitetin, taksave të automjeteve, taksës së ERE. Tejkalimi 9.11% ka ardhur si rezultat i tejkalimit të zërit taksa vendore dhe pasurie me 0.22% si rezultat i përfshirjes në këtë zë të taksës së televizorit e cila është faturuar çdo muaj në faturën e energjisë elektrike për të cilën nuk është bërë parashikim për arsye se gjatë vitit 2022 nuk kemi patur faturim të kësaj takse, gjithashtu tejkalimit të zërit taksa ERE me 16.56% për parashikim e të cilës bazohemi mbi të ardhurat e vitit paraardhës. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 22.00% më shumë, si rezultat i tejkalimit të nën zërave të këtij grupi shpenzimesh të sqaruara më sipër.

Taksa vendore dhe pasurie. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 445,000.00 lekë dhe realizimi është 446,000.00 lekë, në përqindje 100.22%. Realizimi i këtij zëri i përket pagesave për detyrimet të cilat janë përcaktuar nga Drejtoria Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore bazuar në Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 59, datë 30.12.2015, "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore", i ndryshuar. Tejkalimi prej 0.22% ka ardhur si rezultat i përfshirjes në këtë zë të taksës së televizorit e cila është faturuar çdo muaj në faturën e energjisë elektrike, për të cilën nuk është bërë parashikim për vitin 2023 për arsye se gjatë vitit 2022 nuk kemi patur faturim të kësaj takse. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 0.22% më shumë, referuar sqarimit të dhënë më sipër.

Taksa për automjetet. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 22,000.00 lekë dhe realizimi është 18,835.00 lekë, në përqindje 85.61%. Kjo përqindje realizimi vjen si rezultat i pagesave për taksat vjetore të automjeteve në pronësi të shoqërisë. Krahasuar me periudhën Janar Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 26.05% më shumë, duke qenë se për vitin 2023 është parashikuar fond edhe për mjetin i cili edhe për vitin 2022 ka qenë i përjashtuar nga taksat referuar vitit të tij të prodhimit, rrjedhimisht dhe realizimet i përkasin parashikimeve.

Taksa e RE. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 600,000.00 lekë dhe realizimi është 699,363.00 lekë, në përqindje 116.56%. Realizimi i këtij zëri i përket pagesës së tarifës së rregullimit që HEC Lanabregas ka bërë për ERE, përcaktuar me vendimin Nr. 171, datë 15/05/2023 "Mbi Llogaritjen e Pagesave Rregullatorë për Vitin 2023" të Bordit të Komisionerëve të ERE. Si rregull taksa e ERE llogaritet mbi të ardhurat e vitit paraardhës mbi të cilin jemi bazuar për parashikimin e bërë. Meqenëse për vitin 2022 kemi realizuar më shumë të ardhura se një vit më parë si rezultat edhe kjo taksë ka pësuar rritje. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022 ky zë është realizuar 41.48% më shumë, referuar realizimit të të ardhurave të vitit paraardhës mbi të cilin bëhet parashikimi, rrjedhimisht dhe realizimi i përket parashikimit të bërë.

Gjoba penalitete dhe dëmshpërblime. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 1,546,000.00 lekë dhe realizimi është 20,109.00 lekë, në përqindje 1.30%. Realizimi i këtij zëri i përket pagesës së shpenzimeve administrative (gjoba që janë marrë gjatë ecurisë së punës). Pjesa e mbetur pa realizuar i përket fondit të parashikuar për dëmshpërblimet e mundshme si pasojë e vendimeve të gjykatave për punonjës të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës, çështje të cilat janë për rigjykim në Gjykatën e Apelit dhe duke qenë se këto vendime nuk janë marrë gjatë kësaj periudhe nga organet përkatëse, rrjedhimisht gjatë kësaj periudhe nuk kemi realizim për këto shpenzime. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 22.73% më shumë,

duke qenë se shpenzimet për gjobat e paguara gjatë viti 2023 janë më të larta krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

Shpenzime për Zhvlerësimin e Aktiveve. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 6,650,000.00 lekë dhe realizimi është 8,718,388.00 lekë, në përqindje 131.10%. Kjo përqindje i përket vlerës së amortizimit të aseteve në pronësi të shoqërisë. Tejkalimi 31.10% ka ardhur si rezultat i parashikimit të bërë për këto shpenzime i cili është bazuar në realizimin e vitit 2022 që ka qenë më i ulët se realizimi i vitit 2023, bazuar në vlerën e amortizimit të aseteve. Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 34.92% më shumë, si rezultat i rritjes së amortizimit gjatë kësaj periudhe të vitit 2023.

Shpenzime të Jashtëzakonshme. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 5,000,000.00 lekë dhe realizimi është 3,735,000.00 lekë, në përqindje 74.70%. Kjo përqindje realizimi i përket riparimit të transformatorit të fuqisë bazuar në nevojën e domosdoshme për të shmangur humbjet në prodhimin e energjisë elektrike në rastet e avarive. Krahasuar me periudhën Janar Dhjetor 2022 ky zë është realizuar 22.19% më pak, duke qenë se fondi i nevojshëm për kryerjen e këtij riparimi ka qenë me i ulët se ai i realizuar gjatë vitit 2022, tabela 8.

Tabela 8. *Realizimi i Treguesve të fitimit për periudhën Janar-Dhjetor 2022-2023*

NR.	EMËRTIMI	NJËSIA	2022	2023		Diferenca			
			FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	PLAN 12-Mujori Janar-Dhjetor	FAKT 12-Mujori Janar-Dhjetor	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Plani Janar-Dhjetor 2023*	*në Vlerë Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*	*në % Fakti Janar-Dhjetor 2023/ Fakti Janar-Dhjetor 2022*
VI	**FITIMI**								
	Fitimi Para Tatimit	lekë	56,903,279.90	80,339,356.57	80,233,803.46	*-105,553.11*	*-0.13*	*23,330,523.56*	*41.00*
	Tatim Fitimi	lekë	8,535,491.99	12,050,903.49	12,035,070.52	*-15,832.97*	*-0.13*	*3,499,578.53*	*41.00*
	Fitimi/Humbja Neto	lekë	48,367,787.92	68,288,453.08	68,198,732.94	*-89,720.14*	*-0.13*	*19,830,945.02*	*41.00*

Burimi: *Të dhënat e subjektit, të përpunuara nga grupi*

Llogaritja e fitimit vjen si rezultat i diferencës midis të ardhurave dhe shpenzimeve gjithsej. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 80,339,356.57 lekë dhe realizimi është 80,233,803.46 lekë, në përqindje 99.87%.

Krahasuar me periudhën Janar-Dhjetor 2022 realizimi i fitimit para tatimit është 41.00% më shumë, në të cilin ka ndikuar rritja e çmimit të shitjes së energjisë gjatë vitit 2023, i cili ka sjellë rritjen e të ardhurave nga shitja e energjisë.

Tatim fitimin është llogaritur në bazë të tarifës së përcaktuar prej 15% mbi fitimin para tatimit. Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 parashikimi është 12,050,903.49 lekë dhe realizimi është 12,035,070.52 lekë, në përqindje 99.87%.

Bazuar në të dhënat e realizimit të planit ekonomiko-financiar për periudhën Janar Dhjetor të vitit 2023, Shoqëria HEC Lanabregas SHA rezulton me një fitim neto prej 68,198,732 lekë.

- **Periudha 2024**

Realizimi i treguesve tekniko-ekonomik 12-mujori (janar-dhjetor) viti 2024

Nr.	EMËRTIMI	Njësia	12-MUJORI (JANAR-DHJETOR) 2024		Diferenca në Vlerë	Realizimi në %
			PLAN	FAKT		
I	TREGUESIT E PRODHIMIT					
1	Sasia e energjisë së prodhuar	000/kwh	13,355.56	15,134.45	1,778.89	113.32
2	Sasia e ujit të përdorur nga Hec	000/m3	9,616.00	10,896.80	1,280.80	113.32
II	INVESTIMET		35.62	35.28	-0.34	99.06
1	Ndërtime dhe Instalime	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Makineri e Pajisje	mln/lekë	35.62	35.28	-0.34	99.06
3	Mjete Transporti	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Pajisje e Orendi	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
5	Studime e Projektime	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
6	Investime të Tjera	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
III	TREGUESIT E PUNËS					
	Numri i Punonjësve	nr.mes	34.00	31.17	-2.83	91.67
	Fondi i pagave	mln/lekë	28.65	27.98	-0.67	97.65
	Paga mesatare mujore	lekë	75,009.56	74,616.59	-392.97	99.48
IV	TË ARDHURAT		133.56	151.34	17.79	113.32
	Të ardhura nga shitja e energjisë	mln/lekë	133.56	151.34	17.79	113.32
	Të ardhura të tjera financiare	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
V	SHPENZIMET		127.41	124.98	-2.42	98.10
1	Disbalanca nga prodhimi i Energjisë Elektrike	mln/lekë	1.10	1.53	0.43	138.99
2	Materiale të Para e Materiale të Tjera	mln/lekë	3.09	1.13	-1.96	36.54
	Materiale të para, elektrike, ndihmëse etj.	"	2.13	0.29	-1.83	13.77
	Veshje të ndryshme pune	"	0.96	0.84	-0.13	86.75
3	Furnitura dhe Shërbime	mln/lekë	70.36	71.43	1.07	101.52
	Shpenzime uji për prodhimin e en. el.	"	48.08	54.48	6.40	113.32
	Tarifë për përdorimin e ujit	"	0.47	0.00	-0.47	0.00
	Karburant	"	1.33	0.85	-0.48	64.11
	Qera ambiente zyrash	"	2.31	2.28	-0.03	98.55
	Roje objektesh	"	5.25	5.25	0.00	100.00
	Sigurim Prone	"	0.98	0.92	-0.06	93.88
	Sigurim jete dhe shendeti per punonjesit	"	0.98	0.89	-0.09	90.54
	Shërbime, riparime, mirëmbajtje	"	1.25	0.55	-0.70	44.14
	Mirëmbajtje për automjetet	"	0.72	0.08	-0.64	10.53
	Siguracion dhe kontroll teknik i makinave	"	0.44	0.44	0.00	100.00
	Shpenzime kancelerie	"	0.10	0.10	0.00	100.00
	Personel i jashtëm (K/Mbikqyrës)	"	3.23	3.23	0.00	100.00
	Shpenzime konsulence tek-ekonomik	"	1.20	1.20	0.00	100.00
	Shpenzime mbikqyrje dhe kolaudimi	"	0.17	0.09	-0.07	55.07
	Shpenzime Udhëtim e Dieta	"	0.20	0.12	-0.08	57.56
	Shpenzime poste dhe interneti	"	0.06	0.06	0.00	100.00
	Shpenzime telefoni	"	0.13	0.08	-0.05	58.71
	Shërbime bankare	"	0.06	0.06	0.00	98.26
	Shpenzime të përgjithshme	"	3.41	0.77	-2.65	22.43
4	Shpenzime Personeli	mln/lekë	41.19	40.22	-0.97	97.64
	Fondi pagave gjithsej	"	28.65	27.98	-0.67	97.65
	Trajtimi ushqimor i punonjësve	"	4.02	3.92	-0.10	97.50
	Shpërblim	"	3.07	2.99	-0.07	97.63
	Paga jashtë orarit	"	0.00	0.00	0.00	0.00
	Sigurime shoqërore	"	5.46	5.33	-0.13	97.71
5	Tatime e Taksa	mln/lekë	1.26	1.25	0.00	99.84
	Taksa vendore dhe pasurie	"	0.45	0.45	0.00	99.89
	Taksa për automjetet	"	0.02	0.02	0.00	93.07
	Taksa ERE	"	0.79	0.79	0.00	100.00
	Taksa të tjera	"	0.00	0.00	0.00	0.00
6	Gjoba penalitete dhe dëmshpërblime	mln/lekë	0.50	0.66	0.16	132.25
7	Shpenzime për Zhvlerësimin e Aktiveve	mln/lekë	7.40	8.70	1.30	117.54
8	Shpenzime të jashtëzakonshme	mln/lekë	2.50	0.05	-2.45	2.16
VI	FITIMI					
	Fitimi Para Tatimit	mln/lekë	6.15	26.36	20.21	428.75
	Tatim Fitimi	mln/lekë	0.92	3.95	3.03	428.75
	Fitimi/Humbja Neto	mln/lekë	5.23	22.41	17.18	428.75

Energjia Elektrike e Prodhuar për vitin 2024 është 15,134,450 kŵh. Krahasuar me planin e miratuar për vitin 2024 realizimi në përqindje është 113.32%. Nga shitja e Energjisë Elektrike janë gjeneruar të ardhura për vitin 2024 në masën 151,344,500 lekë. Krahasuar me planin e miratuar për vitin 2024 realizimi në përqindje është 113.32%.

Shpenzimet i përgjigjen sasisë së ujit të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike, disbalancave nga prodhimi energjisë si dhe plotësimit të nevojave për materiale, furnitura e shërbime, shpenzime personeli, tatime e taksa etj. Për vitin 2024 shpenzimet janë realizuar në vlerën 124,983,365.51 lekë. Krahasuar me planin e miratuar për vitin 2024 realizimi në përqindje është 98.10%.

Fitimi Neto i realizuar për vitin 2024 është përllogaritur në vlerën 22,406,964 lekë.

- **Periudha 2025**

Realizimi i treguesve tekniko-ekonomik për periudhën janar-korrik të vitit 2025

Nr.	EMËRTIMI	Njësia	7-MUJORI (JANAR-KORRIK) 2025		Diferenca në Vlerë	Realizimi në %
			PLAN	FAKT		
I	**TREGUESIT E PRODHIMIT**					
1	Sasia e energjisë së prodhuar	000/kwh	9,447.76	10,614.29	1,166.53	112.35
2	Sasia e ujit të përdorur nga Hec	000/m3	6,802.39	7,642.29	839.90	112.35
II	**INVESTIMET**		**0.74**	**0.00**	**-0.74**	**0.00**
1	Ndërtime dhe Instalime	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
2	Makineri e Pajisje	mln/lekë	0.74	0.00	-0.74	0.00
3	Mjete Transporti	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
4	Pajisje e Orendi	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
5	Studime e Projektime	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
6	Investime të Tjera	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
III	**TREGUESIT E PUNËS**					
	Numri i Punonjësve	nr.mes	34.00	31.71	-2.29	93.28
	Fondi i pagave	mln/lekë	18.31	16.94	-1.37	92.51
	Paga mesatare mujore	lekë	76,936.91	76,302.50	-634.40	99.18
IV	**TË ARDHURAT**		**94.48**	**106.14**	**11.67**	**112.35**
	Të ardhura nga shitja e energjisë	mln/lekë	94.48	106.14	11.67	112.35
	Të ardhura të tjera financiare	mln/lekë	0.00	0.00	0.00	0.00
V	**SHPENZIMET**		**89.25**	**78.08**	**-11.17**	**87.49**
1	**Disbalanca nga prodhimi i Energjisë Elektrike**	**mln/lekë**	**0.94**	**0.85**	**-0.09**	**90.14**
2	**Materiale të Para e Materiale të Tjera**	**mln/lekë**	**2.46**	**0.84**	**-1.62**	**34.32**
	Materiale të para, elektrike, ndihmëse etj.	"	2.46	0.84	-1.62	34.32
	Veshje të ndryshme pune	"	0.00	0.00	0.00	0.00
3	**Furnitura dhe Shërbime**	**mln/lekë**	**50.87**	**46.98**	**-3.89**	**92.36**
	Shpenzime uji për prodhimin e en. el.	"	34.01	38.21	4.20	112.35
	Tarifë për përdorimin e ujit	"	2.17	0.00	-2.17	0.00
	Karburant	"	0.84	0.45	-0.38	54.23
	Qera ambiente zyrash	"	1.35	1.34	-0.01	99.08
	Roje objektesh	"	3.06	3.06	0.00	100.00
	Sigurim Prone	"	0.00	0.00	0.00	0.00
	Sigurim jete dhe shendeti per punonjesit	"	0.00	0.00	0.00	0.00
	Shërbime, riparime, mirëmbajtje	"	4.45	0.31	-4.14	6.85
	Mirëmbajtje për automjetet	"	0.72	0.00	-0.72	0.00
	Siguracion dhe kontroll teknik i makinave	"	0.55	0.43	-0.12	77.33
	Shpenzime kancelerie	"	0.00	0.00	0.00	0.00
	Personel i jashtëm (K/Mbikqyrës)	"	1.88	1.87	-0.01	99.41
	Shpenzime konsulence tek-ekonomik	"	1.20	1.20	0.00	100.00
	Shpenzime mbikqyrje dhe kolaudimi	"	0.16	0.00	-0.16	0.00
	Shpenzime Udhëtim e Dieta	"	0.12	0.00	-0.12	0.00
	Shpenzime poste dhe interneti	"	0.04	0.03	0.00	96.43
	Shpenzime telefoni	"	0.08	0.03	-0.05	36.84
	Shërbime bankare	"	0.04	0.04	0.00	107.34
	Shpenzime të përgjithshme	"	0.21	0.01	-0.19	6.04
4	**Shpenzime Personeli**	**mln/lekë**	**25.11**	**22.57**	**-2.54**	**89.88**
	Fondi pagave gjithsej	"	18.31	16.94	-1.37	92.51
	Trajtimi ushqimor i punonjësve	"	2.62	2.40	-0.22	91.58
	Shpërblim	"	0.45	0.00	-0.45	0.00
	Paga jashtë orarit	"	0.20	0.00	-0.20	0.00
	Sigurime shoqërore	"	3.53	3.23	-0.30	91.52
5	**Tatime e Taksa**	**mln/lekë**	**1.17**	**1.05**	**-0.11**	**90.34**
	Taksa vendore dhe pasurie	"	0.45	0.46	0.02	104.16
	Taksa për automjetet	"	0.02	0.00	-0.02	0.00
	Taksa ERE	"	0.70	0.59	-0.11	84.38
	Taksa të tjera	"	0.00	0.00	0.00	0.00
6	**Gjoba penalitete dhe dëmshpërblime**	**mln/lekë**	**0.00**	**0.00**	**0.00**	**0.00**
7	**Shpenzime për Zhvlerësimin e Aktiveve**	**mln/lekë**	**5.78**	**5.78**	**0.00**	**100.00**
8	**Shpenzime të jashtëzakonshme**	**mln/lekë**	**2.92**	**0.00**	**-2.92**	**0.00**
VI	**FITIMI**					
	Fitimi Para Tatimit	**mln/lekë**	**5.23**	**28.06**	**22.83**	**536.39**
	Tatim Fitimi	**mln/lekë**	**0.78**	**4.21**	**3.42**	**536.39**
	Fitimi/Humbja Neto	**mln/lekë**	**4.45**	**23.85**	**19.41**	**536.39**

Energjia Elektrike e Prodhuar, për periudhën Janar-Korrik 2025 është 10,614,290.00 kŵh. Krahasuar me planin e miratuar për periudhën Janar-Korrik të vitit 2025 realizimi në përqindje është 112.35%.

Nga shitja e Energjisë Elektrike janë gjeneruar të ardhura, për periudhën Janar-Korrik 2025 në masën 106,142,900.00 lekë. Krahasuar me planin e miratuar për periudhën Janar-Korrik 2025 realizimi në përqindje është 112.35%.

Shpenzimet, i përgjigjen sasisë së ujit të përdorur për prodhimin e energjisë elektrike, disbalancave nga prodhimi energjisë si dhe plotësimit të nevojave për materiale, furnitura e shërbime, shpenzime personeli, tatime e taksa etj. Për periudhën Janar-Korrik të vitit 2025 shpenzimet janë realizuar në vlerën 78,079,175.60 lekë. Krahasuar me planin e miratuar për periudhën Janar-Korrik 2025 realizimi në përqindje është 87.49%.

Fitimi Neto, i realizuar për periudhën Janar-Korrik 2025 është përllogaritur në vlerën 23,854,165.74 lekë.

Objektivat kryesore të shoqërisë të përcaktuara dhe në statutin e shoqërisë janë : *Prodhim i energjisë elektrike dhe shitja e energjisë elektrike. Shoqëria mundet te realizoje çdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Shoqëria do te kryeje çdo veprim me qellim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve te nevojshme për realizimin e veprimtarive te saj, për te cilat kërkohen këto dokumente administrative.*

Nga shqyrtimi i regjistrit të aktiveve të shoqërisë vërehet se një pjesë e madhe e makinerive dhe pajisjeve kanë tejkaluar afatet teknike të përdorimit.
Nga shoqëria nuk u bënë të disponueshme analiza teknike të mbështetura në manualet përkatëse të pajisjeve, ekspertizave të specialistëve të fushës, të detajuara për caktimin e jetëgjatësisë për pajisjet gjendje, dhe planifikimin për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
Për sa sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ndryshuar, neni 5 "Menaxhimi financiar dhe kontrolli" i cili citon: "*Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh,* ***nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar, për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.*** *Ky sistem vendoset, ruhet dhe përditësohet rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihet në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme* ***se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet: veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi****."* , dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 28.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në institucionet publike".
Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi ish- administratori i shoqërisë, në cilësinë e titullarit autorizues të shoqërisë dhe nëpunësit zbatues: O.I.

IV. REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vendimet e Asamblesë dhe Këshillit Mbikëqyrës për ndryshimet në strukturë rast pas rasti, propozuar nga Administratori i shoqërisë, u konstatua se nga pikëpamja formale e hartimit të tyre në pjesën arsyetuese në asnjë rast nuk është përshkruar numri ekzistues i punonjësve në strukturë miratuar me vendimin e mëparshëm, jo në përputhje me nenin 24, pika1, germa "h" të Statutit të shoqërisë. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-15 të Raportit të Auditimit).*
1.1. Rekomandimi: Asambleja dhe Këshilli Mbikëqyrës i HEC Lanabregas SH.A, të marrë masa që në pjesën arsyetuese të vendimeve të miratuara prej tyre për ndryshimet në strukturën organike që bëhen rast pas rasti propozuar nga administratori i shoqërisë, të pasqyrohet numri ekzistues i punonjësve në strukturë dhe ndryshimet që pëson struktura, me qëllim që të ketë lidhje koherente mes vendimeve të mëparshme dhe atyre aktuale për ndryshimet e bëra.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi rekrutimin e punonjësve, u konstatua se:
- Në Rregulloren e brendshme miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr.15, datë 13.12.2016 si dhe në Statutin e HEC Lanabregas SH.A, miratuar me Vendim të Aksionerit të vetëm (UKT) Nr.13, datë 30.09.2013, nuk janë parashikuar:
- Kritere të përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në punë për vende të lira,
- Procedura e konkurrimit apo e pranimit në punë si dhe procedura e publikimit të njoftimit për rekrutim në një pozicion të caktuar, pasi në kontratat individuale të punës është parashikuar vetëm dokumentacioni që duhet të paraqesë punëmarrësi në rastin e pranimit në punë,
- Nuk evidentohet të ketë raste të deklarimeve për vende të lira pune të cilat të jenë të publikuara, jo në përputhje me nenin 12, të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë".

- Në planet ekonomiko financiare për periudhën nën auditim, paraqitur nga Administratori i shoqërisë për miratim në Asamble, nuk është parashikuar numri i vendeve vakante të krijuara si rezultat i largimeve nga puna (*apo daljeve në pension*), jo në përputhje me nenin 19 të Statutit të shoqërisë, në një kohë që për vitin 2023, kemi 5 largime nga puna për arsye të ndryshme *(4 me dorëheqje, 1, dalje në pension)*, për vitin 2024, kemi 8 largime nga puna *(dorëheqje*) dhe për vitin 2025 kemi 3 largime nga puna (*dorëheqje*), me qëllim planifikimin e ndryshimeve në strukturë rast pas rasti. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 15-18 të Raportit të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Administratori i shoqërisë HEC Lanabregas SH.A, të marrë masa që, në relacionet përmbledhëse për hartimin e programeve ekonomike të shoqërisë që ia paraqet për miratim Asamblesë dhe Këshillit Mbikëqyrës të parashikohet dhe numri i vendeve të lira për punë sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, duke bërë një analizë të detajuar mbi largimet nga puna për shkaqe të ndryshme me qëllim, planifikimin e ndryshimeve në strukturë rast pas rasti.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se nuk administrohet në dosje dokumenti "*raport mjekësor për aftësitë në punë*" (përveç personelit teknik) sipas kërkesave për pranimin në punë të punonjësve parashikuar në kontratën individuale të punës dhe as dokumenti i vlerësimit për performancën në punë të punonjësve, si dhe lista e inventarit të dokumentacionit të administruar në çdo dosje, jo në përputhje me nenin 25, pika 6 të Rregullores së brendshme.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 15-18 të Raportit të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në HEC Lanabregas SH.A, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të personelit si dhe inventarizimin e dokumentacionit të administruar për çdo dosje.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i **4** dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, në shoqërinë HEC Lanabregas SH.A, ku janë të pasqyruara dosjet fizike të prokurimit, të cilat ndër të tjera përmbajnë procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., u konstatua se dosjet nuk janë të pajisura me inventar të brendshëm për të gjithë përmbajtjen e tyre, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9154 datë 06.11.2003 "*Për arkivat*"; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të PP",* i ndryshuar, neni 78, pika 2, neni 74, pika 3, dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, dhe të Vendimit të Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 4, datë 19.06.2017 "*Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH*". *(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 21-39 të Raportit të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të shoqërisë HEC Lanabregas SH.A të analizojë situatën duke nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për mos arkivim të dosjeve, dhe nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masat që të gjitha procedurat e prokurimit publik të përfunduara, të arkivohen pasi dokumentacioni përkatës të numërtohet në mënyrë kronologjike.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në 3 nga 4 procedurat e prokurimit të audituara në Shoqërinë HEC Lanabregas SH.A, për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 30.09.2025 me fond limit 80,914 mijë lekë ose 96.7% e fondit të prokuruar (83,641 mijë lekë), u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore të LPP. Konkretisht:
- Procedura me objekt: "Rikonstruksion i seksionit 6KV në HEC Lanabregas faza e dytë, Viti 2023", me fond limit 35,866,371 lekë, ku fitues është shpallur B/OE I. ShPK, me vlerë oferte 34,731,300 lekë pa TVSh, ose 96.8% e fondit të prokuruar, rezultoi se:

Bashkëlidhur mungonin dokumentacioni mbi hartimin e fondit limit; Mungon njoftimi i subjektit për depozitimin e dokumentacionit nga OE fitues; Nuk evidentohet PV i verifikimit të dokumentacionit, pasi nga verifikimi një pjesë e dokumenteve nuk është sipas inventarit të subjektit, veprime në kundërshtim me nenin 35 të LPP dhe nenet 13; 26 pika 6 dhe neni 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt B/OE e shpallur fitues, duke lidhur kontratë me një B/OE në kushtet e mos plotësimit të të gjitha kritereve të DST, pasi nuk plotëson pikën 2.3.6 për kategoritë e licencës NP-11/B dhe NS-14/B.
- Procedura me objekt: "Zëvendësim i paneleve të kontrollit, Sinkronizimit, Mbrojtjes dhe Pajisjeve Matëse të Agregateve AG.1/AG.2 me sistem digjital SCADA", me fond limit 36,745,000 lekë pa TVSh, ku fitues është shpallur B/OE "L. + A." ShPK, me vlerë oferte 35,616,225 lekë pa TVSh, ose 96.9% e fondit të prokuruar.
Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt OE fitues, pasi nuk plotëson kriteret si vijon:
Mos plotësimi i rregullt i formularit përmbledhës i vetëdeklarimit (Shtojca 8), në Pjesën III, pika A; - Në pikën B, nuk është deklaruar numri i punonjësve sipas formatit të DST-së; - Në pikën C, mungon dokumentacioni provues për makineritë dhe pajisjet, konkretisht:
Megaohmeter 1000V, Multimetër dixhital, aparat testimi për RL, darë ampermetrike 150A, indikator i sensit të fazave; Nuk vërtetohet përmbushja e pikës 2.3.4 për inxhinierin elektrik të certifikuar nga prodhuesi i releve (vetëdeklarim). Ndërkohë, ky është deklaruar në Shtojcën 8.
- Procedura me objekt: "Riparim i transformatorit të dëmtuar 3200 KVA, 6/35 kv, viti 2023", me fond limit 3,803,000 lekë, ku fitues është shpallur shoqëria "E." ShPK, me vlerë oferte 3,735,000 lekë pa TVSh, ose 98.2% e fondit të prokuruar.
Sipas vlerësimit të grupit të auditimit, KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt OE fitues, pasi nuk plotëson pikën 2.3.3 mbi makineritë e pajisjet, pasi një pjesë e tyre nuk është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit, dhe për një pjesë nuk është dokumentacioni që vërteton se këtë mjete janë në pronësi të shoqërisë.
Për sa sipër, në lidhje me vlerësimin e dokumentacionit ligjorë nga KVO-ja, u konstatua se vlerësimi e procedurave të sipërcituara vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, neni 3 pika 1 dhe neni 92 pika 3 dhe 4.
(Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 21-39 të Raportit të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Titullari i shoqërisë HEC- Lanabregas SH.A të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik (OE) të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST).
Të merren masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit në fazën e vlerësimit dhe kualifikimit të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e zbatimit rigoroz të kritereve dhe shmangien e praktikave që ekspozojnë Autoritetin Kontraktor ndaj risqeve që mund të ndikojnë negativisht në realizimin e kontratave sipas afateve, cilësisë dhe kërkesave të përcaktuara.

Menjëherë dhe ne vijimësi

6. Gjetje nga auditimi*:* Nga auditimi i kontratës me objekt "*Rikonstruksion i seksionit 6 kV në HEC Lanabregas (Faza e dytë)*", nënshkruar me nr. 208 Prot., datë 24.11.2023, me vlerë 34,731,300 lekë pa TVSH, u konstatua se libreza e masave është hartuar duke shënuar vetëm sasitë përfundimtare, të cilat janë të njëjta me sasitë e parashikuara në preventiv, pa skica apo përllogaritje të tyre. Komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve sipas kontratës "Rikonstruksion i seksionit 6 kV në HEC Lanabregas (Faza e dytë)", për zërat "Demontim kabulli kontrolli fuqie" dhe "Demontim kanalina dhe aksesore të tjerë montimi", në sete dhe jo në sasi, të cilat po ashtu janë magazinuar në sete, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 610, datë 22.09.2022 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit", i ndryshuar, neni 41, pika l, dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik" i ndryshuar, pika 38. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.4.4, faqe 39-43 të Raportit të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Administratori i HEC Lanabregas SH.A, të marrë masa për:
- Rritjen e monitorimit të kontratave duke kërkuar nga strukturat përgjegjëse për ndjekjen e ecurisë së zbatimit të kontratës, verifikimin e dokumentacionit të dosjeve teknike i cili duhet të jetë në përputhje me aktet ligjore përkatëse.
- Përllogaritjen e sasisë së materialeve të demontuar, jo vetëm për këtë kontratë, por edhe kontrata të mëparshme, me synim përcaktimin e saktë të peshës apo dimensioneve, elementë të domosdoshëm për procese të tjera si nxjerrja jashtë përdorimit, apo shitja për skrap.
- Për ri inventarizimin në sasi dhe jo sete, për zërat "*Demontim kabulli kontrolli fuqie*" dhe "*Demontim kanalina dhe aksesore të tjerë montimi*", të cilat po ashtu janë magazinuar në sete.

Menjëherë dhe ne vijimësi

7. Gjetje nga auditimi*:* Nga auditimi i dokumentacionit në shoqërinë HEC-Lanabregas SH.A për periudhën objekt auditimi (01.01.2023 – 30.09.2025), u konstatua se objektivi kryesor i shoqërisë përcaktuar në statutin e shoqërisë është prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike. Planet ekonomiko-financiare të shoqërisë nuk kanë vlerësuar në mënyrë të qartë dhe konkrete gjendjen e aktiveve që duhen për përmbushjen e objektivave të saj. Nga shqyrtimi i regjistrit të aktiveve të shoqërisë vërehet se një pjesë e madhe e makinerive dhe pajisjeve kanë tejkaluar afatet teknike të përdorimit. Shoqëria nuk ka kryer analiza teknike të mbështetura në manualet përkatëse të pajisjeve, ekspertizave të specialistëve të fushës për caktimin e jetëgjatësisë për pajisjet gjendje, dhe planifikimin për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
Mungesa e një strategjie të menaxhimit të aktiveve rrit riskun e dëmtimit dhe zvogëlimin e aftësisë për të përmbushur misionin dhe objektivat e shoqërisë.
Për sa sipër është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar dhe në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 28.11.2011, "*Për menaxhimin e aktiveve në institucionet publike*" pikat 18-23.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.6, faqe 49-64 të Raportit të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë HEC Lanabregas SH.A, në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një plani të menaxhimit të riskut dhe të aktiveve, bazuar në një inventarizim dhe vlerësim të plotë të aktiveve të shoqërisë, me qëllim garantimin e përmbushjes së objektivave të shoqërisë.
Gjithashtu, të marrë masa për përcaktimin e sistemeve dhe të procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata, në veçanti, për aktivet që ndodhen në fund të ciklit të tyre të jetës, me qëllim minimizimin e risqeve të mosfunksionimit të papritur, garantimin e vazhdimësisë së veprimtarisë dhe përdorimin efektiv të burimeve të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin për planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël, u konstatua se:
- Në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, me objekt: *"Detergjente për mirëmbajtje"*, kryer në periudhën 2023, në ftesën për ofertë për mallrat e kërkuar janë përdorur emrat e markave, me emërtime jo të qarta dhe jo të plota. Në specifikimet teknike nuk janë përdorur standardet shqiptare sipas VKM-ve përkatëse si dhe standardet kombëtare për kimikatet dhe detergjentet, që përcaktohen në Ligjin nr. 27/2016, "*Për menaxhimin e kimikateve*", VKM nr. 488, datë 29.06.2016, "Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve", VKM nr. 669, datë 28.9.2011, "Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve të detergjenteve".
Gjithashtu në specifikimet e përgjithshme është kërkuar paraqitja e mostrave për disa artikuj me qëllimin e verifikimit të produkteve nga AK. Ky kriter është i tepërt pasi përputhshmëria e produkteve sipas specifikimeve teknike të kërkuar nuk mund të bëhet me paraqitjen e mostrave por me plotësimin standardeve përkatëse ose me analiza laboratorike. Kritere të tilla janë jo thelbësore dhe jo të nevojshme për procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

- Në procedurën e zhvilluar në periudhën 2024, për shërbime dezinfektimi dhe deratizimi, në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit pika 2, janë kërkuar dhe nga operatorët ekonomikë disponimi i certifikatave ISO 9001:2015 (*mbi Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë*), ISO 14001: 2015 (*mbi Sistemin e për Menaxhim Mjedisor*), ISO 45001: 2018 (*mbi Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*) dhe ISO 99:2012 (*mbi Sistemin e Menaxhimit te Integruar*).
Kërkesat e mësipërme nuk janë në proporcion me vlerën që është kontraktuar, janë jo thelbësore dhe jo të nevojshme për procedurat e blerjeve me vlera të vogla duke rritur mundësinë për zvogëlimin e OE pjesëmarrës në procedurë.
-Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël ka specifikuar shërbimet për Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim dhe ka bërë studimin e tregut për të marrë çmimet për këto shërbime. Çmimet janë marrë në disa subjekte që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre kryerjen e shërbimeve për DDD duke rezultuar në fondin limit në vlerën 997,700 lekë pa TVSH.
Në përfundim të procedurës komisioni ka konfirmuar si fitues ofertuesin e renditur i pari në klasifikim A. ShPK, me vlerë oferte 498,850 lekë pa TVSH, dhe pasi ka paraqitur fizikisht dokumentet është pranuar për lidhjen e kontratës.
Nga shqyrtimi i fondit limit të procedurës dhe procesit të ofertimit konstatohet se vlera e ofertës fituese është 50 % ose sa ½ e vlerës së fondit limit të përllogaritur nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla. Procesi i testimit të tregut nuk është i besueshëm dhe i saktë duke sjellë rritje të panevojshme të fondit limit efektet e të cilit ndikojnë në ekonomicitetin e shfrytëzimit të burimeve financiare të HEC Lanabregas, në kundërshtim me nenin 40 dhe nenin 76 pika 1-2 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", ndryshuar me Vendimin Nr. 710, datë 24.11.2021.
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 18-21 të Raportit të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë HEC Lanabregas SH.A, të marrë masa për trajnimin e punonjësve lidhur me procedurat e prokurimit për aftësimin e tyre dhe realizimin e procedurave të blerjeve me përgjegjshmëri dhe profesionalizëm.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 30.09.2025, Shoqëria HEC Lanabregas SH.A ka lidhur kontratë me shoqërinë V. për shërbimin e telefonisë për 24 numra celulari. Në vendimet e Këshillit Mbikëqyrës aprovimi është për vetëm tre pozicione në administratën e shoqërisë, si dhe janë përcaktuar kuotat për disbursim. Dhënia e garancisë ndaj shoqërisë V. për mbulimin e shpenzimeve për të gjithë numrat e kontraktuar përfshirë dhe pozicionet e tjera jo të aprovuara në vendimin e KM, rrit riskun e shoqërisë për efekte të mundshme ekonomike negative, veprime në kundërshtim me pikën 12 të VKM nr. 673, datë 02.09.2020 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik".
(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 18-21 të Raportit të Auditimit).
9.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë HEC-Lanabregas SH.A, të marrë masa që në të ardhmen funksionarët që përfitojnë disbursimin e shpenzimeve telefonike, të lidhin kontratë individuale me cilindo prej operatorëve të shërbimit telefonik të lëvizshëm që veprojnë në vend, për një numër të vetëm celular dhe detyrimi financiar i cili paguhet nga funksionari, kompensohet nga institucioni, kundrejt dokumentit të blerjes së shërbimit të numrit telefonik celular, por jo më shumë se kufijtë përkatës mujorë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Shoqëria HEC Lanabregas SH.A nuk është hartuar dhe miratuar Rregullorja për Menaxhimin e Aktiveve, për ruajtjen e tyre, përcaktimin e personave përgjegjës për rastet e dëmtimeve apo mungesave gjatë procesit të inventarizimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 07.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, neni 9, germa ë)**,** dhe Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në*

pikën 2.5 faqe 43-49 të Raportit të Auditimit).
10.1. Rekomandimi: Administratori i HEC Lanabregas SH.A, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, nëpërmjet strukturave përkatëse të marrin masa për hartimin dhe miratimin e një rregulloreje për menaxhimin e aktiveve për ruajtjen e tyre, me qëllim përcaktimin personave përgjegjës për rastet dëmtimeve apo mungesave gjatë procesit të inventarizimit.

Menjëherë

B. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e inventarit kontabël të llogarisë studime e projektime të pasqyruar në pasqyrat financiare të vitit 2023 dhe 2024, në vlerën 17,913,190 lekë e cila përfaqëson vlerën e disa projekteve të cilat i përkasin periudhave 2017 dhe 2019 me qëllim mbrojtjen e sistemeve dhe zëvendësimin e pajisjeve të vjetra të HEC-it për studime e projektime si:
- *Studim për sistemin e mbrojtjes në vlerën 2,968,000 lekë, që i përket periudhës viti 2017,*
- *Studim për sistemin hidromekanik në vlerën 2,955,000 lekë, që përket periudhës viti 2017,*
- *Hartim projektit zbatimit dhe preventivit për ndërlidhjen e Turbinës së HEC Guri Bardhë me pajisjet e HEC Lanabregas në vlerën 1,818,960 lekë, që i përket periudhës viti 2019,*
- *Studim dhe hartim i projektit zbatimit dhe preventivit të punimeve për rehabilitimin e HEC Lanabregas në vlerën 10,717,230 lekë, që i përket periudhës viti 2019,* u konstatua se nga ana e Shoqërisë HEC Lanabregas SH.A, këto projekte nuk janë vënë në zbatim për faktin se shoqëria nuk ka planifikuar fonde për të kryer investime për vënien në zbatim të këtyre projekteve dhe mbartin riskun e mospërmbushjes së objektivave për përdorimin e aktiveve afatgjata nga pikëpamja e vlerave, përmirësimin në strukturën e tyre për një periudhë të caktuar duke siguruar eficiencën e fondeve të përdorura për përmirësimin e tyre dhe zhvlerësimin e tyre duke renduar shpenzimet nga mosvënia në zbatim, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu II, pikat 17 18 dhe 23 germa g).
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43-49 të Raportit të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë HEC- Lanabregas SH.A, në bashkëpunim me Drejtorin Ekonomik, të marrin masa që për projektet e mbrojtjes dhe mirëmbajtjes në vlerën 17,913,190 lekë të pa vëna në zbatim të përgatis një relacion dhe ta paraqes në Këshillin Mbikëqyrës për analizimin dhe marrjen e masave për vënien në zbatim të tyre për përmbushjen e objektivave për përdorimin e aktiveve afatgjata nga pikëpamja e vlerave, përmirësimin e strukturës së tyre, duke siguruar eficiencën e fondeve të përdorura.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 dhe 2024, u konstatua se në Aktivet afatshkurtër, zëri shpenzime të shtyra në vlerën 12,975,000 lekë përfaqëson e projektin për "*Ofrimi i Shërbimeve të Specializuara Ligjore dhe Rregullator në lidhje me Energjinë nga burime të Rinovueshme në favor të HEC Lanabregas SH.A*" që i përket periudhës viti 2019, i cili për periudhën pas realizimit nuk ka ofruar shërbime për operatorë të tjerë, pasi nuk ka pasur kërkesa për dhënien e këtij shërbimi, pra nuk ka përmbushur qëllimin për të realizuar të ardhura dhe mbart riskun e mospërmbushjes së objektivave për përdorimin e aktiveve nga pikëpamja e vlerave, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Kreu II, pikat 17 18 dhe 23 germa g). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 43-49 të Raportit të Auditimit).*
2.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë HEC Lanabregas SH.A, në bashkëpunim me Drejtorin Ekonomik, të marrin masa që për projektin për "*Ofrimi i Shërbimeve të Specializuara Ligjore dhe Rregullatorë në lidhje me Energjinë nga burime të Rinovueshme në favor të HEC*

Lanabregas në vlerën 12,975,000 lekë të pa vëna në zbatim të përgatis një relacion dhe ta paraqes në Këshillin Mbikëqyrës për analizimin dhe marrjen e masave për vënien në zbatim, për përmbushjen e objektivave për përdorimin e aktiveve nga pikëpamja e vlerave, duke siguruar eficiencën e fondeve të përdorura.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e blerjeve me vlera të vogla të kryer në periudhën 2025 për pajisjen me siguracion të automjeteve të shoqërisë u konstatuan parregullsitë si vijon:
Në kërkesën me nr. 118 prot., datë 16.04.2025, të specialistit të logjistikës, Zyra e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore ka kërkuar për automjetin KIA Sportage me targë AB ... KL, kryerjen e shërbimit të siguracionit vjetor TPL, siguracion ndërkombëtar (Kartoni jeshil) dhe siguracion Full Kasko si dhe për vjedhje brenda dhe jashtë Shqipërisë.
Më datë 18.04.2025 titullari i AK ka urdhëruar zhvillimin e procedurës për siguracionin e automjeteve. Në specifikimet teknike është kërkuar dhe shërbimi me GPS, kërkesë jo në përputhje me objektin e procedurës që është sigurimi i automjeteve. Në ftesën për ofertë, në pikën 5 të tabelës së çmimeve përshkrimi i shërbimit është "Siguracion ndërkombëtar (karton jeshil) për mjetin KIA Sportage dhe sasia 1. Komisioni nuk ka përcaktuar periudhën e sigurimit (javë, muaj, ditë). Përcaktimi i marrjes së siguracionit ndërkombëtar për 1 vit në vlerën 400 euro është shpenzim jo në përputhje me parimet e eficiencës dhe efektivitetit pasi nuk ka arsye të paguhet për një periudhë 1 vjeçare, vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, nenet 1,2,3 dhe 12.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 18-21 të Raportit të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë HEC Lanabregas SH.A, të analizojë shpenzimin vjetor për siguracion për lëvizje jashtë shtetit në lidhje me realizimin e objektivave të shoqërisë dhe të marrë masa që në të ardhmen fondet e shoqërisë të shpenzohen me eficiencë dhe efikasitet.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

C. MASA DISIPINORE

D.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*", rregulloren e brendshme, si dhe neni 61 të kontratës përkatëse individuale, **i rekomandojmë Administratorit të Shoqërisë HEC Lanabregas SH.A,** të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH–së, për periudhën 01.01.2023 deri më 30.09.2025, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si vijon:

a- ***"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna",*** sipas pikës 2 të nenit 61 të kontratës individuale për **6 (gjashtë)** punonjësit, si më poshtë:

1. XH.K, me detyrë Drejtor Administrativ, në cilësinë e anëtarit të KVO;
2. A.S, me detyrë Përgjegjës prodhimi, në cilësinë e anëtarit të KVO;
3. A.P, me detyrë Specialist prokurimesh, në cilësinë e anëtarit të KVO;
4. A.L, me detyrë Specialist prokurimesh, në cilësinë e anëtarit të KVO;
5. S.C, me detyrë Specialist Mirëmbajtje, në cilësinë e anëtarit të KVO;
6. J.D, me detyrë Specialist prokurimesh, në cilësinë e anëtarit të KVO.

Për punonjësit e mësipërm, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të gjitha kritereve kualifikuese të DST të miratuara nga AK, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 3, neni 98, neni 76, neni 92, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, neni 67, neni 83, në procedura me objekt: "*Rikonstruksion i seksionit 6KV në Hec Lanabregas faza e dytë*" me fond

limit 35,866,371 lekë; "*Zëvendësim i paneleve të kontrollit, Sinkronizimit, Mbrojtjes dhe Pajisjeve Matëse të Agregateve AG.1/AG.2 me sistem digjital SCADA Æ* me fond limit *36,745,000 lekë;* " *Riparim i transformatorit të dëmtuar 3200 KVA, 6/35 Kv"* me fond limit *3,803,000 lekë. (Më gjerësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 21-39, të Raport Auditimit).*

C.2. Për punonjësit e tjerë, emrat e të cilëve citohen në brendësi të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nuk është rekomanduar dhënia e një mase disiplinore konkrete, pasi është vlerësuar se shkeljet, mangësitë apo të metat e veprimeve të tyre janë në një nivel më të ulët se materialiteti.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT